

PËR MËSUESIN/EN

duk^agjini
shtëpia botuese publishing house

Mimoza Lipaj, Shqiponjë Kamberi,
Drilona Ethem, Artan Bislmi

SHOQËRIA DHE MJEDISI

Për klasën e katërt të arsimit fillor

4

PËRMBAJTJA

Udhërrëfyes	5
Hyrje	7
Planifikimi vjetor	16
Plani dymujor: shtator—tetor	17
Plani dymujor: nëntor—dhjetor	20
Plani tremujor: janar—shkurt—mars	24
Plani tremujor: prill—maj—qershor	28
Mësimi 1: Unë po rritem	32
Mësimi 2: Komuniteti ynë	34
Mësimi 3: Grupet shoqërore	36
Mësimi 4: E mira jonë e përbashkët	38
Mësimi 5: Së bashku ia dalim	40
Mësimi 6: Të drejtat dhe përgjegjësitë e mia	42
Mësimi 7: Institucionet që na mbrojnë	44
Mësimi 8: Respektojmë diversitetin kulturor	46
Mësimi 9: Ndihej i/e barabartë	48
Mësimi 10: Mendimi ndryshe	50
Mësimi 11: Shumëllojshmëria fetare në vendin tonë	52
Mësimi 12: Vlerat	54
Mësimi 13: Solidariteti - vlerë njerëzore	56
Mësimi 14: Barazi për të gjithë	58
Mësimi 15: Toleranca dhe miqësia	60
Mësimi 16: Mbështesim njëri-tjetrit	62
Mësimi 17: Me mendje dhe zemër për njerëzit	64
Mësimi 18: Respektoj mendimin e tjetrit	66
Mësimi 19: Hapat e vendimmarrjes	68
Mësimi 20: Eja të vendosim së bashku	70
Mësimi 21: Në familje vendosim së bashku	72
Mësimi 22: Në komunitetin tonë	74
Mësimi 23: Institucionet dhe vendimet	76
Mësimi 24: Vendimmarrja dikur dhe sot	78
Mësimi 25: Kosova - atdheu im	80
Mësimi 26: Pavarësia e Kosovës	82
Mësimi 27: Regjionet e Kosovës	84
Mësimi 28: Komunitetet dhe veçoritë e tyre	86
Mësimi 29: Fqinjët e Kosovës	88
Mësimi 30: Familja dikur dhe sot	90
Mësimi 31: Fshati dikur dhe sot	92
Mësimi 32: Qyteti dikur dhe sot	94
Mësimi 33: Degët e ekonomisë	96
Mësimi 34: Vendi im dhe ekonomia	98
Mësimi 35: Njerëzit që nuk harrohen	100
Mësimi 36: Kultura - pasuri kombëtare	102
Mësimi 37: Ruajmë traditat tona	104
Mësimi 38: Kulturat janë të shumëllojshme	106
Mësimi 39: Institucionet kulturore	108

Mësimi 40: Veshjet tradicionale	110
Mësimi 41: Pjesëmarrja jonë në festë	112
Mësimi 42: Shfrytëzimi i pasurive natyrore	114
Mësimi 43: Shfrytëzimi i pasurive nëntokësore	116
Mësimi 44: Shfrytëzimi i pasurive mbitokësore	118
Mësimi 45: Shfrytëzimi i arsyeshëm i pasurive natyrore	120
Mësimi 46: Pasuritë humane	122
Mësimi 47: Ruajmë trashëgiminë kulturore	124
Mësimi 48: Kujdesi shëndetësor	126
Mësimi 49: Ndihmojmë për një mjedis të pastër	128
Mësimi 50: Njeriu mbron natyrën	130
Mësimi 51: Ndotja e ujërave	132
Mësimi 52: Ndotja e tokës	134
Mësimi 53: T'i ruajmë tokën dhe pyjet	136
Mësimi 54: Transporti publik dhe ekologjik	138
Mësimi 55: Si riciklohen mbetjet?	140
Mësimi 56: Kujdesi për higjienën në komunitet	142
Mësimi 57: Unë dhe ti	144

Të dashur mësues dhe mësuese,

Ky libër është hartuar me qëllimin për t'ju ardhur në ndihmë për zhvillimin e mësimit, mbështetur në metodologjitë më të përparuara bashkëkohore.

Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar nëpër vështirësi të ndryshme dhe në shkolla janë përdorur metoda tradicionale të mësimdhënies. Sot kemi mundësinë që arsimimi t'i pajisë nxënësit me kompetencat që u nevojiten, për ta formësuar jetën e tyre dhe për të kontribuar në shoqëri. Për ta realizuar këtë synim, shtëpia botuese "Dukagjini" aplikon metodologji bashkëkohore të mësimdhënies ndërvepruese në librat e mësuesve, që ka për qëllim t'ju ndihmojë të gjeni përgjigje për pyetjen themelore: Çfarë metodologjie do të përdorni për të ndërtuar e krijuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që do t'u nevojiten nxënësve të Republikës së Kosovës për ta formësuar të ardhmen e tyre?

Integrimi në hapësirën arsimore të shekullit të 21-të kërkon, midis të tjerash, modernizimin e metodave ekzistuese të mësimdhënies dhe të të nxënit, futjen e veprimtarive bashkëkohore në mësim, që mundësojnë përgatitjen e një individi aktiv, të pavarur dhe të lirë, të pajisur me shprehje të menduarit kritik, krijues, komunikues dhe bashkëpunues, i aftë për t'i përmbushur kërkesat e shoqërisë së sotme.


Cilësia e re e të nxënit dhe e mësimdhënies përbën përparësi absolute për arsimin. Ju nuk jeni vetëm burime informacioni, por nga ju kërkohet edhe të përdorni metoda dinamike të mësimdhënies, të quajtura edhe metoda mësimore ndërvepruese, të cilat përbëjnë elementet bazë të këtij modeli, për t'i motivuar nxënësit që të angazhohen maksimalisht në mësim.

Modeli i këtyre librave dhe mësimet janë hartuar me profesionalizëm, përkushtim dhe përgjegjësi maksimale.

UDHËRRËFYES për konceptimin e mësimëve model

Faqja në të majtë


- Këto janë të dhëna identifikuese, të cilat orientojnë për mësimin.
- Mësimi synon që, përmes rezultateve të të nxënës, të kontribuojnë në një ose disa prej kompetencave.
- Rezultatet specifike janë në koherencë me ato të fushës.
- Të gjitha mjetet dhe materialet, e çdo lloji, që shërbejnë për konkretizim në ndihmë të të nxënës.
- Parashikimi është faza e parë e orës mësimore që siguron përqendrimin dhe aktivizimin e nxënësve në mësim.



- Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes.
- Rezultatet e të nxënës të temës janë në koherencë me ato të orës mësimore; tema është më e gjerë.
- Rezultatet specifike të të nxënës janë ato mbi të cilat ndërtohet mësimi.
- Janë zbrëthim i rezultateve të të nxënës sipas niveleve të arritjes. Përcaktohen me nxënësit në klasë.
- Zakonisht, mësimi ka lidhje me lëndë dhe fusha të tjera, të cilat evidentoohen.

Faqja në të djathtë

- Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësuesin gjatë përgatitjes.
- Vlerësimi formues në raport me rezultatet e të nxënës.
- Vetëreflektim dhe vetëvlerësim për orën mësimore në raport me arritjen e rezultateve të nxënësve.



- Përpunimi i përmbajtjes është faza e dytë e orës mësimore, ku bëhet përzgjedhja e materialit mësimor dhe organizimin metodologjik të tij.
- Përfundimi është faza e tretë e orës mësimore, ku bëhet integrimi i dijeve dhe shprehjeve, si dhe zbatimi i tyre.

Përshkrim i rubrikave kryesore të orës së mësimin

Rezultatet e të nxënës të temës janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme, të cilat janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore për lëndën dhe rezultateve të të nxënës për këtë temë. Në këtë rast, mund të merren nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese me Kurrikulën Bërthamë, por edhe mund të hartohen vetë, mund të jenë një, dy a më shumë rezultate. Një rezultat i të nxënës të lëndës mësimore mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore - kjo varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxënës dhe nga elementet përbërëse të tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: Duke filluar nga klasa e tretë e më lart, nxënësit zotërojnë operacionet mendore, të menduarit e tyre është konkret me elemente të të menduarit abstrakt, prandaj mësimi me këta nxënës kalon në tri faza. Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht në rezultatet e tyre, bëhet përmes fushës kurrikulare e cila kontribuon në arritjen e rezultateve të kompetencave. Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zërthehen në rezultate të të nxënësve. Ato janë pjesë e Kurrikulës Bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga nxënësit, me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: Shprehin kërkesat thelbësore të arritjes në fushën kurrikulare, drejt zotërimit të kompetencave kryesore, në përfundim të shkallës. Ato përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë nxënësi në fund të shkallës a nivelit dhe shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Vendosen rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temën mësimore.

Rezultatet e të nxënësve: Rezultatet specifike të të nxënësve janë ato mbi të cilat ndërtohet ora e mësimi, të cilat përbëjnë detajimin e rezultateve të të nxënësve të temës e që janë në koherencë me ato të fushës së kurrikulës.

Kriteret e vlerësimit/suksesit: Janë zërthim i rezultateve të të nxënësve sipas niveleve të arritjes dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit. Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Metodologjia dhe veprimtaritë me nxënësit - hapat e zhvillimit të mësimi: Mësimi zhvillohet përmes hapave, duke nxitur të menduarit logjik e kritik të nxënësit, duke pasur parasysh fazat e zhvillimit sipas Piazhesë.

Çfarë simbolizon modeli me tri pamje të ndryshme të ciklit të jetës së bimës së grurit në tri fazat e mësimi?

Mbillet një farë. Pasi është bërë puna themelore e fillimit, mësuesi/ja vazhdon dhe fara e grurit lëshon rrënjë, kështu që bima rritet. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Cikli i jetës së grurit, nga fara në tokë, në bimë, e prapë në farë, sugjeron, gjithashtu, ciklin e vazhdueshëm të shkollimit, përmes mbështetjes në njohuritë ekzistuese, për të ecur më tej përpara.



Parashikimi: Përgatitja për të nxënësit

Në fazën e parashikimit mbillet një farë në një truall pjellor. Mësimi duhet të mbështetet edhe në njohuritë ekzistuese të nxënësve, ashtu si fara që merr ushqim nga trualli ku është mbjellë.

Kjo është faza e parë e strukturës për zhvillimin e të menduarit dhe të nxënësve, kryhen veprimtari të ndryshme njohëse, nxënësi është i përfshirë gjallërisht në rikujtimin e asaj ç'ka di rreth temës së mësimi, bën lidhjen e njohurive të reja me ato që dihen. Nxënësit ndërtojnë njohuritë, konceptet, kuptimin e ri mbi dukuritë e caktuara nga bazat e njohurive të mëparshme.



Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mësimi vazhdon me fazën e ndërtimit të njohurive; fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kjo është faza e dytë e strukturës për zhvillimin e të menduarit të nivelit të lartë gjatë të nxënësve dhe nxënësi është i përfshirë në procesin e përfundimit të kuptimit të njohurive, gjithashtu ruan interesin dhe ritmin e vendosur gjatë fazës së parashikimit.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve

Mësimi përfundon me fazën e përforcimit. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Në këtë fazë, nxënësit konsolidojnë të nxënësit e ri dhe, në mënyrë të gjallë, ristrukturojnë skemën e tyre për të përshtatur konceptet e reja dhe për t'i zbatuar ato.

HYRJE

Konceptimi dhe ndërtimi i librit për mësuesin

SHOQËRIA DHE MJEDISI 4

Njohuritë nga fusha *Shoqëria dhe mjedisi* janë pjesë e mozaikut të gjerë, të përbërë nga fushat kurrikulare, përmes të cilave, nxënësi arrin qëllimet e përcaktuara në Kornizën Kurrikulare. *Shoqëria dhe mjedisi* është njëra nga shtatë fushat kurrikulare të parapara në Kornizën Kurrikulare e cila zhvillon te nxënësi njohuritë, shkathtësitë dhe kultivon vlerat dhe qëndrimet demokratike, individuale e shoqërore, duke zhvilluar prirjet e qytetarit të përgjegjshëm për proceset shoqërore e mjedisore. Kjo fushë e ndihmon nxënësin për të zhvilluar të kuptuarit e tij për botën, për njerëzit, për vlerat, për proceset mjedisore në kohë dhe hapësirë, në vende dhe rrethana të ndryshme. Njohuritë nga kjo fushë gjithashtu mundësojnë që nxënësi të kultivojë identitetet personal, shoqëror, kulturor, shtetëror e kombëtar, të kultivojë të mësuarit për të jetuar së bashku me të tjerët, si dhe edukimin për zhvillim të qëndrueshëm.

Në fushën *Shoqëria dhe mjedisi*, mësimi realizohet me përmbajtje të integruara, përmes rezultateve të cilat e përcjellin zhvillimin njohës, psikofizik dhe emocional te nxënësi, duke zhvilluar tek ai tiparet e qytetarit të përgjegjshëm, krijues dhe vendimmarrës.

Udhëzime metodologjike

Për të realizuar qëllimet e kurrikulës, përmes fushës *Shoqëria dhe mjedisi*, këshillohet përdorimi i metodave të ndryshme që plotësojnë njëra-tjetrën dhe që mundësojnë zhvillimin e të menduarit kritik e krijues te nxënësi, për zbatimin e njohurive dhe shkathtësive në situata të ndryshme.


Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësuesit/es të/së fushës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes tematike mësimore dhe të rezultateve të kompetencave për shkallën e dytë kurrikulare, me bazë didaktike dhe me nivelin e formimit të nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë maksimumin e potencialit që zotëron brenda vetes.

Mësuesi/ja është i/e lirë të përdorë metoda mësimore bashkëkohore ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, teknika e forma të shumëllojta të punës dhe një kompleks të tërë procedurash. Këto metoda duhet të jenë në funksion të nxitjes së mendimit të pavarur, kritik e krijues. Metodatat dhe teknikat e punës me nxënës lipset të jenë të kombinuara dhe të shumëllojta, në funksion të arritjeve të rezultateve të të nxënësve dhe të zbatimit në jetën e përditshme.

Metodologjia ndërvepruese në mësimdhënie dhe të nxënësve

Libri që keni në duar, është hartuar për t'ju pajisur me metodologjinë ndërvepruese në ndërtimin e dijeve dhe formimin e shkathtësive. Ai trajton temat mësimore në përputhje me "Kurrikulën Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës" (2016), si edhe të gjitha dokumentet dhe udhëzimet administrative në fuqi, ku është mbështetur metodologjia me të gjitha elementet përbërëse, duke filluar me kontributin në kompetencat kryesore dhe rezultatet e të nxënësve të fushës, rezultatet specifike të të nxënësve të njësisë mësimore, mjetet e punës, ecurinë metodologjike të orës së mësimi e deri te vlerësimi i nxënësve. Një nga risitë e këtij libri është se përmban edhe një rubrikë: *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore*. Qëllimi i kësaj rubrike është që t'ju ndihmojë të mbani shënime për punën tuaj në klasë, arritjet, por edhe mosarritjet, dhe më pas të reflektoni kur të bëni përsëritje, të kontrolloni dijet dhe të bëni vlerësimin e nxënësve, por edhe kur të zhvilloni mësimin një vit apo disa vjet më pas.

Në aspektin metodologjik të hartimit të modeleve orientuese për çdo orë mësimi, është bërë kujdes i veçantë në harmonizimin e të gjitha veprimtarive. Marrëdhëniet midis rezultateve të të nxënit - procedurave të mësimdhënies dhe të nxënit - vlerësimit, përbëjnë atë që në metodologjinë e sotme quhet 'trekëndëshi magjik'. Trekëndëshi paraqet marrëdhënien koherente midis rezultateve të të nxënit, veprimtaritë e mësimdhënies/të nxënit dhe vlerësimin. Këta tre komponentë janë në koherencë me njëri-tjetrin, me qëllim që nxënësit të inkurajohen për të mësuar, të jenë pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e dijes dhe të shkathhtësive.




Zgjeroni dhe thelloni dijet Për më shumë lexoni në: Musai. B. (2014) *Metodologji e mësimdhënies*. Tiranë: CDE, faqe 101-128.

Metodologjia e çdo teme zhvillohet në mënyrë pamore rreth mësimi të librit të nxënësit, e cila ju ndihmon ta shikoni atë pa pasur nevojën që ta keni pranë. Përdorimi i kësaj mënyre të paraqitjes metodologjike të mësimi ka dhënë rezultate mjaft të mira.

Metodologjia ndërvepruese ka si qëllim përfshirjen aktive të nxënësve në ndërtimin e dijes dhe formimin e shprehive. Zhvillimi i nxënësve që mendojnë në mënyrë kritike e që janë krijues, është në qendër të metodave të mësimdhënies, të mënyrave të të nxënit e të çdo veprimtarie tjetër, me synim zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë. Por, nga ana tjetër, jemi mbështetur edhe në parimet e psikologjisë së edukimit, kryesisht të zhvillimit njohës sipas moshave, me konsideratë të veçantë Zonën e zhvillimit proksimal të Vigotskit, e cila është zona midis nivelit aktual të zhvillimit të fëmijës sipas përcaktimit të aftësive për zgjidhjen e pavarur të problemeve dhe nivelit të zhvillimit që fëmija është në gjendje të arrijë, përmes orientimit të të rriturve, apo në bashkëpunim me bashkëmoshtarët e tij më të aftë. Kjo është një hapësirë dinamike ku mësimdhënja mund të japë rezultate e ndodhet diku midis asaj që nxënësi di dhe asaj që nxënësi nuk është gati të mësojë. Zona e zhvillimit proksimal është hapësira e mësimi midis të së mërzitshmes dhe të së pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga mësuesi apo nga një bashkëmoshtar mund të bëjë që mësimi të japë rezultat.

Zgjeroni dhe thelloni dijet Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011) *Psikologji edukimi*. Tiranë: CDE, faqe 47-51.



Burimi: Psikologji edukimi, (faqe 47), A. Woolfolk, 2011. Botuar në Tiranë: CDE



Zgjeroni dhe thelloni dijet Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011) Psikologji edukimi. Tiranë: CDE, faqe 32-36.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 2

I Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv	
1.	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë.
2.	Shkruan një tekst deri në një faqe (500 fjalë) e më shumë për një temë të caktuar.
3.	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje: pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.
4.	Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërën nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.
5.	Merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike në harmoni me moshën e vet, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.
6.	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo ndonjë ngjarjeje nga jeta, bën dallimin e tyre duke bërë një listë me vetitë që i pëlqejnë dhe që nuk i pëlqejnë tek ata, diskuton rreth tyre, performon rolin e njerit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarë.
7.	Shpreh në formë verbale dhe të shkruar, fjali të thjeshta në gjuhë të huaj dhe përkthen në gjuhë amtare fjali të tjera të thjeshta që i dëgjon nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësuesi/ja në gjuhë të huaj të dhëna si detyrë.
8.	Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
1.	Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njëres nga format shprehëse.
2.	Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera).
3.	Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
4.	Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkencat e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme.
5.	Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.
6.	Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore - historike) në njërën nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.
7.	Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyrë të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minutash.
8.	Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë, sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitive në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimet) të tyre.

III. Kompetenca e të nxënës – Nxënës i suksesshëm	
1.	Parashtron pyetje që nxësin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njëres nga format e shprehjes.
2.	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.
3.	Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje caktuar, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme).
4.	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.
5.	Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar.
6.	Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigjimeve të nevojshme.
7.	Identifikon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.
8.	Menaxhon sjelljet e veta, materialet/mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti individual apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj.
9.	Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinën për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
1.	Përgatit një autobiografi në të cilën prezanton veten me të dhënat personale dhe me prirjet për fusha të caktuara duke i gjetur të përbashkëtat me profesionet e dëshiruara.
2.	Përgatit një plan pune për një javë dhe specifikon aktivitetet më me prioritet duke arsyetuar përzgjedhjen e tyre.
3.	Përgatit një projekt të vogël duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupon atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.
4.	Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.
5.	Debaton me moshatarë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë-laborator, në shkollë dhe në mjedise të tjera apo për një grup të caktuar njerëzish për një situatë të caktuar duke mbrojtur idetë e veta me shembuj konkretë.
6.	Identifikon ushqimet më të shpeshta, materialet e tjera shpenzuese të familjes apo harxhimet vetjake dhe llogarit shpenzimet për një javë, të dhënat e gjetura i paraqet në formë tabelare/grafike apo në një formë tjetër.
7.	Lexon etiketën, udhëzuesin e produkteve të ndryshme (rrobave, ushqimit, barnave apo të teknikës) dhe jep sqarim për prejardhjen, përmbajtjen, përdorimin, mënyrën e mirëmbajtjes apo për rreziqet në rast mospërdorimi të drejtë-adekuat.
8.	Paraqet në formë tabelare, grafike, të vizatimit apo në një formë tjetër, aktivitetet e kujdesit që i bën ndonjë qenieje të gjallë, të cilat i mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të tij/saj.

V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

1.	Prezanton para të tjerëve mënyrën e zbatimit të rregullave themelore të higjienës personale (fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit, ku jeton dhe vepron, përmes formave të ndryshme të shprehjes.
2.	Merr pjesë në aktivitete fizike-lojëra lëvizore dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer, menaxhon emocionet e veta dhe prezanton para të tjerëve gjendjen fizike dhe shpirtërore pas realizimit të një aktiviteti fizik apo loje sportive.
3.	Përgatit një listë (me njërin nga format e shprehjes, shkrim, vizatim etj.) me ushqime të cilat i konsumon familja duke i renditur ato sipas kalorisë dhe më pas i klasifikon në ushqime të shëndetshme dhe më pak të shëndetshme.
4.	Lexon të dhënat në paketim të ushqimit dhe diskuton në grup për këto të dhëna (vlerat ushqyese, afatet e prodhimit etj.).
5.	Identifikon përparësitë dhe mangësitë e personalitetit të vet dhe jep mendime për mënyrën e përmirësimit, në forma të ndryshme shprehëse.
6.	Propozon alternativa për zgjidhjen konstruktive të një konflikti ndërpersonal duke i analizuar paraprakisht me kujdes rrethanat që kanë shkaktuar konfliktin, ndan përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.
7.	Dallon dhe përshkruan rolet e personave dhe shërbimeve të nevojshme për kërkimin e ndihmës në situata të caktuara të rrezikut të shëndetit të vet, fizik dhe mendor.
8.	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkollë apo jashtë saj).
9.	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

1.	Paraqet në forma të ndryshme të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të familjes së vet dhe i diskuton ato me të tjerët, më pas i krahason me të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve, mësuesve dhe stafit menaxhues në shkollë apo me pjesëtarët e ndonjë institucioni.
2.	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.
3.	Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh., besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti-mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga ato.
4.	Manifeston veprime që shprehin mirësjellje në situata të ndryshme dhe me shembull konkret tregon përdorimin e tyre në klasë/shkollë, në familje e në komunitet.
5.	Propozon dhe ndan mendimin me shokët/shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësues, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre.
6.	Merr pjesë në hartimin e rregullave të lojës, në klasë, në shkollë (p.sh., si propozues rregullash, menaxhues i propozimeve nga të tjerët etj.) dhe argumenton rëndësinë e respektimit të ndonjërit rregull të propozuar në forma të ndryshme të shprehjes, duke parashikuar pasojat e moszbatimit të saj.
7.	Identifikon dy e me shumë organizime shoqërore dhe përshkruan (në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër) mënyrat/mundësitë se si njerëzit e ndryshëm, me përvoja të ndryshme, mund të organizojnë diçka të përbashkët.
8.	Prezanton në mënyrë kronologjike ndryshimet e familjes dhe të rrethit në aspekte të ndryshme (si: objektet e banimit, festat, veshjet, ushqimet-mënyra e të ushqyerit, menaxhimi i ekonomisë familjare, të drejtat, përgjegjësitë dhe vendimmarrja në familje etj.) ose disa nga personalitetet dhe ngjarjet kryesore të popullit të vet, duke e dalluar të tashmen nga e kaluara.
9.	Paraqet me shembuj konkretë sjelljet që duhen manifestuar në rast rreziku nga fatkeqësitë natyrore apo të krijuara nga njeriu, si: zjarri, vërshimi, tërmeti, komunikimi me njerëz të panjohur etj.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS SHOQËRIA DHE MJEDISI **Shkalla 2**

I. NJOHURITË, TË KUPTUARIT, SHKATHTËSITË që zhvillohen	
1. Mëson për vetveten, strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e përfshirjes në to: Nxënësi/ja:	
1.	Identifikon dhe krahason dëshmi të thjeshta (objekte, mjete, fotografi, veshje dhe gjëra të tjera) që lidhen me ngjarje personale, familjare dhe të komunitetit ku jeton dhe i klasifikon sipas kronologjisë.
2.	Dallon strukturën e grupeve të ndryshme shoqërore, si p.sh.: familja, shkolla etj., dhe mund të bëjë krahasime si kanë qenë ato dikur dhe si janë tani.
3.	Kupton dhe respekton të drejtat e njeriut dhe të drejtat themelore të fëmijëve si mënyra më e mirë për mbrojtjen e individëve dhe bashkësisë nga padrejtësitë.
2. Njeh rëndësinë e monumenteve, dukurive, proceseve historike, shoqërore, natyrore e mjedisore, si dhe lidhjet dhe ndikimet ndërmjet tyre Nxënësi/ja:	
1.	Identifikon ngjarje shoqërore, kulturore e historike të nivelit lokal, vendor, kombëtar e më gjerë dhe shkaqet që i sillen ato.
2.	Kupton rëndësinë e objekteve, dukurive dhe proceseve shoqërore, natyrore e mjedisore në nivel lokal, vendi, regjional dhe botëror.
3.	Tregon respekt për trashëgiminë kulturore e natyrore si dhe shpreh solidaritet në proceset shoqërore ku ai është i përfshirë.
3. Njeh dhe mëson të zbatojë normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet: Nxënësi/ja:	
1.	Dallon llojllojshmërinë e etnive, kulturave, racave, besimeve, profesioneve në shoqëri dhe shpreh respekt për këtë diversitet.
2.	Tregon ndërgjegjshmëri për dallimet gjinore, liritë dhe të drejtat e njeriut dhe demonstroi tolerancë dhe solidaritet në komunikim dhe bashkëpunim me të tjerët.
4. Përfshihet në dhënien e ideve, propozimeve dhe merr vendime në mënyrë të përgjegjshme: Nxënësi/ja:	
1.	Identifikon dhe shpjegon faktorët që duhet të marrë parasysh me rastin e marrjes së vendimeve në situata të ndryshme nga jeta e përditshme.
2.	Kupton nivelet e ndryshme të vendimmarrjes në institucione dhe shoqëri, dikur dhe tani, dhe i respekton ato në veprimet e tij.
5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm: Nxënësi/ja:	
1.	Shpjegon disa nga shkaqet dhe pasojat e rreziqeve natyrore e shoqërore si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe veprimeve të njeriut dhe merr pjesë në aktivitete për ruajtjen e mjedisit dhe përkujdesjen për trashëgiminë.
2.	Bashkëpunon me të tjerët dhe ndërmerr veprime të dobishme që promovojnë mjedisin e pastër, kujdeset për përdorim të drejtë të të mirave jetësore, për higjienën e përgjithshme dhe për atë personale.

6. Shfrytëzohet në mënyrë efektive Teknologjinë e Informimit dhe të Komunikimit (TIK) dhe teknologjitë e tjera bashkëkohore:

Nxënësi/ja:

1.	Shfrytëzohet TIK-un dhe mjetet multimediale për t'i plotësuar dhe thelluar njohjet për ngjarjet dhe dukuritë kulturore, historike e natyrore.
2.	Demonstron shkathhtësi në përdorimin e TIK-ut dhe medias për nevojat e mësimit, prezantimit dhe komunikimit.
3.	Demonstron sjellje të përgjegjshme të përdorimit të drejtë të teknologjisë në harmoni me rregullat për ruajtjen e mjedisit.

II. QËNDRIMET DHE VLERAT që zhvillohen

- Respekti për të tjerët;
- Vetërespekti;
- Barazia;
- Toleranca;
- Mirëkuptimi (për tjetrin ndryshe);
- Reagimi (ndaj dukurive negative);
- Empatia;
- Altruizmi;
- Gjykimi i drejtë;
- Kujdesi për mjedisin;
- Solidariteti;
- Qëndrimi miqësor ndaj shoqërisë dhe mjedisit;
- Kujdesi për trashëgiminë.

III. AFTËSITË DHE SHKATHËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja:

- Shfrytëzimi i burimeve;
- Krijimi i modeleve;
- Diskutimi;
- Matja;
- Skicimi;
- Ndërtimi dhe leximi i grafikëve, diagrameve, tabelave dhe hartave;
- Përdorimi me vend i informacioneve;
- Huluntimi;
- Përdorimi i saktë i termave të mësuar.

Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës: SHOQËRIA DHE MJEDISI Klasa IV

Lëndët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 2 (Klasa e IV)
	GJYSMËVJETORI I		GJYSMËVJETORI II		
	shtator—tetor	nëntor—dhjetor	janar—shkurt—mars	prill—maj—qershor	
Shoqëria dhe mjedisi	<ul style="list-style-type: none"> - Lidhjet dhe bashkëpunimi me të tjerët - Secili ka të drejta dhe përgjegjësi - Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve 	<ul style="list-style-type: none"> - Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve - Mendime të ndryshme, vendime të përbashkëta - Vendi ku jetoj 	<ul style="list-style-type: none"> - Vendi ku jetoj - Jeta në Kosovë dikur dhe sot - Traditat dhe trashëgimia jonë - Resurset dhe trashëgimia e vendit tim 	<ul style="list-style-type: none"> - Resurset dhe trashëgimia e vendit tim - Mjedisi i vendit tim 	<ul style="list-style-type: none"> I Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv 1, 3, 4, 5, 6, 8 II Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8 III Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 IV Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribuues produktiv 1, 3, 4, 5, 8 V Kompetenca personale – Individ i shëndoshë 1, 5, 6, 7, 8, 9 VI Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8,9

PLANI DYMUJOR: SHTATOR—TETOR

Lënda mësimore: SHOQËRIA DHE MJEDISI

Fusha e kurrikulës: SHOQËRIA DHE MJEDISI

Klasa: IV

Temat mësimore:

- Lidhjet dhe bashkëpunimi me të tjerët
- Secili ka të drejta dhe përgjegjësi
- Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve

RNK - Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:	
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv	
I.1	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë;
I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje: pyetje, komente ose sqarime për temën e dhënë;
I.4	Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërin nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.;
I.8	Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
II.1	Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njëres nga format shprehëse;
II.2	Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera).

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm	
III.2	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar;
III.3	Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shënjuar me shenja të ndryshme);
III.9	Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinën për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribuues produktiv	
IV.1	Përgatit një autobiografi në të cilën prezanton veten me të dhënat personale dhe me prirjet për fusha të caktuara duke i gjetur të përbashkëtat me profesionet e dëshiruara;
IV.6	Identifikon ushqimet më të shpeshta, materialet e tjera shpenzuese të familjes apo harxhimet vetjake dhe llogarit shpenzimet për një javë, të dhënat e gjetura i paraqet në formë tabelare/grafike apo në ndonjë formë tjetër.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.3	Përgatit një listë (me njërën nga format e shprehjes, shkrim, vizatim etj.) me ushqime të cilat i konsumon familja duke i renditur ato sipas kalorisë dhe më pas i klasifikon në ushqime të shëndetshme dhe më pak të shëndetshme;
V.5	Identifikon: përparësitë dhe mangësitë e personalitetit të vet dhe jep mendime për mënyrën e përmirësimit, në forma të ndryshme shprehëse;
V.8	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkollë apo jashtë saj).

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.1	Paraqet në forma të ndryshme të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të familjes së vet dhe i diskuton ato me të tjerët, më pas i krahason me të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve, mësuesve dhe stafit menaxhues në shkollë apo me pjesëtarët e ndonjë institucioni;
VI.2	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët;
VI.3	Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh., besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti-mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga ato;
VI.8	Prezanton në mënyrë kronologjike ndryshimet e familjes dhe të rrethit në aspekte të ndryshme (si: objektet e banimit, festat, veshjet, ushqimet-mënyrat e të ushqyerit, menaxhimi i ekonomisë familjare, të drejtat, përgjegjësitë dhe vendimmarrja në familje etj.) ose disa nga personalitetet dhe ngjarjet kryesore të popullit të vet, duke e dalluar të tashmen nga e kaluara.

RNF - Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

1.1	Identifikon dhe krahason dëshmi të thjeshta (objekte, mjete, fotografi, veshje dhe gjëra të tjera) që lidhen me ngjarje personale, familjare dhe të bashkësisë ku jeton dhe i klasifikon sipas kronologjisë;
1.2	Dallon strukturën e grupeve të ndryshme shoqërore si p.sh.: familja, shkolla etj., dhe mund të bëjë krahasime si kanë qenë ato dikur dhe si janë tani;
1.3	Kupton dhe respekton të drejtat e njeriut dhe të drejtat themelore të fëmijëve si mënyra më e mirë për mbrojtjen e individëve dhe bashkësisë nga padrejtësitë;
3.1	Dallon llojllojshmërinë e etnive, kulturave, racave, besimeve, profesioneve në shoqëri dhe shpreh respekt për këtë diversitet;
3.2	Tregon ndërgjegjshmëri për dallimet gjinore, liritë dhe të drejtat e njeriut dhe demonstroi tolerancë dhe solidaritet në komunikim dhe bashkëpunim me të tjerët.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p>- Lidhjet dhe bashkëpunimi me të tjerët</p> <p>- Secili ka të drejta dhe përgjegjësi</p> <p>- Mirë-kuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve</p>	<p>- Dallon grupet dhe komunitetet në mjedisin ku jeton dhe përshkruan ndryshimet ndërmjet tyre;</p> <p>- Jep ide dhe merr hapa për një veprimtari të përbashkët me 84 grupet dhe/ose komunitetet e tjera në klasë, shkollë, lagje, vendbanim;</p> <p>- Vlerëson efektet pozitive të bashkëveprimtimit me të tjerët dhe punës vullnetare (brenda klasës, shkollës, lagjes dhe më gjerë);</p> <p>- Shpjegon ndërlidhjen midis të drejtave dhe përgjegjësisë dhe ilustron me shembuj nga situata jetësore në klasë, shkollë, lagje dhe/ose më gjerë;</p> <p>- Dallon shkeljet e të drejtave të njeriut dhe identifikon institucionet për mbrojtjen e tyre;</p> <p>- Jep ide dhe merr pjesë në veprime të cilat janë në funksion të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve;</p> <p>- Respekton dhe vlerëson dallimet kulturore, gjinore, etnike, fetare dhe personalitetet me nevoja të veçanta në klasë, shkollë, lagje dhe më gjerë;</p> <p>- Respekton mendimet ndryshe të të tjerëve, pranon të tjerët ashtu siç janë dhe i trajton në mënyrë të barabartë.</p> <p>- Vlerëson solidaritetin si vlerë njerëzore dhe merr pjesë në aktivitete përkrahëse për njëri-tjetrin në shkollë dhe mjedis shoqëror.</p>	<ol style="list-style-type: none"> Unë po rritem Komuniteti ynë Grupet shoqërore E mira jonë e përbashkët Së bashku ia dalim “Puna vullnetare na bashkon” (veprimtari 1) Të drejtat dhe përgjegjësitë e mia Institucionet që na mbrojnë Vizitë në një qendër shëndetësore (veprimtari 2) Respektojmë diversitetin kulturor Ndihem i/e barabartë Mendimi ndryshe Shumëllojshmëria fetare në vendin tonë Vlerat njerëzore Solidariteti - vlerë Barazi për të gjithë Toleranca dhe miqësia 	17 orë	<ul style="list-style-type: none"> - Metodologjitë: Mësimdhënia dhe të nxënësve bazuar në arritjen e kompetencave; - Mësimdhënia dhe të nxënësve integruar; - Mësimdhënia dhe të nxënësve diferencuar. - Teknikat: <ol style="list-style-type: none"> Stuhi mendimesh; Dramatizim me role; Rrjet diskutimi. 	<p>Gjuhë shqipe</p> <p>Matematikë</p> <p>Shkencat e natyrës</p> <p>Shkathësi për jetë</p> <p>Edukimi për qytetari demokratike</p> <p>Edukimi për mjedis</p>	<p>Shoqëria dhe mjedisi 4</p> <p>Shoqëria dhe mjedisi 4 - Fletore pune</p> <p>Burime nga interneti</p>

PLANI DYMUJOR: NËNTOR—DHJETOR

Lënda mësimore: SHOQËRIA DHE MJEDISI

Fusha e kurrikulës: SHOQËRIA DHE MJEDISI

Klasa: IV

Temat mësimore:

- Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve
- Mendime të ndryshme, vendime të përbashkëta
- Vendi ku jetoj

RNK - Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv

I.1	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë;
I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje: pyetje, komente ose sqarime për temën e dhënë;
I.8	Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.2	Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera);
II.3	Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).

Kompetenca e të nxënimit – Nxënës i suksesshëm

III.1	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njëres nga format e shprehjes;
III.2	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar;
III.9	Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribuues produktiv

IV.1	Përgatit një autobiografi në të cilën prezanton veten me të dhënat personale dhe me prirjet për fusha të caktuara duke i gjetur të përbashkëtat me profesionet e dëshiruara;
IV.5	Debaton me moshatarë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë-laborator, në shkollë dhe në mjedise të tjera apo për një grup të caktuar njerëzish për një situatë të caktuar duke mbrojtur idetë e veta me shembuj konkretë.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë	
V.5	Identifikon: përparësitë dhe mangësitë e personalitetit të vet dhe jep mendime për mënyrën e përmirësimit, në forma të ndryshme shprehëse;
V.8	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm	
VI.2	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët;
VI.3	Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh., besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti-mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga ato;
VI.4	Propozon dhe ndan mendimin me shokët/shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësimor, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre.
VI.8	Prezanton në mënyrë kronologjike ndryshimet e familjes dhe të rrethit në aspekte të ndryshme (si: objektet e banimit, festat, veshjet, ushqimet-mënyrat e të ushqyerit, menaxhimi i ekonomisë familjare, të drejtat, përgjegjësitë dhe vendimmarrja në familje etj.) ose disa nga personalitetet dhe ngjarjet kryesore të popullit të vet, duke e dalluar të tashmen nga e kaluara.

RNF - Rezultatet e të nxënimit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:	
3.1	Dallon llojllojshmërinë e etnive, kulturave, racave, besimeve, profesioneve në shoqëri dhe shpreh respekt për këtë diversitet;
3.2	Tregon ndërgjegjshmëri për dallimet gjinore, liritë dhe të drejtat e njeriut dhe demonstroi tolerancë dhe solidaritet në komunikim dhe bashkëpunim me të tjerët;
4.1	Identifikon dhe shpjegon faktorët që duhet të ketë parasysh me rastin e marrjes së vendimeve në situata të ndryshme nga jeta e përditshme;
4.2	Kupton nivelet e ndryshme të vendimmarrjes në institucione dhe shoqëri, dikur dhe tani, dhe i respekton ato në veprimet e tij;
1.1	Identifikon dhe krahason dëshmi të thjeshta (objekte, mjete, fotografi, veshje dhe gjëra të tjera) që lidhen me ngjarje personale, familjare dhe të bashkësisë ku jeton dhe i klasifikon sipas kronologjisë;
1.2	Dallon strukturën e grupeve të ndryshme shoqërore si p.sh.: familja, shkolla etj., dhe mund të bëjë krahasime si kanë qenë ato dikur dhe si janë tani.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p>Mirë-kuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve</p> <p>- Men-dime të ndryshme, vendime të përbashkëta</p> <p>- Vendi ku jetoj</p>	<p>- Respekton dhe vlerëson dallimet kulturore, gjinore, etnike, fetare dhe personat me nevojë të veçanta në klasë, shkollë, lagje dhe më gjerë;</p> <p>- Respekton mendimet ndryshe të të tjerëve, pranon të tjerët ashtu siç janë dhe i trajton në mënyrë të barabartë.</p> <p>- Vlerëson solidaritetin si vlerë njerëzore dhe merr pjesë në aktivitete përkrahëse për njëri-tjetrin në shkollë dhe mjedis shoqëror;</p> <p>- Përshkruan situata të ndryshme jetësore të bashkëndënjës dhe të mbështetjes shokut, shoqes, anëtarëve të familjes dhe të tjerëve në të mirë dhe në të keq.</p> <p>- Tregon gatishmëri për të marrë vendime në konsultim me të tjerët duke i respektuar idetë dhe mendimet e tyre;</p>	<p>18. Mbështetim njëri-tjetrin</p> <p>19. Me mendje dhe zemër për njerëzit</p> <p>20. Si të jemi qytetarë të mirë (veprimtaria 3)</p> <p>21. Respektoj mendimin e tjetrit</p> <p>22. Hapat e vendimmarrjes</p> <p>23. Eja të vendosim së bashku</p> <p>24. Në familje vendosim së bashku</p> <p>25. Në komunitetin tonë</p> <p>26. Institucionet dhe vendimet</p> <p>27. Vendimmarrja dikur dhe sot</p> <p>28. “Si të marrë vendimin e duhur” (veprimtaria 4)</p> <p>29. Kosova atdheu im</p> <p>30. Pavarësia e Kosovës</p> <p>31. Regjionet e Kosovës</p> <p>32. Komunitetet dhe veçoritë e tyre</p> <p>33. Fqinjët e Kosovës</p>	16 orë	<p>- Metodologji të: - Mësimdhënia dhe të nxënimit e bazuar në arritjen e kompetencave; - Mësimdhënia dhe të nxënimit e integruar; - Mësimdhënia dhe të nxënimit e diferencuar.</p> <p>- Teknikat: 1. Stuhi mendimesh; 2. Dramatizim me role; 3. Rrjet diskutimi.</p>	<p>Vlerësimi formativ</p> <p>Vlerësimi i të nxënimit</p> <p>Informata kthyesë</p> <p>Listë kontrolli</p> <p>Portofolio</p>	<p>Gjuhë shqipe</p> <p>Matematikë</p> <p>Shkencat e natyrës</p> <p>Shkathësi për jetë</p> <p>Edukimi për qytetari demokratike</p> <p>Edukimi për mjedis</p>	<p>Shoqëria dhe mjedisi 4</p> <p>Shoqëria dhe mjedisi 4 - Fletore pune</p> <p>Burime nga interneti</p>

<ul style="list-style-type: none"> - Shpjegon situata të ndryshme të vendim-marrjes në jetën e përditshme dhe identifikon faktorët që janë marrë dhe që duhet të merren parasysh në raste të tilla; - Identifikon vendimmarrjen dikur dhe sot në familje, shoqëri dhe institucione dhe i shfrytëzon ato përvoja në vendimmarrjet e tij/saj; - Përshkruan festën e Pavarësisë së Kosovës dhe simbolet shtetërore të saj (stemën, flamurin, himnin); - Dallon regjionet e Kosovës dhe evidenton disa karakteristika të tyre (gjeografike, kulturore, ekonomike); - Identifikon komunitetet etnike në Kosovë, përshkruan disa veçori dhe simbolet e tyre. - ërshkruan festën e Pavarësisë së Kosovës dhe simbolet shtetërore të saj (stemën, flamurin, himnin); 									
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

PLANI TREMUJOR: JANAR—SHKURT—MARS

Lënda mësimore: SHOQËRIA DHE MJEDISI

Fusha e kurrikulës: SHOQËRIA DHE MJEDISI

Klasa: IV

Temat mësimore:

- Vendi ku jetoj
- Jeta në Kosovë dikur dhe sot
- Traditat dhe trashëgimia jonë
- Resurset dhe trashëgimia e vendit tim

RNK - Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv

I.1	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë;
I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje: pyetje, komente ose sqarime për temën e dhënë;
I.4	Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërin nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.;

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.1	Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njëres nga format shprehëse;
II.2	Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera);
II.7	Paraqet dhe arsyeton me argumente, mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyrë të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minutash.

Kompetenca e të nxënësve – Nxënës i suksesshëm

III.1	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njëres nga format e shprehjes;
III.2	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar;
III.9	Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyrë të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

IV.3	Përgatit një projekt të vogël duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupojnë atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për përfundimin e tyre etj.
------	---

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë	
V.5	Identifikon: përparësitë dhe mangësitë e personalitetit të vet dhe jep mendime për mënyrën e përmirësimit, në forma të ndryshme shprehëse;
V.8	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm	
VI.1	Paraqet në forma të ndryshme të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të familjes së vet dhe i diskuton ato me të tjerët, më pas i krahason me të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve, mësuesve dhe stafit menaxhues në shkollë apo me pjesëtarët e ndonjë institucioni;
VI.3	Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh., besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti-mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga ato;
VI.6	Merr pjesë në hartimin e rregullave të lojës, në klasë, në shkollë (p.sh., si propozues rregullash, menaxhues i propozimeve nga të tjerët etj.) dhe argumenton rëndësinë e respektimit të ndonjërës rregull të propozuar në forma të ndryshme të shprehjes, duke i parashikuar pasojat e moszbatimit të saj.
VI.7	Identifikon dy e me shumë organizime shoqërore dhe përshkruan (në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër) mënyrat/mundësitë se si njerëzit e ndryshëm me përvoja të ndryshme mund të organizojnë diçka të përbashkët.

RNF - Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:	
1.3	Kupton dhe respekton të drejtat e njeriut dhe të drejtat themelore të fëmijëve si mënyra më e mirë për mbrojtjen e individëve dhe bashkësisë nga padrejtësitë;
2.1	Identifikon ngjarje shoqërore, kulturore e historike të nivelit lokal, vendor, kombëtar e më gjerë dhe shkaqet që sollën ato;
2.2	Kupton rëndësinë e objekteve, dukurive dhe proceseve shoqërore natyrore e mjedisore në nivel lokal, vendi, regjional dhe botëror;
2.3	Tregon respekt për trashëgiminë kulturore e natyrore si dhe shpreh solidaritet në proceset shoqërore ku ai është i përfshirë;
5.1	Shpjegon disa nga shkaqet dhe pasojat e rreziqeve natyrore e shoqërore si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe veprimeve të njeriut dhe merr pjesë në aktivitete për ruajtjen e mjedisit dhe përkujdesjen për trashëgiminë.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e vlerësimit	Ndrëlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p>- Vendi ku jetoj</p> <p>- Jeta në Kosovë dikur dhe sot</p> <p>- Traditat dhe trashëgimia jonë</p> <p>- Resurset dhe trashëgimia e vendit tim</p>	<p>- Identifikon shtetet fqinje dhe simbolet e tyre me të cilat rrethohet Kosova, në materialet mësimore (hartë, atlas, glob, gazetë, libra, enciklopedi etj.) dhe mjedis të ndryshme;</p> <p>- Krahason jetën në familje dikur dhe sot, në fshat dhe qytet, si rezultat i zhvillimeve shoqërore (shkollimit dhe punësimit masiv, në veçanti të femrës, funksionimit dhe menaxhimit të familjes, zhvillimit të transportit, elektrifikimit, ujësjellësit etj.)</p> <p>- Përkrauan degët ekonomike në vendbanimin e tij dikur dhe sot dhe vlerëson ndikimin e tyre në jetën e jetëzve;</p> <p>- Identifikon personalitete kontributdhënëse të vendit ku jeton dikur dhe sot dhe përkrauan rolin e tyre në fushat përkatëse (arsim, shëndetësi, ekonomi etj.);</p> <p>- Identifikon sportet dhe sportistët, artistët dhe artistët që kanë ndikuar në shoqërinë kosovare dikur dhe sot (nga futboli, hendbolli, muzika, piktura, filmi, drama etj.);</p> <p>- Dallon ngjarje nga tradita e lashtë (dasmat, festat dhe ritet e tyre si Shën Gjergji etj.) dhe nga tradita kombëtare, shtetërore dhe përkrauan format e shënimit të tyre në familje, në shkollë, në komunitet;</p>	<p>34. “Festojmë të gëzuar Pavarësinë e Kosovës” (Veprimtaria 5)</p> <p>35. Familja dikur dhe sot</p> <p>36. Fshati dhe sot</p> <p>37. Qyteti dhe sot</p> <p>38. Degët e ekonomisë</p> <p>39. Vendi im dhe ekonomia</p> <p>40. Njerëzit që nuk harrohen</p> <p>41. Kultura - pasuri kombëtare</p> <p>42. “Mësojmë nga jeta e personaliteteve tona” (Takim)</p> <p>43. Ruajtja e traditave tona</p> <p>44. Kulturat janë të shumëllojshme</p> <p>45. Institucionet kulturore</p> <p>46. Veshjet tradicionale</p> <p>47. Pjesëmarrja jonë në festë</p> <p>48. Shfrytëzimi i pasurive natyrore</p> <p>49. Shfrytëzimi i pasurive nëntokësore</p> <p>50. Shfrytëzimi i pasurive mbitokësore</p> <p>51. Shfrytëzimi i arsyeshëm i pasurive natyrore</p>	18 orë	<p>Metodologji: Mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar në arritjen e kompetencave;</p> <p>Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar;</p> <p>Mësimdhënia dhe të nxënit e diferencuar.</p> <p>Teknikat:</p> <p>1. Stuhi mendimesh; 2. Dramatizim me role; 3. Rrjet diskutimi.</p>	<p>Gjuhë shqipe</p> <p>Matematikë</p> <p>Shkencat e natyrës</p> <p>Shkathësi për jetë</p> <p>Edukimi për qytetari demokratike</p> <p>Edukimi për mjedis</p>	<p>Shoqëria dhe mjedisi 4</p> <p>Shoqëria dhe mjedisi 4 - Fletore pune</p> <p>Burime nga interneti</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - Merr pjesë në mënyrë aktive në shënimin e ndonjë feste tradicionale në shkollën dhe komunitet; - Identifikon institucionet kulturore si teatrot, muzet, si dhe lokalitetet arkeologjike, historike dhe natyrore të vendit dhe përshkruan aktivitetet që zhvillohen në to; - Dallon veshjet e krahinave të ndryshme të Kosovës dhe disa nga tiparet karakteristike të tyre; - Mbledh dhe përkujdeset për eksponatet nga trashëgimia, jep kontribut në pasurimin e arkivës së familjes dhe muzeut të shkollës; - Përshkruan disa nga pasuritë kryesore natyrore të Republikës së Kosovës dhe shpjegon rëndësinë e shfrytëzimit racional të tyre për të mirën e gjeneratave të tanshme dhe të ardhshme; - Identifikon disa nga pasuritë humane dhe të trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës dhe shpjegon rëndësinë e tyre për vendin. 				
--	--	--	--	--	--

PLANI TREMUJOR: PRILL—MAJ—QERSHOR

Lënda mësimore: SHOQËRIA DHE MJEDISI

Fusha e kurrikulës: SHOQËRIA DHE MJEDISI

Klasa: IV

Temat mësimore: - Resurset dhe trashëgimia e vendit tim
- Mjedisi i vendit tim

RNK - Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv

I.1	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë;
I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje: pyetje, komente ose sqarime për temën e dhënë;
I.4	Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërin nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.;

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.1	Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njëres nga format shprehëse;
II.2	Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera);
II.6	Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore - historike) në njërin nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie;
II.8	Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërtimeve apo pozitave në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimit) të tyre.

Kompetenca e të nxënësve – Nxënës i suksesshëm

III.1	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njëres nga format e shprehjes;
III.2	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar;
III.9	Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyrë të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
IV.4	Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes;
IV.7	Lexon etiketën, udhëzuesin e produkteve të ndryshme (rrobave, ushqimit, barnave apo të teknikës) dhe jep sqarim për prejardhjen, përmbajtjen, përdorimin, mënyrën e mirëmbajtjes apo për rreziqet në rast mospërdorimi të drejtë-adekuat;
IV.8	Paraqet në formë tabelare, grafike, të vizatimit apo në një formë tjetër, aktivitetet e kujdesit që i bën ndonjë qenieje të gjallë, të cilat i mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të tij/saj.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë	
V.1	Prezanton para të tjerëve mënyrën e zbatimit të rregullave themelore të higjienës personale (fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit, ku jeton dhe vepron, përmes formave të ndryshme të shprehjes.
V.5	Identifikon: përparësitë dhe mangësitë e personalitetit të vet dhe jep mendime për mënyrën e përmirësimit, në forma të ndryshme shprehëse;
V.7	Dallon dhe përshkruan rolet e personave dhe shërbimeve të nevojshme për kërkimin e ndihmës në situata të caktuara të rrezikut të shëndetit të vet, fizik dhe mendor.

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm	
VI.1	Paraqet në forma të ndryshme të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të familjes së vet dhe i diskuton ato me të tjerët, më pas i krahason me të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve, mësuesve dhe stafit menaxhues në shkollë apo me pjesëtarët e ndonjë institucioni;
VI.3	Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh., besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti-mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga ato;
VI.8	Prezanton në mënyrë kronologjike ndryshimet e familjes dhe të rrethit në aspekte të ndryshme (si: objektet e banimit, festat, veshjet, ushqimet-mënyrat e të ushqyerit, menaxhimi i ekonomisë familjare, të drejtat, përgjegjësitë dhe vendimmarrja në familje etj.) ose disa nga personalitetet dhe ngjarjet kryesore të popullit të vet, duke e dalluar të tashmen nga e kaluara.
VI.9	Paraqet me shembuj konkretë sjelljet që duhet manifestuar në rast rreziku nga fatkeqësitë natyrore apo të krijuara nga njeriu, si: zjarri, vërshimi, tërmeti, komunikimi me njerëz të panjohur etj.

RNF - Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:	
5.1	Shpjegon disa nga shkaqet dhe pasojat e rreziqeve natyrore e shoqërore si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe veprimeve të njeriut dhe merr pjesë në aktivitete për ruajtjen e mjedisit dhe përkujdesjen për trashëgiminë.
5.2	Bashkëpunon me të tjerët dhe ndërmer veprime të dobishme që promovojnë mjedisin e pastër, kujdeset për përdorim të drejtë të të mirave jetësore për higjienën e përgjithshme dhe për atë personale.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p>- Resurset dhe trashëgimia e vendit tim</p> <p>- Mjedis i vendit tim</p>	<p>- Identifikon disa nga pasuritë humane dhe të trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës dhe shpjegon rëndësinë e tyre për vendin;</p> <p>- Merr pjesë aktive dhe përcakton veprimet që duhet ndërmarr në bashkëpunim me të tjerët në organizimin e aktiviteteve të ndryshme që promovojnë ruajtjen e mjedisit, trashëgimisë ekonomike, shëndetësore dhe kujdesit shoqëror ndaj të tjerëve;</p> <p>- Përkrahet me shembull konkret si dëmtohet mjedisi nga hedhja e mbeturinave familjare dhe industriale në vende joadekuate, nga trafiku, keqpërdorimi dhe degradimi i tokës, pyjeve dhe ujërave;</p> <p>- Shpjegon rëndësinë e zgjerimit të sipërfaqeve të gjelbra, përdorimit të transportit publik dhe atij ekologjik, riciklimit të mbetjeve, krijimit dhe përdorimit të depozitave adekuate.</p>	<p>52. Pasuritë humane</p> <p>53. Ruajtje trashëgiminë kulturore</p> <p>54. Kujdesi shëndetësor</p> <p>55. Ndihmimet për një mjedis të pastër</p> <p>56. "Pasuritë natyrore të vendit tim" (Ekskursion)</p> <p>57. Njeriu mbron natyrën</p> <p>58. Ndotja e ujërave</p> <p>59. Ndotja e tokës</p> <p>60. T'i ruajmë tokën dhe pyjet</p> <p>61. Transporti publik dhe ekologjik</p> <p>62. Si riciklohen mbetjet?</p> <p>63. Kujdesi për higjienën në komunitet</p> <p>64. "Ndihmoj për një mjedis të pastër dhe të gjelbër" (Projekti ynë)</p> <p>65. "Unë dhe ti" (Loja)</p>	<p>14 orë</p> <p>Metodologjitë: Mësimdhënia dhe të nxënësve bazuar në arritjen e kompetencave; Mësimdhënia dhe të nxënësve integruar; Mësimdhënia dhe të nxënësve diferencuar.</p> <p>Teknikat: 1. Stuhi mendimesh; 2. Dramatizim me role; 3. Rrjet diskutimi.</p>	<p>- Vlerësimi formativ</p> <p>- Vlerësimi i të nxënësve</p> <p>- Informata kthyesë</p> <p>- Listë kontrolli</p> <p>- Portofolio</p>	<p>Gjuhë shqipe</p> <p>Matematikë</p> <p>Shoqëria dhe mjedisi</p> <p>Të drejtat e fëmijëve</p> <p>Çështjet ndërkurrikulare</p>	<p>Shoqëria dhe mjedisi 4</p> <p>Shoqëria dhe mjedisi 4 - Fletore pune</p> <p>Burime nga interneti</p>

Mësimi 1

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Lidhjet dhe bashkëpunimi me të tjerët

Rezultatet e të nxënit të temës:

Jep ide dhe merr hapa për një veprimtari të përbashkët me 84 grupet dhe/ose komunitetet e tjera në klasë, shkollë, lagje, vendbanim.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.3; V.8; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Unë po rritem

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon gjëra të reja për veten;
- Përmbledh tregimin e Lindës;
- Krahason tiparet e veta me Lindën.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Ndaje me shokun/shoqen

Nxënësit në çifte do të diskutojnë lidhur me ngjarjet ose shprehitë që i kanë fituar gjatë kohës sa ishin në pushime. Njëkohësisht nxënësit do të tregojnë për ndryshimet pozitive që i kanë arritur gjatë asaj kohe.

Pastaj, disa nxënës do të tregojnë para klasës për gjërat që shoku/shoqja i ka shkëmbyer me të.



Situata 1. Unë jam Linda. Jam në klasën e katërt. Prindërit çdo ditë më thonë: "Linda, ti po rritesh dhe po bëhesh vajzë e mbarë!".

Po ju tregoj se pse ata mendojnë kështu. Më besoni, nuk po mburrem, vetëm dua të ndaj këtë kënaqësi me ju, moshatarët e mi. Tani unë kam krijuar shprehitë e mia. Çdo mëngjes pastrohem, rregulloj dhomën time, vishem dhe mbath këpucët e përshtatshme për stinën. Ushqehem me orar dhe me ushqime të shëndetshme. Shkoj në shkollë pasi ti kem kryer të gjitha detyrat. Ushtrroj balet, sepse është pasioni im. Po ashtu, vijoj kurse të gjuhëve të huaja, sepse, siç thonë rilindësit tanë: "Sa gjuhë di, aq vlen".

Jashë, në shkollë, në teatër, në kinema e kudo sillem mirë dhe respektoj rregullat. Përvojat ditore e sidomos ndonjë shqetësim ose problem i diskutoj me prindërit.

Mos të harroj të përmend se u ndihmoj babait e nënës rreth punëve të shtëpisë. Më së shumti më pëlqen të gatuj dhe ta shtrroj tryezën e ngrënies.

Në kohën e lirë luaj me shokët e shoqet e mia, argëtohem me prindërit dhe nganjëherë këqyri televizor. Afër shtratit gjithmonë mbaj një libër dhe para gjumit lexoj, sepse leximi më qetëson dhe më bën të ëndërroj.

Unë po rritem

- Pse prindërit thonë se Linda është rritur?
- Cila sjellje jotja të pëlqen më shumë?
- Cila sjellje jotja nuk të pëlqen? Si mendon ta ndryshosh?
- Plotëso tabelën e mëposhtme, duke krahasuar veten me Lindën.



	Unë	Linda
Shprehitë		
Ushqimet		
Veshjet		
Mbathjet		
Talenti		
Gjuha e huaj		
Punët e shtëpisë		
Leximi		
Sjellja		
Respektimi i rregullave		

Njeriu lind, zhvillohet, rritet dhe ndryshon vazhdimisht. Njeriu pëson ndryshime fizike dhe mendore apo psikike. Ndryshimi fizik përfshin ndryshimet në peshë dhe gjatësi. Ndryshimet mendore janë: formimi i shprehive të jetës, aftësia për t'i dalluar veprimet e mira nga ato jo të mira, interesimi për lojën, aftësia për t'u përshtatur në mjedisin ku jeton e zbatimi i rregullave në të, aftësia për të mësuar, përvetësuar dhe zbatuar ato njohuri në jetën e përditshme. Të gjitha këto arrihen kur fëmija është i rrethuar me njerëz që i ofrojnë dashuri, e udhëzojnë dhe e këshillojnë.

Fjalët kyçe: rritem, shprehi, pasion, sjellje, rregull.

7



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Pyetja sjell pyetjen

Lexohet situata e dhënë në libër dhe diskutohet lidhur me aktivitetet dhe përgjegjësitë që i arrin t'i përfundojë Linda.

Parashtrihen pyetjet si p.sh.:

- Pse prindërit thonë se Linda është rritur?
- Pse krenohet gjyshja me Lindën?
- A mendojnë edhe prindërit e tu se ti po rritesh? Pse?
- Cilën sjellje tënde mendon se duhet ta ndryshosh?

Pastaj, nxënësit në mënyrë individuale do të plotësojnë tabelën për të krahasuar tiparet/shprehitë e veta me Lindën.

Pastaj, së bashku do të bëjmë krahasimin me nxënësit, se sa kanë tipare/shprehi të përbashkëta me Lindën.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënët Fjalët kyçe

Përmes fjalëve kyçe: rritem, shprehi, pasion, sjellje dhe rregull, secili nxënës do të shkruajë një ese të shkurtër lidhur me njësinë e mësuar.

Eseja e shkruar do të lexohet nga disa nxënës dhe do të diskutohen së bashku me shokët/shoqet e klasës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për mënyrën e komentimit/ndarjes së ngjarjeve me shokun/shoqen dhe përdorimin e një fjalori të pasur gjatë komunikimit dhe komentimit.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës, faqe 6.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 2

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Lidhjet dhe bashkëpunimi me të tjerët

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon grupet dhe komunitetet në mjedisin ku jeton dhe përshkruan ndryshimet ndërmjet tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.3; V.5,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Komuniteti ynë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Kujton njohuritë për komunitetin;
- Cakton përgjegjësitë në komunitet;
- Shpjegon kuptimin e termit komunitet.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletorja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Kllaster

Nxënësit tregojnë njohuritë e mëparshme për komunitetin dhe përmes kllasterit tregojnë pjesë e cilit komunitet mund të jemi.



Lidhjet dhe bashkëpunimi me të tjerët

Komuniteti ynë

Situata 1. Ne jetojmë brenda një komuniteti.

Në lagjen ku jetojmë, kemi përgjegjësi për fqinjët tanë dhe të gjithë banorët e komunitetit.

Që të funksionojë jeta në komunitet dhe të ketë harmoni, ne vendosim së bashku për ndryshimet që do të bëhen në lagjen tonë.

Çdo ndryshim duhet të jetë për të mirën e të gjithëve.

Secili anëtar i komunitetit e ndien veten si pjesëtar aktiv për të gjitha ndryshimet që ndodhin. Në lagje është një hapësirë e pandërtuar. Të gjithë po mendonin se për çfarë do ta shfrytëzonin atë hapësirë.

Jepe edhe ti mendimin tënd.



- Çfarë kupton me fjalën *komunitet*?
- Kush është pjesë e komunitetit?
- Cili është qëllimi i përbashkët i komunitetit?
- Çfarë ndryshime do të bëje ti në lagjen tënde?



Komuniteti është një bashkësi njerëzish, të cilët ndajnë një hapësirë të përbashkët banimi ose kanë një mori karakteristikash të përbashkëta. Ata mund të kenë, por jo domosdoshmërisht, vlera, tipare, interesa, zakone, qëllime të përbashkëta.

Komuniteti, po ashtu, mund të jetë bashkësi njerëzish, që lidhen nga kushte historike ose nga interesa të përbashkët ekonomike, shoqërore e politike.

Komuniteti është një grup njerëzish që kryesisht ndërveprojnë drejtpërdrejt ose përmes ndërmjetësuesve të komunikimit për qëllime shoqërore, profesionale, arsimore ose qëllime të tjera.

8 | Fjalët kyçe: komunitet, grup njerëzish, bashkëpunim, mirëkuptim.

**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:****Përpunimi i përmbajtjes***Leximi i drejtuar*

Një nxënës i përzgjedhur bën leximin e situatës 1. Pas leximit bëhen pyetje lidhur me tekstin e lexuar:

- Çfarë kupton me fjalën komunitet?
- Kush është pjesë e komunitetit?
- Cili është qëllimi i përbashkët i komunitetit?
- Çfarë ndryshime do të bëje ti në lagjen tënde?

Lexohet dhe diskutohet edhe pjesa e mbetur për komunitetin.

Përgjatë kësaj kohe nxënësit do të caktojnë edhe përgjegjësitë e tyre që i kanë brenda secilit komunitet ku bëjnë pjesë.

**Përforsimi:****Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënës***Marrëdhëniet pyetje-përgjigje*

Në pjesën e fundit të orës mësimore, bëhet përmbledhje e njohurive të fituara gjatë orës mësimore duke parashtruar pyetje lidhur me njësinë mësimore:

- Në cilin komunitet bën pjesë?
- Cilat janë përgjegjësitë e tua brenda komunitetit?
- Dallo përgjegjësitë nga komunitetet e ndryshme ku bën pjesë.

Sipas rrjedhës së diskutimit do të parashtrohen pyetje të ndryshme nga mësuesi/ja.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen sipas dhënies së saktë të përgjigjeve dhe angazhimit në diskutim.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës, faqe 7.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 3

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Lidhjet dhe bashkëpunimi me të tjerët

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon grupet dhe komunitetet në mjedisin ku jeton dhe përshkruan ndryshimet ndërmjet tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1; III.3,9.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Grupet shoqërore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon grupet shoqërore;
- Përcakton rolin brenda një grupi shoqëror;
- Krahason grupet shoqërore në të kaluarën dhe sot.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletorja, hameri.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Matematikë, Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Diskutim për njohuritë paraprake

Së pari fillojmë me një aktivitet duke e marrë vetëm një nxënës një njërën anë dhe në anën tjetër grumbullojmë 2 e më shumë nxënës.

Pyesim nxënësit: Ku qëndron dallimi mes nxënësve ose ndarjes së tyre?

Arrijmë të njësia mësimore që ka të bëjë me grupet shoqërore.

Duke u bazuar te njohuritë paraprake pyesim nxënësit: Kush është grup shoqëror, ose në cilat grupe shoqërore bëjnë pjesë?



Lidhjet dhe bashkëpunimi me të tjerët

Grupet shoqërore

Situata 1. Bora, së bashku me prindërit dhe vëllanë e madh, jeton në Prishtinë. Ajo është në klasën e katërt. Në shkollën e saj ka shumë grupe të ndara në bazë të ideve dhe qëllimeve të përbashkëta. Këto grupe të shkollës u mundësojnë nxënësve që t'i shprehin aftësitë dhe talentet e tyre të ndryshme. Bora është pjesëtare e grupit të vallëzimit dhe atij të recitimit. Ndërsa, vëllai i saj është pjesëtar i grupit të futbollit dhe atij të pikturës. Në këto grupe, ata mësojnë shumë gjëra të reja, duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin.



- Cilat janë grupet ku bën pjesë Bora?
- Po vëllai i Borës, në cilat grupe bën pjesë?
- Po ti, në çfarë grupe bën pjesë?
- Cili grup të pëlqen më së shumti ty?
- A keni krijuar ndonjëherë ndonjë grup? Nëse jo, mendoni tani se çfarë grupi të ri do të mund të krijonit në shkollë.



Njeriu është një qenie shoqërore dhe si i tillë ai është gjithmonë anëtar i bashkësisë shoqërore. Grupi shoqëror përbëhet prej dy a më shumë njerëzve, të cilët kanë të përbashkëta. Grupi shoqëror është grup njerëzish që kanë pikëpamje, ide, qëllime e interesa të përbashkët ose profesion të njëjtë, të organizuar së bashku, që kryejnë të njëjtën punë a veprimtari.

Njeriu mund të jetë pjesëtar i shumë grupeve në të njëjtën kohë, si: pjesëtar i familjes, nxënës i klasës, pjesëtar i komunitetit të lagjes, pjesëtar i një grupi të sportit, të gjuhës së huaj, të vallëzimit, të këndimit etj.

Në të kaluarën, njerëzit kishin ide dhe veprimtari të ndryshme nga ato të sotme. Këtë ndryshim në grupet shoqërore e bën të mundur zhvillimi ekonomik, teknologjik dhe ai i prodhimit.

10 Fjalët kyçe: grup shoqëror, dikur, sot, qëllim i përbashkët.



11

**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:****Përpunimi i përmbajtjes***Të nxënësit me këmbime*

Lexohet teksti i dhënë në libër dhe komentimi i përbashkët i pjesës së lexuar.

Nxënësve u parashtrohen edhe pyetjet e dhëna në libër.

Përmes kësaj nxënësit do të shkëmbejnë përvojat e tyre të ndryshme lidhur me grupet shoqërore ku bëjnë pjesë.

Në fletoret e tyre nxënësit kanë për detyrë të shkruajnë për një grup shoqëror që dëshirojnë të bëhen pjesë e tij dhe do të tregojnë arsyen pse duan të jenë pjesë e atij grupi.

Do të lexohen shkrimet e disa nxënësve.

**Përforcimi:****Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit***Ditari dypjesësh*

Duke e përdorur ditarin dypjesësh, nxënësit në grupe do të bëjnë krahasimin ndërmjet grupeve shoqërore në të kaluarën dhe sot.

Do të paraqiten/lexohen para nxënësve mendimet e shkruara në ditarin dypjesësh.

Grupet shoqërore në të kaluarën	Grupet shoqërore sot

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për mënyrën e përgjigjes ndaj pyetjeve të parashtruara, bashkëpunimin me të tjerët dhe dhënien e mendimeve.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës, faqe 8.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

Mësimi 4

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Lidhjet dhe bashkëpunimi me të tjerët

Rezultatet e të nxënësve të temës:

Vlerëson efektet pozitive të bashkëveprimit me të tjerët dhe punës vullnetare (brenda klasës, shkollës, lagjes dhe më gjerë).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.3,8; II.1; III.3; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: E mira jonë e përbashkët

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Diskuton lidhur me fotografitë e dhëna;
- Përcakton aktivitete të përbashkëta;
- Përzgjedh aktivitete që mund t'i realizojnë së bashku.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografia të printuara, libri, fletorja

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Matematikë, Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Imagjinata e drejtuar

Para nxënësve paraqesim një fotografi të një fëmije në rrugë.

Pyeten nxënësit:

- Çfarë po shihni?
- Si do të vepronit nëse do ta takoni një fëmijë të tillë në rrugë?
- Si do të ndiheshë nëse do ta bëje të buzëqesh?


Për pyetjen e fundit secili nxënës do të shënojë përgjigjen e tij në një etiketë dhe pastaj do të vendosen në tabelë dhe do të lexohen nga mësuesi/ja.



Lidhjet dhe bashkëpunimi me të tjerët

E mira jonë e përbashkët

Situata 1. Ishin festat e fundvitit. Moti i ftohtë që mbizotëronte në vend nxiti fëmijët e shkollës që të mendonin për fëmijët në nevojë. Nën moton "Dhurojmë copëza lumturie", nxënësit organizuan një aktivitet humanitar. Secili fëmijë, sipas mundësisë, do të sillte diçka që do t'u dhurohej fëmijëve në nevojë. Mund të ishin troba që fëmijët nuk i përdomin më, mund të ishte ndonjë shall apo doreza, ndonjë fletore apo mjet tjetër shkollore, ndonjë produkt higjienik apo çfarëdo tjetër që do t'i lehtësonte ditët e ftohta të dimrit. Të gjithë kishin sjellë dhuratat të bukura. Ata po diskutonin me njëri-tjetrin për dhuratat që i kishin përfituar me shumë dashuri për fëmijët në nevojë.



- Çfarë kuptoni me shprehjen "Dhurojmë copëza lumturie"?
- Cili ishte motivi i fëmijëve për të organizuar një aktivitet humanitar?
- Çfarë të bën ty të lumtur?
- A ke pasur mundësi ndonjëherë që ti ta bësh dikë të lumtur duke e ndihmuar?



E mira jonë e përbashkët buron nga humanizmi ndërmjet njerëzve. Humanizmi është punë vullnetare, një veprim vullnetar i një individi ose grupi shoqëror që kryen aktivitete të ndryshme për të mirën e komunitetit. Humanizmi është vlerësimi i njerëzve, me kujdesin për mirëqenien e tyre. Humanizmi shprehet nëpërmjet kujdesit, ndihmës, tolerancës, përkrahjes, mirëkuptimit dhe mirësjelljes. Në kuptimin e përgjithshëm, humanizëm është çdo sistem mendimi dhe veprimi që i vë në radhë të parë njeriun dhe dinjitetin e tij.

12 Fjalët kyçe: dashuri, ndihmë, buzëqeshje, përkrahje.



Lidhjet dhe bashkëpunimi me të tjerët

E mira jonë e përbashkët

Situata 1. Ishin festat e fundvitit. Moti i ftohtë që mbizotëronte në vend nxiti fëmijët e shkollës që të mendonin për fëmijët në nevojë. Nën moton “Dhurojmë copëza lumturie”, nxënësit organizuan një aktivitet humanitar. Secili fëmijë, sipas mundësisë, do të sillte diçka që do t’u dhurohej fëmijëve në nevojë. Mund të ishin rroba që fëmijët nuk i përdornin më, mund të ishte ndonjë shall apo doreza, ndonjë fletore apo mjet tjetër shkollor, ndonjë produkt higjienik apo çfarëdo tjetër që do t’i lehtësonte ditët e ftohta të dimrit. Të gjithë kishin sjellë dhuratat të bukura. Ata po diskutonin me njëri-tjetrin për dhuratat që i kishin përgatitur me shumë dashuri për fëmijët në nevojë.



- Çfarë kuptoni me shprehjen “Dhurojmë copëza lumturie”?
- Cili ishte motivi i fëmijëve për të organizuar një aktivitet humanitar?
- Çfarë të bën ty të lumtur?
- A ke pasur mundësi ndonjëherë që ti ta bësh dikë të lumtur duke e ndihmuar?



E mira jonë e përbashkët buron nga humanizmi ndërmjet njerëzve. Humanizmi është punë vullnetare, një veprim vullnetar i një individi ose grupi shoqëror që kryen aktivitete të ndryshme për të mirën e komunitetit. Humanizmi është vlerësimi i njerëzve, me kujdesin për mirëqenien e tyre. Humanizmi shprehet nëpërmjet kujdesit, ndihmës, tolerancës, përkrahjes, mirëkuptimit dhe mirësjelljes. Në kuptimin e përgjithshëm, humanizëm është çdo sistem mendimi dhe veprimi që i vë në radhë të parë njeriun dhe dinjitetin e tij.

12 | Fjalët kyçe: dashuri, ndihmë, buzëqeshje, përkrahje.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Parashikimi me terma paraprakë

Para se të hapen librat, në tabelë do të shënohet termi “Dhurojmë copëza lumturie”. Prej nxënësve kërkohen disa mendime lidhur me termin e shënuar.

Pas marrjes së mendimeve vazhdohet me leximin e përbashkët të tekstit të dhënë në libër dhe analizën e tij.

Nxënësit gjatë kësaj kohe do të kuptojnë edhe më shumë termin humanizëm se çfarë do të thotë dhe si duhet të zbatohet.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Turi i galerisë

Nga nxënësit do të kërkohet që në fletët e shpërndara të shkruajnë nga një aktivitet që dëshirojnë ta realizojnë në mënyrë të përbashkët. Secili nxënës do të vendosë fletën e tij në tabelë dhe do të tregojë aktivitetin që ka menduar që mund ta realizojë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për angazhimin e treguar gjatë procesit mësimor.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës, faqe 9-10.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Lidhjet dhe bashkëpunimi me të tjerët

Rezultatet e të nxënit të temës:

Vlerëson efektet pozitive të bashkëveprimit me të tjerët dhe punës vullnetare (brenda klasës, shkollës, lagjes dhe më gjerë).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.2; V.8; VI.2,3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Së bashku ia dalim

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon efektet pozitive të bashkëpunimit;
- Interpreton raste të bashkëpunimit;
- Organizon bashkëpunim ndërmjet grupit/nxënësve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletorja, etiketa.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Anagrami

Sipas numrit/grupeve të nxënësve do të përgatiten disa etiketa ose copëza për të bërë kombinime.

Përmes copëzave nxënësit do të formojnë fjalë.

Mund të merren si shembuj kombinimi i fjalëve: bashkëpunim, vendimmarrje, ndërveprim etj.

Gjatë kësaj, do të garojnë nxënësit se cili grup do të plotësojë më shpejt fjalën.

Grupi i përzgjedhur do të tregojë se çfarë u ndihmoi të gjejnë më shpejt fjalën e fshehur.

Lidhjet dhe bashkëpunimi me të tjerët



Së bashku ia dalim

Situata 1. Ishin ditët e fundit të gushtit, kur Lisi po rregullonte dhomën e tij të gjumit para fillimit të vitit shkollor. Do ta fillonte klasën e katërt dhe kjo e bënte më përgjegjës ndaj gjërave të tij. Lisi është i lartë i ripërdorimit dhe i riciklitimit dhe ai çdo vit shikon se çfarë i ka mbetur nga viti i kaluar shkollor për t'i përdorur në vitin e ardhshëm. Mirëpo, diçka që nuk i duhej më, por që kishte shumë vlerë për të, ishin librat e tij të parë. Mendoi t'i vendoste diku në shtëpi për t'i ruajtur, por e dinte që kështu nuk bënte mirë për askënd. Kur bisedoi me prindërit për këtë çështje, ata i dhanë një ide të shkëlqyeshme. - Pse nuk mbledh libra edhe nga shokët e klasës dhe të krijoni bibliotekën e klasës? - ishte ideja e përbashkët e prindërve. Lisi u lumturua shumë nga kjo ide. E mendonte sa mirë do të bëhej kur të gjithë fëmijët e klasës do të mblidhnin librat e tyre dhe t'i shkëmbenin me njëri-tjetrin.



- Sa e vlerëson bashkëpunimin me të tjerët për të bërë një veprim të mirë për komunitetin?
- Si përfiton komuniteti nga veprimi i Lisit me shokët?
- A ke bërë ndonjëherë ndonjë aktivitet/veprim për të mirën e të tjerëve?
- Si e vlerëson idenë e prindërve të Lisit për krijimin e bibliotekës së klasës?
- Sa është e rëndësishme që shkollat të kenë biblioteka?

Njerëzit dallojnë nga njëri-tjetri. Ata jetojnë në familje, mjedise të ndryshme, kanë edukatë dhe kulturë të ndryshme. Kështu që, secili njeri ka mendimet e veta.

Nëse respektojmë kulturat dhe mendimet e të tjerëve dhe i shkëmbejmë ato në mes nesh, atëherë çdo punë bëhet më mirë dhe ne bëhemi më të ditur, pasi përfitojmë shumë nga të tjerët.

Puna në ekip bëhet nga disa persona që kanë një qëllim të përbashkët dhe punojnë për ta përfunduar një detyrë në mënyrë efektive. Puna në ekip nuk njihet moshë. Ajo është e njëjtë për të gjitha moshat. Anëtarët e grupit ndajnë në mënyrë të barabartë përgjegjësitë dhe detyrat e tyre.

Fjalët kyçe: bashkëpunim, kujdes, ndërveprim, vlerësim.

Lidhjet dhe bashkëpunimi me të tjerët

Së bashku ia dalim



Situata 1. Ishin ditët e fundit të gushtit, kur Lisi po rregullonte dhomën e tij të gjumit para fillimit të vitit shkollor. Do ta fillonte klasën e katërt dhe kjo e bënte më përgjegjës ndaj gjërave të tij. Lisi është idhtar i ripërdorimit dhe i riciklimit dhe ai çdo vit shikon se çfarë i ka mbetur nga viti i kaluar shkollor për t'i përdorur në vitin e ardhshëm. Mirëpo, diçka që nuk i duhej më, por që kishin shumë vlerë për të, ishin librat e tij të parë.

Mendoi t'i vendoste diku në shtëpi për t'i ruajtur, por e dinte që kështu nuk bënte mirë për askënd. Kur bisedoi me prindërit për këtë çështje, ata i dhanë një ide të shkëlqyeshme.

- Pse nuk mbledh libra edhe nga shokët e klasës dhe të krijoni bibliotekën e klasës? - ishte ideja e përbashkët e prindërve. Lisi u lumturua shumë nga kjo ide. E mendonte sa mirë do të bëhej kur të gjithë fëmijët e klasës do të mblidhnin librat e tyre dhe t'i shkëmbenin me njëri-tjetrin.



- Sa e vlerëson bashkëpunimin me të tjerët për të bërë një veprim të mirë për komunitetin?
- Si përfiton komuniteti nga veprimi i Lisit me shokët?
- A ke bërë ndonjëherë ndonjë aktivitet/veprim për të mirën e të tjerëve?
- Si e vlerëson idenë e prindërve të Lisit për krijimin e bibliotekës së klasës?
- Sa është e rëndësishme që shkollat të kenë biblioteka?

Njerëzit dallojnë nga njëri-tjetri. Ata jetojnë në familje, mjedise të ndryshme, kanë edukatë dhe kultura të ndryshme. Kështu që, secili njeri ka mendimet e veta.

Nëse respektojmë kulturat dhe mendimet e të tjerëve dhe i shkëmbejmë ato në mes nesh, atëherë çdo punë bëhet më mirë dhe ne bëhemi më të ditur, pasi përfitojmë shumë nga të tjerët.

Puna në ekip bëhet nga disa persona që kanë një qëllim të përbashkët dhe punojnë për ta përfunduar një detyrë në mënyrë efektive. Puna në ekip nuk njih moshë. Ajo është e njëjtë për të gjitha moshat. Anëtarët e grupit ndajnë në mënyrë të barabartë përgjegjësitë dhe detyrat e tyre.

Fjalët kyçe: bashkëpunim, kujdes, ndërveprim, vlerësim.

13



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Ruaje fjalën e fundit për mua

Në mënyrë të përbashkët do të lexohet teksti i dhënë në libër dhe do të jepen përgjigje për pyetjet e dhëna.

Pas kësaj, secili nxënës do të zgjedhë nga një citat dhe në pjesën tjetër të fletës do të shkruajë një koment për të.

Gjatë leximit të citatit nga një nxënës i caktuar, nxënësit e tjerë do të bëjnë komentimin e citatit dhe në fund nxënësi i caktuar do ta lexojë komentin e tij që e ka shkruar.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënët

Copëzat e përziera

Në pjesën e fundit të orës, në grupe, nxënësve do t'u shpërndahet me copëza të përziera ndonjë nga poezitë e mësuara. Pas përfundimit, nxënësit do të prezantojnë punën grupe se si janë organizuar dhe do të tregojnë kontributin e secilit anëtar të grupit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për shpejtësinë dhe saktësinë në kryerjen e detyrave dhe bashkëpunimin e treguar me të tjerët.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës, faqe 11-12.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 6

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Shoqëria dhe mjedisi
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Secili ka të drejta dhe përgjegjësi

Rezultatet e të nxënit të temës:
Shpjegon ndërlidhjen midis të drejtave dhe përgjegjësi dhe ilustron me shembuj nga situata jetësore në klasë, shkollë, lagje dhe/ose më gjerë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; III.2,3; VI.1,3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Të drejtat dhe përgjegjësitë e mia

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Tregon të drejtat dhe përgjegjësitë;
 - Bën dallimin midis të drejtave dhe përgjegjësi;
 - Cakton disa të drejta dhe përgjegjësi personale.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletorja, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Matematikë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS





Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Pema e mendimeve

Fillimisht nxënësve u bëhen disa pyetje para se të tregojmë njësinë mësimore.

P.sh.:

- Në çfarë ore ke ardhur në shkollë?
 - Cilat libra i ke marrë me vete?
- Vazhdohet me pyetje të ndryshme me ç'rast nxënësit do të tregojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.



Secili ka të drejta dhe përgjegjësi



Të drejtat dhe përgjegjësitë e mia

Situata 1. Në klasë, gjatë pushimit midis orëve, mbledhemi dhe diskutojmë për probleme të ndryshme.
Mësuesja na këshillon që të mos bëjmë zhurmë, pasi kështu shqetësojmë të tjerët. Po ashtu, ajo theksoi se duhet të tregohemi të kujdesshëm kur lëvizim në klasë, pasi mund të lëndojmë njëri tjetrin.
- Në kemi të drejtën e arsimit, por edhe përgjegjësinë për njohjen dhe respektimin e rregullave në shkollë, - tha mësuesja.
- Detyra juaj është që të mësoni shumë, ashtu që të përgatiteni sa më mirë për jetë dhe t'u shërbeni dinjitetshëm vendit, shoqërisë dhe njëditit ku jetoni.



- Çfarë kërkonte mësuesja nga nxënësit?
- Po ju, a i respektoni rregullat në klasë?
- Cilat janë disa nga të drejtat tuaja?
- Përmend disa përgjegjësi që ke në shkollë.





Secili ka të drejta dhe përgjegjësi

Të drejtat dhe përgjegjësitë e mia

Situata 2. Në familjen time, ne zakonisht në mbrëmje këqyrim televizor. Kur jepen informacione për ngjarje të ndryshme, tregohem e pavëmendshme, pasi nuk kam interes që t'i dëgjoj. Nëna më këshillon të tregoj kujdes, pasi aty mund të marr informacione që ndikojnë në jetën time. Si për shembull, një natë u raportua për sëmundjet ngjitëse, me ç'rast kuptova se duhej të mbaja distancën e duhur fizike nga shoqet dhe shokët.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Mendo, puno në dyshe

Do të lexohen dhe diskutohen situatat dhe teksti i dhënë në libër.

Pas diskutimit dhe sqarimit të njësisë mësimore, nxënësit do të bashkëpunojnë në dyshe.

Njëri nxënës do të shkruajë një të drejtë, kurse nxënësi tjetër do të shkruajë një përgjegjësi për të drejtën e shkruar nga shoku.

Nxënësit do të shkruajnë vetëm nga dy shembuj dhe pastaj do të fillojë leximi i tyre nga disa nxënës.

Do të plotësohen të drejtat që nuk janë lexuar nga nxënësit e tjerë.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Ditari dypjesësh

Në mënyrë individuale, nxënësit do të paraqesin disa të drejta dhe përgjegjësi në shtëpi dhe në shkollë.

Në shtëpi		Në shkollë	
Të drejtat	Përgjegjësitë	Të drejtat	Përgjegjësitë

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për angazhimin e treguar gjatë orës mësimore dhe dallimin e të drejtave nga përgjegjësitë.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës, faqe 14.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 7

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Shoqëria dhe mjedisi
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Secili ka të drejta dhe përgjegjësi

Rezultatet e të nxënit të temës:
Dallon shkeljet e të drejtave të njeriut dhe i identifikon institucionet për mbrojtjen e tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.2; III.2,3; VI.1,2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Institucionet që na mbrojnë

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Emërton institucionet;
 - Praktikon funksionin e ndonjë institucioni;
 - Shpjegon funksionet e institucioneve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektori, libri, fletorja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Matematikë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Diskutim për njohuritë paraprake

Në tabelë ose përmes projektorit paraqiten disa fotografi të institucioneve të ndryshme, ku nxënësit do ta bëjnë emërtimin e tyre. Duke i kujtuar njohuritë paraprake, do të rikujtojmë edhe numrat kontaktues për këto institucione në rastet kur ne kemi nevojë.

Policia _____ Urgjenca _____ Zjarrfikësit _____

Secili ka të drejta dhe përgjegjësi Institucionet që na mbrojnë

Rikujtojmë njohuritë që kemi marrë nga klasa e tretë. Në rast nevojë, duhet të telefonohen:



Policia _____



Urgjenca _____



Zjarrfikësit _____

Situata 1. Sot, kur shkuam në shkollë, në klasë erdhi infermierja, e cila po kontrollonte higjienën dhe shëndetin tonë. Instituti i Shëndetit Publik kujdeset për shëndetin e çdo individi.



- ?**
- Çfarë masash janë marrë për mbrojtjen e shëndetit?
 - Kush kujdeset për shëndetin tonë?
 - Po ne, çfarë kujdesi duhet të tregojmë?
 - Bëni një dialog në dyshe, ku njëri ka rolin e mjekut, kurse tjetri rolin e pacientit.

Secili ka të drejta dhe përgjegjësi

Institucionet që na mbrojnë



Situata 2. Në qytetin tonë të zhurmshëm, vijon tradita e bashkëveprimit me policinë rrugore. Ka kohë që, në oraret kur ne hyjmë e dalim nga shkolla, polici bllokoi qarkullimin dhe qëndron te vijat e bardha. Kështu, ndihemi të sigurt ndaj çdo rreziku.



- Për çfarë shërbejnë vijat e bardha?
- Pse polici bllokoi qarkullimin e mjeteve në vijat e bardha?
- A ndiheni ju të sigurt? Pse?



Shteti ka përgjegjësinë kryesore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ai, nëpërmjet institucioneve të tij, siguron respektimin e ligjeve dhe të rregullave në shoqëri. Institucionet shtetërore për të drejtat e njeriut nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi. Ka shumë organizata ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e njeriut e të fëmijëve. Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), e formuar më 24 tetor 1945, mbron liritë dhe të drejtat e njeriut, si dhe ka rol të rëndësishëm për sigurimin e paqes në botë. Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE) garanton të drejtat e njeriut dhe përfshin të gjitha shtetet evropiane. Avokati i Popullit mbron të drejtat e njeriut, si dhe shqyrton ankesat e personave që mendojnë se u është shkelur një e drejtë.

Fjalët kyçe: Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, protokoll, polici rrugore, institucion, organizatë.

19



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Lojë me role

Do të lexohen situatat dhe teksti i dhënë në libër. Gjatë komentimit të situatës së parë do të zhvillohet loja me role në mes të infermieres dhe pacientit.

Aktiviteti do të realizohet në dy grupe.

Njëri grup do ta luajë rolin në rastin kur pacienti sillet mirë. Grupi tjetër do të luajë rolin në rastin kur pacienti sillet jo mirë.

Përmes leximit dhe komentimit të pjesës kryesore të tekstit, nxënësit do të kuptojnë dhe do të tregojnë funksionet e institucioneve përkatëse që na mbrojnë.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Pesëvargëshi

Duke u bazuar te njësia mësimore nxënësit në mënyrë individuale do të formojnë nga një pesëvargësh.

_____ (emër)
_____, _____ (mbiemër)
_____, _____, _____ (folje)
_____ (fjali me katër fjalë)
_____ (sinonim)

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për luajtjen e roleve dhe saktësinë e plotësimit të pesëvargëshit.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës, faqe 15-16.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve

Rezultatet e të nxënit të temës:

Respekton dhe vlerëson dallimet kulturore, gjinore, etnike, fetare dhe personat me nevoja të veçanta në klasë, shkollë, lagje dhe më gjerë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.1,2; III.2; VI.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Respektojmë diversitetin kulturor

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon se çfarë përfshin kultura e një vendi;
- Dallon llojlloshmërinë e kulturave;
- Vlerëson dallimet kulturore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletorja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Matematikë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Fjalët kyçe

Në tabelë do të shënohen disa fjalë kyçe përmes së cilave nxënësit do të shkruajnë një lloj eseje. Fjalët kyçe: diversitet kulturor, kulturë kombëtare, bashkëjetesë, raporte pozitive, respektim. Gjatë leximit, nxënësit do të fitojnë njohuri nga njëri-tjetri lidhur me diversitetin kulturor dhe veçoritë e tij. Do të paraqiten edhe shembuj të diversitetit kulturor edhe nga jeta e përditshme ose brenda klasës nëse kemi raste të diversitetit.



Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve

Respektojmë diversitetin kulturor

Situata 1. Motra ime e madhe ka tre vjet që jeton në Turqi. Ajo ka shkuar për studime atje. Njëkohësisht edhe punon. Çdo ditë ajo njuh njerëz të rinj nga vende të ndryshme të botës. Në konvikt jeton me një vajzë kineze, një turke dhe një iraniane. Gjatë një bisede që patëm me të, na tregoi për kulturat e vendeve të tyre. Më shumë na e tërhoqën vëmendjen format e përshëndetjes në kulturën kineze, si dhe mënyra e të ushqyerit. Na njoftoi se herën tjetër do të vinte me shoqen e saj nga Kina dhe se duhej të përshatashim e të gatuanim orizin si në Kinë, e të mos e konsumonim atë me pirunë...



- Jepini një përfundim kësaj ngjarjeje.
- Cilat janë disa nga zakonet e traditat e shqiptarëve?
- Flisni për traditat e zakonet tona dhe ato të një populli tjetër dhe krahasojini mes vete.



Respektojmë diversitetin kulturor

Situata 2. Ngjyrat e çdo luleje ndryshojnë kuptimin nga një kulturë në tjetrën. E verdha përfaqëson diellin, jetën e gëzimin. Në Japoni, ngjyra e verdhë tregon trimërinë dhe kurajën. Në Egjipt, kjo ngjyrë është simbol i zisë. E bardha në Perëndim është simbol i pastërtisë. Në Lindje është simbol i zisë dhe i mbrëzisë. Në Kinë e Japoni, ngjyra e bardhë ta kujton dhimbjen dhe trishtimin. E kuqja në Kinë është simbol i fatit të mirë, ndërsa në Perëndim simbolizon rrezikun. Tulipanët kanë domethënie pozitive në të gjitha kulturat. Ata tregojnë rilindje, gëzim. Shoku ynë i klasës, Luja, kishte ditëlindjen. Ai jeton me familjen e tij, e cila ka një biznes familjar në Prishtinë. Vendosëm që ta uronim me një buqetë lulesh. Në vend që ta gëzonte, dhurata e shqetësoi Lunë...



- Vazhdoje ndodhinë me Lunë, duke përcaktuar ngjyrën e buqetës me lule.
- Çfarë e shqetësoi atë?
- Çfarë kuptimi kishte ngjyra e bardhë për Lunë?
- A mendoni se është e rëndësishme që t'i njohim kulturat e vendeve të ndryshme? Pse?



Çdo popull ka një kulturë të veten që quhet kulturë kombëtare. Kultura, zakonet dhe traditat shfaqen në familje, shkollë dhe kudo në shoqëri. Individidë dhe grupe të ndryshme mund të kenë kultura të ndryshme. Diversiteti kulturor shfaq dallimet kulturore që njerëzit, përkatësisht grupet e njerëzve, mund të kenë ndërmjet tyre. Çdo kulturë duhet të respektohet, sepse ka vlerat e veta. Ne duhet të mësojmë për të gjitha kulturat. Duke mësuar për to, i kuptojmë më mirë ato, vlerat e tyre dhe dallimet me kulturën tonë. Duke mësuar për kulturat e tjera, ne e kuptojmë më mirë edhe kulturën tonë, edhe veten tonë. Rrjedhimisht, dallimet kulturore nuk bëhen pengesë për bashkëpunim, por lehtësim në komunikim. Mbi të gjitha, arrijmë ta kuptojmë se, përkundër dallimeve kulturore, njerëzit duhet të kërkojnë atë që i përbashkon si qenie njerëzore. Me respekt dhe tolerancë, kulturat e ndryshme mund të bashkëjetojnë paqësisht.

Fjalët kyçe: diversitet kulturor, kulturë kombëtare, bashkëjetesë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
DRTA

Pas leximit të disa eseve, do të lexohen pjesët e tekstit të dhënë në libër.

Lexohet situata e parë dhe parashtrohen pyetje lidhur me pjesën e lexuar.

Nxënësit do të japin mendime lidhur me përfundimin e situatës dhe do t'u përgjigjen pyetjeve.

Nxënësit do të bëjnë disa dallime ndërmjet kulturave/vendeve të ndryshme përmes situatave ose dukurive të ndryshme.


Përmes kësaj, do të kuptojnë dhe vlerësojnë ndryshimet e kulturave nga njëra-tjetra.



Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Kllaster

Duke u bazuar te njohuritë e fituara nxënësit në mënyrë individuale do të paraqesin se çfarë përfshin kultura e një vendi. Punën e tyre do ta rishikojnë në dyshe, për të plotësuar njëri-tjetrin.

P.sh.:



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për angazhimin e treguar dhe saktësinë në kryerjen e detyrave.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës, faqe 19-20.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve

Rezultatet e të nxënit të temës:

Respekton mendimet ndryshe të të tjerëve, pranon të tjerët ashtu siç janë dhe i trajton në mënyrë të barabartë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1; V.5,8; VI.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndhim i/e barabartë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përcakton ndryshimet/dallimet nga njëri-tjetri;
- Arsyeton ndryshimet nga njëri-tjetri;
- Vlerëson të qenët i/e barabartë pavarësisht dallimeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografia, libri, fletorja, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Brainstorming

Nxënësvë u paraqitet fotografia dhe prej tyre kërkohet që të tregojnë ndryshimet që shohin brenda fotografisë.

Pyeten:

- A keni takuar ndonjëherë persona me aftësi të kufizuara?
- Ku i keni takuar?
- A i kanë ndjekur mësimet në shkollë?
- A i kanë të drejtat e barabarta si të gjithë njerëzit?

Me radhë merren përgjigje nga nxënësit lidhur me pyetjet e parashtuara.



Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve

Ndhim i/e barabartë

Situata 1. Të ndihesh i barabartë me të tjerët është prirje krejtësisht e natyrshme. Sytë e qeshur të Besës, e cila ishte ulur në karrocën me rrota, dukeshin sikur luain me topin që godiste herë një kosh, herë një tjetër në fushën e basketbollit. Sa entuziazëm shprehnin sytë e saj! Kishte kohë që ndiqte lojërat tona, madje ishte tifozja jonë e përhershme. Trajneri i basketbollit na njoftoi se kishte menduar diçka të veçantë. Dhe vërtet ashtu ndodhi...



- Vazhdoni tregimin me surpriza të këndshme.
- Cilat nga lojërat mund të realizohen me karroca lëvizëse?
- Si i përfshini në komunitet fëmijët dhe individët me aftësi të veçanta?



Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve

Ndihem i/e barabartë



Situata 2. Nora kishte kohë që mendonte se si ta ndihmonte shokun e saj të bankës. Ai kishte vështirësi në matematikë. Shpeshherë, mësuesja i tërhiqte vëmendjen, pasi ai nuk i zgjidhte saktë ushtrimet dhe problemat.



- Vazhdoje tregimin ashtu siç do ti të zhvillohen ngjarjet!
- Si mendoi që ta zgjidhte Nora problemin e shokut të saj?
- Po ju, si do të vepronit në një situatë të tillë?



Fëmijëve, që kanë vështirësi të formave të ndryshme, duhet t'u jepet të njëjtat mundësi, për të bërë një jetë dinjitoze, si gjithë të tjerët. Ata nuk duhet të përmbuzen apo mëshirohen nga shoqëria, por të integrohen në jetën e shkollës dhe të komunitetit. Fëmijët me nevoja të veçanta dhe fëmijët me vështirësi në të nxënë, kanë nevojë për kujdes dhe arsimim të veçantë për mirërritjen e tyre. Mësuesi/ja duhet t'u ofrojë besim dhe mbështetje për zhvillim, pasi edhe ata kanë nevoja, dëshira, të drejta dhe detyra. Ata janë pjesë e rëndësishme e shoqërisë. Secili prej tyre duhet të ndihmohet për të qenë i pavarur dhe t'i sigurohet pjesëmarrje aktive në komunitetin e tij.

Fjalët kyçe: aftësi e kufizuar, vështirësi, nevojë e veçantë.

25



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Mësimdhënia e ndërsjellë

Varësisht prej situatave të lexuara që janë dhënë në tekst, nxënësit do të përpiqen që të japin mendime lidhur me situatat e paraqitura.

Secili prej tyre do të argumentojë mendimin/qëndrimin e tij.

Do t'i tregojnë lojërat që mund t'i luajnë personat me karroca lëvizëse, do të tregojnë nëse kanë hasur ndonjë rast të tillë në jetën e përditshme ku janë përfshirë fëmijë/persona me nevoja të veçanta.

Gjatë kësaj kohë, ata do të tregojnë se si do t'i ndihmonin ndonjë shoku/shoqe ose individ të njëse do të kishte ndonjë nevojë të veçantë (p.sh., me karrocë lëvizëse, vështirësi në të nxënë etj.).



Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Tryeza e rrumbullakët

Nxënësit do të formojnë tryezën e rrumbullakët dhe do t'u jepet nga një fletë e bardhë. Tema për të cilën do të shënojnë është "Ndihem i/e barabartë". Secili nxënës që do të shënojë, do të palosë pjesën

e fletës që ka shënuar në mënyrë që të tjerët të mos e shikojnë pjesën e shkruar nga dikush tjetër.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për angazhimin e treguar gjatë orës mësimore.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës, faqe 21.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve

Rezultatet e të nxënit të temës:

Respekton mendimet ndryshe të të tjerëve, pranon të tjerët ashtu siç janë dhe i trajton në mënyrë të barabartë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3 III.3,9 V.5,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mendimi ndryshe

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Respekton mendimin ndryshe;
- Zhvillon të menduarit;
- Argumenton mendimin personal.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletorja, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Imagjinatë e drejtuar

Në tabelë shënohet: Si do të reagoje nëse në klasën tonë do të vijë një nxënës i ri?

Merren mendimet e nxënësve vullnetarë. Secili prej tyre mund të ketë mendime të ndryshme dhe me këtë rast ata do të mësojnë të respektojnë mendimet/qëndrimet e të tjerëve.



Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve

Mendimi ndryshe

Situata 1. Mësuesi i lëndës *Shoqëria dhe mjedisi* e nisi orën me një pyetje që nxiti diskutim:
- Çfarë mendoni, është më mirë të shikoni një film apo të lexoni një roman?

Andi dhe Tea reagues menjëherë, duke thënë se filmi ta jep ngjarjen me pamje, është më i lehtë për t'u mbajtur në mend dhe ta kursen kohën. Por, Trina dhe Redoni nuk e përkrahën këtë mendim. Ata thanë se libri është më i mirë, sepse të lë hapësirë për të menduar, për të imagjinuar dhe të bën më kreativ. Kështu, të gjithë u përfshinë në diskutim, duke dhënë mendime të ndryshme, por gjithmonë duke pritur radhën për të folur. Mësuesi e dinte që të dy kishin vlerën e vet.



- Po ty, a të pëlqen më shumë filmi apo libri? Argumentoje përgjigjen tëndel!
- A duhet të pajtohesh gjithmonë me mendimin e të tjerëve? Sa është i rëndësishëm mendimi yt?
- Pasi e keni kuptuar sa i rëndësishëm është mendimi juaj, realizoni një diskutim të ngjashëm në klasë për sportet!



Mendimi ndryshe

Situata 2. Vjosa, bashkë me familjen e saj, kishte kohë që ishte zhvendosur për të jetuar në Gjermani. Me të kisha kaluar kohë shumë të bukur, sidomos gjatë verës. Kur më tha se do të vinte këtë verë, u gëzova shumë. Koha iku shpejt dhe, ja, vera erdhi. Ditën që po prisja ta shihja, nuk përmbahesha dot nga gëzimi. Kur e pashë shoqen time, nuk e njoha fare. Ajo kishte veshur një palë pantallona të gjera, që dukeshin si fustan. U çudit! Sa shumë kishte ndryshuar Vjosa!

- Pse u çudit shoqja kur e pa Vjosën?
- A ndryshon mënyra e veshjes dhe e sjelljes nga një vend në tjetrin?
- Çfarë duhet të kemi parasysh që t'i shmangim keqkuptimet?



Të kesh mendim ndryshe prej të tjerëve, rreth një teme a çështjeje, është krejtësisht e natyrshme. Sepse njerëzit zhvillohen ndryshe dhe kanë kultura të ndryshme. Dallimet në mendime duhen parë si vlerë e mundësi dhe jo si pengesë. Nxënësit, për shembull, duhet të jenë pranues dhe jo diskriminues ndaj njëri-tjetrit. Ata duhet të mbështetin bashkëmoshatarët e tyre, edhe pse mund të kenë mendim ndryshe. Zëri i të gjithë individëve duhet dëgjuar dhe vlerësuar. Mendimi ndryshe nxit kreativitetin e konkurrencën dhe rrjedhimisht ndihmon për zgjidhjen më të shpejtë të problemeve dhe krijimin e ideve të qarta për zhvillim.



Fjalët kyçe: mendim ndryshe, respekt reciprok, mospajtim, individ.

27



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes**
Diskutim përmes shqyrtimit të përbashkët

Parashtrohet pyetja:

- Çfarë mendoni, është më mirë të shikoni një film apo të lexoni një libër?

Pasi merren dy mendime të ndryshme nga nxënësit, nxënësi i tretë do të komentojë ose arsyetojë mendimet e nxënësve që dhanë përgjigje. Pastaj do të pyeten për sportet, se cili sport u pëlqen dhe do të argumentojnë mendimet e tyre.

Përmes leximit të tekstit të dhënë në libër, nxënësit do të kuptojnë që mendimi ndryshe nënkupton dhe duhet të shihet si një vlerë dhe mundësi më e mirë për zgjidhjen e problemeve të ndryshme.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit**
Analiza e tipareve semantike

Në etiketa janë paraqitur disa pyetje ku nxënësit do të përgjigjen po (+), jo (-) dhe nuk e di (?). Pyetjet mund të jenë të ndryshme që lidhen me të menduarit ndryshe. Dhe, pas plotësimit të tabelës, nxënësit do të lexojnë përgjigjet e tyre dhe do të argumentojnë ato.

A do të qëndroje me një shok/shoqe që ka mendime ndryshe nga ti?	
Nëse ti ke dëshirë të shikosh një film dhe shoku/shoqja ka dëshirë të luajë, a do të respektoje mendimin e shokut/shoqes?	
A do të këmbëngulje të ndryshosh mendimin e dikujt tjetër që ta përkrah mendimin tënd?	

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për angazhimin dhe bashkëpunimin me të tjerët.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës, faqe 22.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve

Rezultatet e të nxënit të temës:

Respekton dhe vlerëson dallimet kulturore, gjinore, etnike, fetare dhe personat me nevoja të veçanta në klasë, shkollë, lagje dhe më gjerë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1,2; VI.1,2,3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shumëllojshmëria fetare në vendin tonë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon besimet fetare në vendin tonë;
- Identifikon vlerat fetare;
- Vlerëson fetë e ndryshme.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektori, libri, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë



Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve

Shumëllojshmëria fetare në vendin tonë

Situata 1. Zakonisht, në orët e mesditës, dëgjonim zëra që vinin nga minaret e xhamisë dhe nga kambanat e kishës. Prindërit më panë që isha habitur, andaj, kur dolëm për një shëtitje, ata më dërguan në një vend ku i pashë të dyja objektet bashkë. Ata ma shpjeguan që ky ishte diversiteti fetar dhe se çdo njeri duhet të respektojë përkatësinë fetare të njerëzve të tjerë. Të gjithë janë të lirë t'i shprehin mendimet e tyre dhe të ndjekin çfarëdo besimi fetar që dëshirojnë.



Prishtinë, viti 1930



Ferizaj



Gjakovë



- Cilat komunitete fetare i njeh?
- Cilat festa fetare i di?



Situata 2. Mësuesja e historisë na shpjegoi për ndarjen e periudhave historike, shumë kohë më parë. Ajo thoshte: *shumë kohë para Krishtit*, M'u kujtuan ditët e Krishtlindjeve kur shihnim filmin me Plakun e Vitit të Ri me thesin e dhuratave. Nuk e di se përse në kujtesën time shpesh kisha menduar për dhuratat që merrja nga njerëzit e mi të dashur për festën e Bajramit dhe festat e tjera. Kishte raste që ato nuk më pëlqenin. Më vonë, qeshja me naivitetin tim prej fëmije.



- Pse duhet t'i njohim kulturat e ndryshme?
- Cila ka qenë dhurata më e bukur që ke marrë për një festë?



Zakonet, traditat dhe gjuha e çdo populli është e ndryshme, prandaj dhe kulturat janë të shumëllojshme. Ruajtja e larmisë kulturore konsiderohet vlerë. Bashkëjetesë fetare në një shtet kemi kur grupe të shumta fetare jetojnë së bashku, duke i respektuar besimet e njëri-tjetrit. Ne duhet t'i pranojmë kulturat e tjera, sepse mund të mësojmë prej tyre. Mirëkuptimi dhe toleranca midis njerëzve që u përkasin besimeve të ndryshme fetare, përbën vlerë kulturore që siguron paqe mes tyre. Shkolla luan rol të rëndësishëm në edukimin e nxënësve me paqe e dashuri. Ajo krijon mjedis të përshtatshëm ku respektohen besimet e ndryshme fetare dhe mbizotëron paqja dhe solidariteti. Si çdo kulturë tjetër, edhe kultura jonë identifikohet me traditat, zakonet, vlerat, veshjet, ushqimet etj.

Fjalët kyçe: kulturë fetare, traditë, zakon, vlerë.

29



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Insert

Gjatë leximit të tekstit të dhënë në libër, nxënësit kanë për detyrë që në fund të fjalisë ose paragrafit të tregohet diçka dhe duhet të vendoset një she-një.

- √ - nëse informacioni ka qenë i njohur
 - nëse informacionin e ke ditur ndryshe
 - + - nëse ke mësuar një informacion të ri
 - ? - nëse informacioni është i paqartë për ju
- Kështu do të diskutohen shenjat/simbolet e përdorura nga nxënësit lidhur me njësinë e lexuar. Secili nxënës do të vlerësojë, dëgjojë dhe respektojë mendimet e nxënësve të tjerë. Në rastet që ndonjë nxënës ka përdorur simbolin ?, do të marrin mendime edhe nga nxënësit e tjerë ose do të kërkohet që të sqarohet nga nxënësit e tjerë fjalia ose paragrafi.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënët

Diskutim në çifte dhe në grup

Duke u njoftuar me fetë e ndryshme në vendin tonë. Nxënësit së pari në çifte do të paraqesin njo-

huritë e tyre që kanë për secilën fe në vendin tonë. Pastaj, do të bëjnë grumbullimin e njohurive në grup dhe do të paraqesin para klasës.

Feja islame	Feja katolike	Feja ortodokse

Nxënësit kështu do të pasurojnë njohuritë e tyre lidhur me fetë e ndryshme që janë në vendin tonë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për bashkëpunimin dhe kryerjen e detyrave me përkushtim dhe përgjegjësi.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës, faqe 23-24.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve

Rezultatet e të nxënit të temës:

Respekton mendimet ndryshe të të tjerëve, pranon të tjerët ashtu si janë dhe i trajton në mënyrë të barabartë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3,8; II.1,2; III.9; VI.1,2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vlerat

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon vlerat njerëzore;
- Arsyeton veprimet sipas vlerave;
- Krijon tekst për vlerat me fjalët kyçe.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletorja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Matematikë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Parashikimi me terma paraparakë

Së bashku me nxënësit do të diskutojmë për vlerat njerëzore dhe çfarë mund të përfshijnë vlerat. Marrim mendime prej nxënësve se çka nënkutojmë me vlerë njerëzore dhe shënojmë në tabelë.



Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve

Vlerat

Situata 1. Motra e vogël e Dritanit po tërhiqte këmbët zvarrë e nuk po na arrinte dot. M'u duk sikur po qante. Unë me Dritanin nxitua hapat dhe kështu u larguam shumë prej saj. Dikur, zëri i saj nuk dëgjohej më. Ne nxitua për të arritur në teatrin e kukullave, për të siguruar orarin, por nuk kishim qëllim ta linim jashtë. Sapo arritëm te dera e teatrit, një plak, i kërrusur, por energjik, po e silte drejt nesh në krahë. U ndiem në faj...



- ? - Vazhdoni dialogun me plakun.
- Vazhdoni dialogun me motrën.
- Si u sollën me motrën e vogël të Dritanit?
- Pse u ndiem në faj?



Vlerat

Situata 2. Mësimi në distancë karakterizohet me shumë probleme, të cilave nuk mund t'u gjenim zgjidhje. Për shembull, shoku ynë i klasës nuk kishte telefon për të komunikuar. Çdo gjë në këtë kohë ishte e lidhur me teknologjinë. U kujtova që gjyshes sime i kishin dhuruar një telefon. Mendova se Besmirin në këto momente do t'i shërbente më shumë...



- Çfarë mendoni se bëri djali?
- Vazhdojeni tregimin ashtu siç mendon ti se do të zhvillohet më tutje.
- Po ju, si do të vepronit në një situatë të tillë?



Njerëz të ndryshëm kanë nevoja të ndryshme, prandaj duhet t'u qëndrojmë atyre pranë, duke u dhënë ndihmën tonë. Një njeri që nuk dëgjon apo një i verbër, ka nevojë që të shoqërohet nga dikush, pra për më shumë kujdes. Dikush që ka vështirësi në mësim, ka nevojë që të ndihmohet nga mësuesi/ja, si dhe nga shoqe/shokë që kanë rezultate më të mira në mësim. Motra apo vëllai më i vogël ka nevojë për më shumë kujdes. Në një situatë të tillë, kur ne u ofrojmë atyre mbështetje, kemi treguar vlerat tona të vërteta. Respekti duhet të ekzistojë te të gjithë dhe për të gjithë pa dallim race, gjinie dhe moshe. Është e rëndësishme që njerëzit kanë nevojë ta dinë se mund të mbështeten tek të tjerët. Ata duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe me dinjitet.

Fjalët kyçe: liri, paqe, respekt, tolerancë, barazi.

31



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Të nxënësit në bashkëpunim**

Nxënësit do të përcjellin leximin e tekstit të dhënë në libër. Së pari do të lexohet situata 1, dhe pastaj do të diskutohet me nxënësit lidhur me situatën.

- A kanë vepruar drejt fëmijët?
- Si do të veproje ti në këtë situatë?
- Çfarë do të këshilloje?

Lidhur me situatën 2, nxënësit do të vazhdojnë tregimin në fletoret e tyre dhe disa prej tyre do të lexohen dhe do të komentohen së bashku me nxënësit e tjerë.

Përmes kësaj nxënësit do të kuptojnë që veprimet që i bëjnë, lidhen kryesisht me vlerat që i kanë. Kështu do të mësojnë që respekti mbi të gjitha është një vlerë e lartë njerëzore.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Fjalët kyçe**

Përmes fjalëve kyçe: liri, paqe, respekt, tolerancë dhe barazi, nxënësit do të shkruajnë nga një ese të shkurtër për vlerat.

Lexohen deri në tri ese dhe do të diskutohen së bashku me nxënësit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për saktësinë në dhënien e përgjigjeve dhe angazhimin në diskutim.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës, faqe 25-26.

Reflektim për njëdhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve

Rezultatet e të nxënit të temës:

Vlerëson solidaritetin si vlerë njerëzore dhe merr pjesë në aktivitete përkrahëse për njëritjetrin në shkollë dhe mjedis shoqëror.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1; V.5,8; VI.2,3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Solidariteti - vlerë njerëzore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Jep shembuj të solidaritetit;
- Shpjegon veprimet sipas solidaritetit;
- Rekomandon vepra të solidaritetit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletorja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Matematikë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Nxënësit pyeten nëse kanë pasur rastin që të ndihmojnë ndonjëherë ndonjë person në nevojë. Marrim disa shembuj dhe i diskutojmë me nxënësit e klasës, që në këtë rast kanë bërë solidaritet ndaj të tjerëve.


Nxënësit kështu përmes shkëmbimit të përvojave të çfarëdoshme të ndihmës, do të kuptojnë sa i rëndësishëm është solidariteti.



Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve

Solidariteti - vlerë njerëzore

Situata 1. Në rrugicën tonë jetonte një plak i vetmuar. Ndihej i fuqishëm dhe kryente vetë aktivitetet e përditshme. Ne luanim përpara portës së tij të drunjtë dhe ai shpesh bëhej spektatori ynë i vetëm. Kishte ditë që nuk e shihnim më. U bënë javë. Një pasdite pamë një infermiere që doli nga dera e drunjtë...



- Vazhdojeni tregimin, duke shprehur se si duhet të ndihmohen të sëmurët e vetmuar.

- A kujdeset shteti për njerëzit e vetmuar?



Situata 2. Në vitin 2020, përhapja e virusit Korona vuri në panik mbarë globin. Gjatë pandemisë, gjithë bota u bë solidarë për t'i bërë ballë vullit të tij. Njerëzit treguan humanizëm e solidaritet në periudhën e karantinimeve shtetërore, duke ndihmuar për t'u shpëtuar jetën personave të rrezikuar...



- Sillni shembuj të tjerë të solidaritetit.
- Cilët janë njerëzit që kanë nevojë për mbështetje?
- Çfarë kujdesi duhet treguar për ta?

Solidariteti ka të bëjë me lidhjet shoqërore, të cilat i mbajnë njerëzit së bashku. Ai i fuqizon marrëdhëniet shoqërore. Përmes solidaritetit, njerëzit njëjtësohen emocionalisht me të tjerët, veçanërisht me ata që i ndajnë interesat dhe vlerat e përbashkëta, duke i mbështetur dhe përkrahur ata në forma të ndryshme. Do të thotë të njohësh dhe të mbrash të drejtat e të tjerëve. Solidariteti është mënyrë jetese, për t'u ofruar mbështetje njerëzve në çastet e vështira. Të tregosh solidaritet do të thotë të veprësh në të mirë të një personi apo grupi tjetër shoqëror. Duke mbrojtur interesat e tyre, ne mbrojmë interesat tanë.

Fjalët kyçe: solidaritet, vlerë njerëzore, mbështetje, përgjegjësi e përbashkët.

33



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Leximi i drejtuar

Situata 1 do t'i nxisë nxënësit të mendojnë më shumë për veprimin që kanë bërë fëmijët duke u kujdesur për plakun që ishte i sëmurë. Do të marrim së paku tri mendime të nxënësve për të vazhduar tregimin e situatës.

Do të pyeten nëse kanë njohuri:

- A kujdeset shteti për njerëzit e vetmuar?
- Lidhur me situatën 2, do të japin shembuj të solidaritetit gjatë kohës së pandemisë. Do të tregojnë nëse kanë bërë solidaritet ose nëse dikush ka treguar solidaritet ndaj tyre.
- Do të parashtrohen pyetje për nxënësit pas leximit të përmbledhjes.
- Si ndikon solidariteti në raportet njerëzore?
 - Çfarë kupton me solidaritetet?



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Rrjeti i diskutimit

Në pjesën e fundit të orës, nxënësit do të paraqesin ndonjë rast ku do të mund të bënin solidaritet. Në mënyrë vullnetare do të tregojnë situata ku

mund të ndihmojnë dhe si do të duhej të vepronin në këto raste. Në mënyrë të përbashkët do të marrin vendim që të bëjnë solidaritet.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për mendimet dhe përgjigjet e dhëna.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës, faqe 27.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Shoqëria dhe mjedisi
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Respekton mendimet ndryshe të të tjerëve, pranon të tjerët ashtu siç janë dhe i trajton në mënyrë të barabartë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3,8; II.1; III.3; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Barazi për të gjithë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon të drejtat e tij/saj;
- Shpreh mendime për barazinë;
- Argumenton mendimet e veta.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë, libri, fletorja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
 Gjuhë shqipe, Matematikë, Shkathësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Anagrami

Prej nxënësve kërkohet që të tregojnë disa të drejta të tyre, të cilat do të shënohen edhe në tabelë. Meqë sot do të flasim për barazinë, atëherë në tabelë do të shënohet fjala BARAZI në mënyrë vertikale, ku për secilën shkronjë do të shënohet nga një fjali që lidhet me barazinë.

- B - Beni i trajton të gjithë në mënyrë të barabartë.
- A - Askush nuk duhet të m'i mohojë të drejtat e mia.
- R - Roli ynë është i rëndësishëm në shoqëri.
- A - Askush të mos lejojë diskriminimin mes vajzave dhe djemve.
- Z -
- I -



Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve

Barazi për të gjithë

Situata 1. Aktiviteti fizik është i shëndetshëm për të gjithë. Fëmijët zakonisht pëlqejnë lojërat në natyrë. Në shkollë do ta zhvillojmë kampionatin e futbollit. Secili, sipas interesave, shpreh dëshirën për të qenë pjesëmarrës në ekip. Ne luajmë shpesh futboll në kohën e lirë. Blerta nuk u përfshi në ekipin e shkollës...



- Vazhdoni tregimin dhe bëjeni një zgjidhje të drejtë për Blertën.
- Cilat mund të jenë arsyet e mospërfshirjes së Blertës në ekip?
- Listoni një sërë veprimtarish që ju kufizojnë të merrni pjesë.
- A duhet që edhe vlerësimi në mësimet të bëhet mbi bazën e barazisë?

Barazi për të gjithë



Situata 2. Asnjëherë nuk e kam parë veten të pabarabartë me shokët e shoqet, qofshin këta djem, qofshin vajza. Në familjen tonë kjo ndjenjë ishte kultivuar që në fëmijërinë e hershme, ku prindërit nuk na ndanin punët në punë djemsh apo punë vajzash. Nëna dhe babai ynë kujdeseshin për ne pa dallim...



- Çfarë kujdesi kanë treguar nëna dhe babai?
- Çfarë të mirash sjell në shoqëri trajtimi në mënyrë të barabartë?
- Po mësuesi/ja, si ju trajton në klasë?
- Tregoni raste nëse jeni ndier të paragjykuar dhe jo të barabartë.

Barazia nënkupton të jesh i trajtuar në mënyrë të barabartë me të tjerët para ligjit, si dhe të gëzosh të gjitha të drejtat, liritë dhe mundësitë sikurse të tjerët. Sipas ligjit, burrat dhe gratë kanë të drejta të barabarta. Barazia gjinore është një prej vlerave themelore të shoqërisë demokratike. Rëndësi kanë parandalimi dhe eliminimi i dhunës gjinore. Nxënësit duhet të reagojnë në rastet kur vënë re se shkelen të drejtat e dikujt. Mësuesi/ja duhet të trajtojë të gjithë nxënësit/et me respekt, pa bërë dallime se nga vjen, kush je, si dukesh etj. Fëmijët edukohen që në shkollë për të trajtuar me respekt dhe me dinjitet fëmijët e tjerë dhe njerëzit në përgjithësi, pavarësisht nga gjinia, prejardhja, statusi etj. Kjo kontribuon që të kemi një shoqëri pa diskriminime, ku të gjithë trajtohemi në mënyrë të barabartë dhe kemi mundësi të barabarta.

Fjalët kyçe: barazi, barazi gjinore, marrëdhënie, diskriminim, respekt. 35



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Ditari dypjesësh**

Situatat do të lexohen dhe do të diskutohen së bashku me nxënësit. Nxënësit duke i dhënë mendimet e tyre, do të plotësojnë kështu vazhdimin ose përfundimin e situatës.

Pas leximit të pjesës kryesore, nxënësit do të realizojnë ditarin dypjesësh, ku në njërën anë shënojnë pjesën e zgjedhur dhe në anën tjetër bëjnë komentimin e pjesës së zgjedhur.

Pjesa e zgjedhur	Komentimi



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënët
Tryeza e rrumbullakët**

Në pjesën e fundit të orës, pasi të jetë përfunduar ditari dypjesësh nga nxënësit, ata do të formojnë tryezën e rrumbullakët.

Nxënësit në mënyrë vullnetare do të lexojnë ci-

tatat dhe komentimet e tyre dhe do të krahasohen me komentimet e nxënësve të tjerë, nëse kanë përzgjedhur citatin e njëjtë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për fjalorin e pasur që e përdorin gjatë përgjigjeve dhe komentimeve.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës, faqe 28.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 15

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve

Rezultatet e të nxënit të temës:

Vlerëson solidaritetin si vlerë njerëzore dhe merr pjesë në aktivitete përkrahëse për njëritjetrin në shkollë dhe mjedis shoqëror.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.2; V.8; VI.2,3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Toleranca dhe miqësia

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon raste të tolerancës;
- Përmend shembuj të ndihmës ndaj shokëve/shoqeve;
- Shpjegon veprimet e tolerancës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletorja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Shkathësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Shkrim i lirë

Përmes shkrimit nxënësit do të tregojnë ndonjë rast të tolerancës që e kanë bërë ose që e kanë dëgjuar/shikuar te dikush tjetër.

Disa prej shkrimeve do të lexohen para klasës dhe do të diskutohen së bashku me nxënësit e tjerë.



Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve

Toleranca dhe miqësia

Situata 1. Vjosa vazhonte klasën e katërt, por pasi mësimi ishte online, kishte vështirësi: kishte probleme me shikim dhe nuk i kishte pajisjet e nevojshme për mësim online. Edhe vëllai i shokut të saj të klasës, Shpatit, kishte të njëjtat vështirësi. Sa e admironte Shpati vullnetin e tij për mësim. Ai kishte ditë që nuk e shihte Vjosën në mësim. Ai bisdoi me vëllanë e madh, duke i thënë se, meqenëse prindërit i kishin blerë një pajisje të re për të lexuar, t'ia faltë pajisjen e tij të vjetër Vjosës. Ai pranoi me shumë kënaqësi, pasi mendoi se kjo do ta ndihmonte Vjosën që të lexonte, duke qenë se pajisja zmadhonte shkronjat në ekran. Vjosa me siguri do të gëzohej dhe do të ishte falënderuese ndaj Shpatit.



- Si i ndihmoni shoqet/shokët në nevojë?
- A duhen ndihmuar vetëm njerëzit që njohim?
- Keni pasur raste kur keni ndihmuar të tjerët?

Situata 2. Shoku i bankës sot erdhi pak me vonë dhe nuk na përshëndeti si zakonisht. Dukej i mërzitur dhe i lodhur, por nuk foli... Jeta e ngacmoi me stilolaps nga pas. Ai befasi thirri:
- Çfarë bën? Mos më ngacmo...



Toleranca dhe miqësia



- A ishte i drejtë veprimi i Jetës? Pse?
- Pa reagimi i shokut? Pse?
- A jeni gjendur në një situatë të tillë?
- Si keni vepruar?
- Jepni argumente pro dhe kundër temës: "Miqë e mirë janë tolerantë".



Të gjithë jemi të barabartë, prandaj duhet ta respektojmë njëri-tjetrin. Kjo arrihet nëpërmjet tolerancës. Të jesh tolerant do të thotë ta vlerësosh dhe ta pranosh tjetrin për atë që është, pa e paragjykuar dhe pa e diskriminuar. Toleranca shërben për vendosjen e paqes mes grupeve të ndryshme shoqërore, pasi pranon edhe diçka që nuk të pëlqen. Toleranca krijon mundësinë e mirëkuptimit dhe të bashkëpunimit mes njerëzve. Ne krijojmë shoqëri me shumë njerëz në shkollë dhe në komunitet. Me disa që i njohim më mirë dhe kemi një lidhje më të ngushtë, krijojmë miqësi. Miqësia është lidhja më e gjatë dhe më e rëndësishme me tjetrin. Ajo na vë përpara disa detyrave ndaj të tjerëve. Miqësia karakterizohet nga dashuria, besimi, ndershmëria, respekti, toleranca etj.

Këshilla:

- Toleranca të mëson të vlerësosh njerëzit që janë ndryshe nga ti, ndryshe në dukje, në bindje, në prejardhje etj.
- Toleranca të mëson të pranosh mendimin e tjetrit, edhe kur nuk është i njëjtë me mendimin tënd.
- Toleranca krijon mundësi dhe ura komunikimi.
- Toleranca krijon hapësira për njëri-tjetrin.
- Toleranca shmang mosmarrëveshjet dhe keqkuptimet dhe nxit bashkëpunimin.

Fjalët kyçe: tolerancë, miqësi, mosmarrëveshje, pranim.

37



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes DRTA

Gjatë leximit të situatave dhe tekstit të dhënë në libër, nxënësve do t'u parashtrihen pyetje lidhur me tekstin.

Nxënësit do te pyeten:

- A i keni ndihmuar ndonjëherë shokët/shoqet?
- Si i ndihmoni shokët/shoqet në nevojë?
- A keni pasur raste kur të tjerët ju kanë ndihmuar juve?
- A jeni treguar tolerant ndonjëherë ndaj veprimeve të shokut/shoqes?
- Çka kuptoni me fjalën tolerancë?

Përmes këtyre pyetjeve realizohet diskutimi së bashku me nxënësit.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Rrjet i diskutimit

Te pjesa e fundit e orës mësimore do të shpërndahet te secili grup nga një etiketë, që përmban nga një pyetje. P.sh.:

- Pse mendoni që është e rëndësishme toleranca?
- Sa është e vështirë të praktikosh tolerancën?
- A mendon që tregohesh më tolerant ti ndaj të tjerëve, apo të tjerët tregohen me shumë tolerantë ndaj teje?

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për angazhimin e treguar.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës, faqe 29-30.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve

Rezultatet e të nxënit të temës:

Respekton dhe vlerëson dallimet kulturore, gjinore, etnike, fetare dhe personat me nevoja të veçanta në klasë, shkollë, lagje dhe më gjerë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.1,3; II.2; III.1; IV.5; V.8; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mbështesim njëri-tjetrit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon vlerat kulturore të njeriut;
- Përshkruan kontributin e secilit anëtar të familjes;
- Shpreh respekt për mendimin e tjetrit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografii, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Imagjinatë e drejtuar

U parashtrajmë pyetje nxënësve:

- Cilat janë punët që i kryejnë anëtarët e familjes suaj?
- A e dini ju se cilat janë vlerat kulturore të njeriut?
- Po ju në shtëpi, çfarë punë bëni?


Nga mendimet e marra nga nxënësit kalojmë te situata e dhënë në tekst.



Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve

Mbështesim njëri-tjetrit

Situata 1. Në familje gjithkush jep kontributin e vet. Disa nga pjesëtarët e familjes japin edhe kontribut financiar. Vëllai im i madh punon në një televizion dhe paguhet sipas orëve që punon. Muajtjn e kultur, ai ishte i ngarkuar me ljerjen e shtëpisë dhe pothuajse nuk punoi. E kuptova edhe nga çokollatat e zakonshme që më munguan. Kur ai paguhej, më blinte çokollatat e preferuara. Ndihej në siklet që nuk m'i bleu, ndërkohë më bëra sikur harrova. Në mbrëmje nëna erdhi në shtëpi me disa çokollata dhe një ëmbëlsirë të madhe. "Këto i keni nga unë sot", - thia duke buzëqeshur.



- ? - A kontribuuan të gjithë në familje?
- Cilët kontribuuan financiarisht?
- Po vëllai i madh, si kontribuoi?



Mbështetja e njëri-tjetrit

Situata 2. Genti ishte një lojtar futbollit shumë i mirë. Ai stërvitej vazhdimisht me skuadrën e tij. Shpesh, skuadra ishte fituese në kampionatet mes shkollave. Në kampionatin e radhës, skuadra e futbollit ku Genti ishte lojtar kishte vështirësi për organizimin e lojës. Ai mendoi të kërkonte ndihmë te shoku i tij i fëmijërisë, i cili luante po aq mirë sa Genti. Të dy së bashku do të ishin një skuadër e fortë...



- Vazhdoni tregimin duke menduar një zgjidhje për të.
- Si e mbështet ti shokun apo shoqen tënde?
- Si e mbështet motrën apo vëllanë?
- Çfarë bën për t' u ndier mirë shoqja apo shoku yt?
- Si ndihesh në një rast kur shoqja apo shoku yt arrin sukses? Po kur ai ndodhet në vështirësi?




Njerëzit formojnë grupe shoqërore që janë pjesë përbërëse e shoqërisë. Individët jetojnë si qenie njerëzore të pavarura, por kanë nevojë për mbështetjen e njëri-tjetrit. Kjo i jep vlerat e vërteta një grupi shoqëror të caktuar. Një individ mund të marrë pjesë në më shumë se një grup. Ai ka dhe aftësi të veçanta që e bëjnë atë pjesë të grupeve të caktuara. Në shkollë, çdo nxënës duhet të ndihet i mirëpritur dhe i përfshirë në procesin mësimor, duke u mbështetur kur ka vështirësi. Në familje ne ndihmojmë njëri-tjetrin për zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Kur ka bashkëpunim në familje, shkollë dhe komunitet, punët shkojnë më mirë. Të gjithë duhet të përfshihen në veprimtari të përbashkëta, pasi kjo rrit bashkëpunimin dhe forcon miqësinë.

Fjalët kyçe: mbështetje, interes, grup, individ, miqësi.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Përvijim i të menduarit**

Shqyrtohet situata në libër, analizohen disa fjalë që kontribuojnë përkitazi me bashkëpunim.



Lexohet informacioni shtesë në libër rreth mbështetjes, mirëkuptimit, empatisë etj.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Shkrim i lirë**

Nxënësve në grupe u shpërndahet nga një fletë A4 duke ua caktuar një detyrë për zgjidhjen e një problemi. Secili grup ka për detyrë ta kryejë

punën ashtu si duhet.

Prezantohen grupet dhe përzgjedhim grupin që e ka kryer punën me përpikëri dhe ka bashkëpunuar me njëri-tjetrin.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për identifikimin e vlerave njerëzore, për përshkrimin e kontributit të secilit anëtar të familjes si dhe për respektin që e tregon ndaj njëri-tjetrit.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve

Rezultatet e të nxënit të temës:

Respekton dhe vlerëson dallimet kulturore, gjinore, etnike, fetare dhe personat me nevoja të veçanta në klasë, shkollë, lagje dhe më gjerë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.2; III.1; IV.5; V.8; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Me mendje dhe zemër për njerëzit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Jep shembuj nga jeta e përditshme për njerëz humanitarë;
- Vlerëson vlerat kulturore;
- Respekton dallimet fetare, kulturore, gjinore etj.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografji, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Kërkohet nga nxënësit të japin shembuj për humanizmin.

Pyeten:

- A keni ndihmuar ju ndonjë njeri në nevojë?
- Si jeni ndjerë kur keni ndihmuar?
- A e keni vendosur vetveten në situata të tilla?

Nga mendimet e nxënësve nënvizojmë në tabelë fjalët: empati, respekt, humanitet, përkrahje.



Mirëkuptimi, solidariteti, empatia dhe respekti ndaj të tjerëve

Me mendje dhe zemër për njerëzit

Situata 1. Nervat pamorë të Besmiri dhjetëvjeçar janë dëmtuar plotësisht, për shkak të një sëmundjeje në sy, e cila i ka shkakuar vështirësi në shikim. Besmiri rrezikon të mbetet pa shkollë. Një institucion arsimor, sapo dëgjoji rastin e tij, pranoi të punësonte një mësuese të veçantë për Besmirin. U siguruan të gjitha pajisjet ndihmëse, që djaloshi të mos ndihej ndryshe nga moshatarët. Prindërit e Besmirit u shprehën mirënjohje të thellë drejtuesve të shkollës. Sa humanë!



- Pse Besmiri ishte i shqetësuar?
- Cili institucion mund ta ketë ndihmuar Besmirin?
- Si u ndien prindërit e Besmirit? Pse?
- Po Besmiri, çfarë ka përjetuar në ato momente?



Me mendje dhe zemër për njerëzit

Situata 2. Nënë Tereza u dha njerëzve dashurinë e mbështetjen më të madhe. Sa humane! Shpesh, në orën e lëndës *Shoqëria dhe mjedisi* ne shprehim vlerësim për çdo kontribut në të mirë të njerëzve. Secili nga ne bëni aq sa mundet. Fëmijët ndihmojnë të moshuarit që kanë pranë. Mjekët ndihmojnë pacientët dhe këdo që ka nevojë për ta. Mësuesit përkujdesen që fëmijët të marrin sa më shumë dije. Ata ndihmojnë edhe fëmijët që kanë vështirësi. Po ashtu, shokët ndihmojnë njëri-tjetrin në situata të vështira.



- Çfarë dini ju për Nënë Terezën?
- Si u ka ndihmuar dhe si i ka mbështetur ajo njerëzit?
- Pse duhet ta ndihmojmë njëri-tjetrin?
- Po ju, a keni mbështetur njerëz në nevojë?



Mjedisi ku jetojmë është i larmishëm, sepse ka individë dhe grupe shoqërore të shumëllojshme. Ne duhet t'i pranojmë dhe t'i respektojmë të gjithë. Situata në të cilën ne përpiqemi që të ndihmojmë të tjerët në rast nevojë, ka të bëjë me sjelljen empatike. Empatia është aftësia për të kuptuar ndjenjat dhe përjetimet e të tjerëve. Ajo vetëdijëson për vuajtjet, dhimbjet dhe gëzimet e njerëzve të tjerë. Kjo bën që ne të jemi të ndjeshëm ndaj të tjerëve dhe të mendojmë për ndjenjat që përjetojnë ata, posaçërisht në gjendje dhe momente të vështira.



Fjalët kyçe: empati, mjedis, ndjenjë, shqetësim.

41



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Mësimdhënia e ndërsjellë**

Lexohet dhe diskutohet bashkërisht situata e parë në libër.

Kërkohet nga nxënësit të japin mendimet e tyre:

- Pse ishte i shqetësuar Besmiri?
- Cili institucion do të duhej t'i dilte në ndihmë Besmirit?
- Ku e vëreni humanizmin në këtë situatë?
- Po Besmiri si u ndje në ato momente?

Analizohet pjesa e dhënë në libër dhe theksohet se humanizmi, empatia, respekti, ndihma për njerëzit në nevojë janë vlerat më të larta njerëzore.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Shkrim i lirë**

Nxënësve u jepet për detyrë që të shkruajnë një ngjarje ku ata e kanë shprehur humanizmin e tyre në mënyra të ndryshme.

Lexohen dhe komentohen ngjarjet.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për dhënien e shembujve të njerëzve humanitarë, për vlerësimin e vlerave kulturore si dhe respektimin e dallimeve fetare, gjinore, racore etj.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mendime të ndryshme, vendime të përbashkëta

Rezultatet e të nxënit të temës:

Respekton mendimet ndryshe të të tjerëve, pranon të tjerët ashtu siç janë dhe i trajton në mënyrë të barabartë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.2; III.1; IV.5; V.8; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Respektoj mendimin e tjetrit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Respekton mendimin e tjetrit;
- Analizon tekstin;
- Përshkruan një ngjarje ku tregon respekt ndaj tjetrit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, projektor, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Diagrami i Venit

Nxënësit ndahen në çifte. Me anë të *Diagramit të Venit* paraqesin të përbashkëtat dhe dallimet që i kanë me njëri-tjetrin

Nxënësit punojnë në mënyrë individuale, pastaj i krahasojnë punimet.



Mendime të ndryshme, vendime të përbashkëta

Respektoj mendimin e tjetrit

Situata 1. Sa herë jemi gjendur përballë situatave të tilla... Shkaku ishte propozimi i mësueses për të organizuar një udhëtim drejt qendrave historike e kulturore. Dritani zgjodhi Krujën, si vendin ku do të njihet me historinë e Skënderbeut, muzeun, rrugët e rrugicat e bukura të qytetit... Blerita u shpreh se e kishte vizituar. I pëlqente më shumë Prizreni. Aty zinte fill historia e Lidhjes së Prizrenit dhe e figurave të shquara të historisë së shqiptarëve brenda e jashtë trojeve...




- Vazhdoni situatën, duke propozuar zgjidhje të tjera.
- Listoni argumente ku të mbështesni zgjedhjet tuaja.
- Në cilën mënyrë mendoni se e respektoni mendimin e tjetrit?

Situata 2. Shpesh, me prindërit diskutojmë për gjëra të ndryshme në familje, p.sh., si t'i ndajmë punët e shtëpisë, si t'u ndihmojmë gjyshërve kur kanë nevojë për ne etj. Vëllai i madh punon, pothuajse, gjithë ditën dhe shpeshherë nuk është i pranishëm në diskutimet tona...

Mendime të ndryshme, vendime të përbashkëta

Respektoj mendimin e tjetrit



- Si mendoni ta dëgjoni mendimin e vëllait?
- Si mendoni ta përfshini edhe atë më shumë në diskutimet tuaja?
- Krijoni një situatë të ngjashme dhe merrni mendimin e tij.



Njerëzit kanë mendime të ndryshme për origjinën, ashtu edhe për zgjidhjen e problemeve. Këto nuk duhet të ndikojnë për t'i ndarë ata nga njëri-tjetri. Ne duhet të dëgjojmë dhe ta respektojmë mendimin ndryshe. Ndaj të tjerëve duhet të sillemi me tolerancë dhe aqetari. Të dëgjojmë mendimin e gjithsecilit dhe të reflektojmë ndaj tij. Në të kundërt, mund të krijohen situata konflikti, të cilat i shmangim përmes qetësisë dhe tolerancës në komunikim. Respektimi i mendimit të tjetrit është baza e mirëkuptimit dhe harmonisë midis njerëzve. Njeriu duhet të respektojë dhe të ndihet i respektuar gjithmonë. Shkalla duhet të punojë që të sigurojë mjedisin e duhur në klasë për mbështetjen e nxënësve në procesin e të mësuarit. Ne kemi nevojë për kulturën e dialogut mes nesh.

Fjalët kyçe: mendim ndryshe, respekt, tolerancë, mirëkuptim.

45



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Mësimdhënia e ndërsjellë

Lexohet dhe diskutohet rasti në situatën e parë.
Kërkohen mendimet e nxënësve

- Në cilën mënyrë mendoni se e respektoni mendimin e tjetrit?

Analizohet pjesa e dhënë dhe diskutohet për të drejtat dhe përgjegjësitë.

Theksohet në veçanti bashkëpunimi me të tjerët dhe respekti ndaj të tjerëve.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Shkrim i lirë

Nxënësve u jepet për detyrë të shkruajnë ndonjë rast ku nuk janë pajtuar me mendimin e të tjerëve qoftë në shtëpi, shkollë apo komunitet.

- Si keni arritur një mirëkuptim?

Theksohen fjalët: tolerancë, mirëkuptim.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për respektimin e mendimit të tjerëve, për analizimin e situatave si dhe për përshkrimin e një ngjarjeje personale ku shpreh respekt ndaj të tjerëve.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mendime të ndryshme, vendime të përbashkëta

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon gatishmëri për të marrë vendime në konsultim me të tjerët duke i respektuar idetë dhe mendimet e tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.1,3; II.2; III.1; IV.5; V.8; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Hapat e vendimmarrjes

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon ngjarje ku ka marrë pjesë në vendimmarrje;
- Njeh konceptin vendimmarrje;
- Përshkruan disa hapa të vendimmarrjes.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektori, fotografi, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Shkathtësi për jetë, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Stuhi mendimesh

U kërkohet nxënësve të japin mendimet e tyre për vendimmarrjen.

Pyeten:

- Si e kuptoni fjalën vendimmarrje?
- A merrni pjesë në vendimmarrje në familje apo shkollë?
- Sa është i rëndësishëm roli juaj gjatë vendimmarrjes në familje apo shkollë?



Mendime të ndryshme, vendime të përbashkëta

Hapat e vendimmarrjes

Situata 1. Tani, edhe fëmijët janë të përfshirë në vendimmarrje, pra ata japin propozime për organizimin e planit të aktiviteteve. Shumë nxënës, jo vetëm që planifikojnë aktivitete dhe veprimtari, por janë të aftë të grupohen vetë në grupe sipas roleve e përgjegjësi që marrin.




- Si përfshihen në marrjen e vendimeve në shkollë?
- Çfarë keni parasysh kur merrni vendime?
- Sa i rëndësishëm është roli i nxënësve në marrjen e vendimeve për procesin mësimor e sa për veprimtaritë?

Situata 2. Shkolla jonë kishte filluar të rindërtohej. Fëmijëve u pëlqejnë shumë aktivitetet dhe lojërat. Në pjesën ballore të godinës, ishte vendosur projekti i rindërtimit. Na pëlqeu pamja e re që do të merrte godina, por kur vërejtëm me kujdes, aty nuk ishte planifikuar palestër e sallë lojërash. Vendosëm të bisedonim me mësuesin e edukatës fizike fillimisht. Pas diskutimeve, ai na tha se duhej të dërgonim një kërkesë me shkrim në drejtorinë e shkollës...

Mendime të ndryshme, vendime të përbashkëta

Hapat e vendimmarrjes



- Shkruani një kërkesë-propozim për ndërtimin e një palestere në shkollë.
- Kujt mendoni t'ia dërgoni kërkesën?
- Si mendoni se do të ndikojë propozimi juaj?
- Tregoni disa situata të ngjashme, ku jeni të përfshirë në marrjen e vendimeve të rëndësishme në shkollën apo klasën tuaj.

Procesi i vendimmarrjes kërkon njerëz të vetëdijshëm dhe të përgjegjshëm për atë që bëjnë, sepse duhet të arrihen zgjidhje të kënaqshme për palët pjesëmarrëse. Pra, vendimmarrja është edhe proces i arritjes së kompromisit. Por, para se të merren vendime, njerëzit diskutojnë me njëri-tjetrin. Ndërsa, diskutimi duhet të bëhet sipas disa rregullave. Prandaj, për t'u marrë vesh sa më mirë me njëri-tjetrin, hartohen rregulla që duhen zbatuar nga të gjithë. Fëmijët duhet të ndihen të pranuar, të respektuar, të mbrojtur, të barabartë në ambientet brenda dhe jashtë shkollës. Përfshirja në vendimmarrje nënkupton pjesëmarrjen e fëmijëve në planifikim, në ndarjen e përgjegjësisë, në aktivitetet e ndryshme etj.

Disa hapa që duhen pasur parasysh gjatë marrjes së vendimit janë:

- përcaktohet qartë se për çfarë do të votohet;
- paraqiten fakte, materiale dhe informacione, për të argumentuar pyetjet që dalin;
- nxënësit japin zgjidhjet e tyre për situatën;
- shqyrtohen zgjidhjet e mundshme, duke parë anët pozitive dhe negative të tyre;
- duhet synuar marrëveshje ndërmjet palëve për një zgjidhje, e cila argumentohet mirë.
- nëse nuk arrihet ajo, atëherë opsionet hidhen në votim. Opsioni që merr më shumë vota, fiton.

Fjalët kyçe: vendimmarrje, propozim, diskutim, vendim.

47



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Përvijim i të menduarit

Shqyrtojme situatën e parë të dhënë në libër. Së bashku analizojmë dhe përcaktojmë disa fjalë që kontribuojnë në bashkëpunim dhe vendimmarrje.

DIALOG, PROPOZIM, E DREJTË, PËRGJEGJËSI, BASHKËPUNIM

Formulojmë konceptin vendimmarrje.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Mendim i lirë

Së bashku lexojmë një situatë që kemi përgatitur paraprakisht dhe nga kjo situatë e argumentojmë mënyrën e marrjes së vendimeve si dhe hapat që duhen zbatuar gjatë procesit të vendimmarrjes.

Nënvizojmë në tabelë hapat e vendimmarrjes.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për procesin e vendimmarrjes ku ishte pjesë e saj, për përkufizimin e konceptit vendimmarrje si dhe përshkrimin e hapave të vendimmarrjes.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mendime të ndryshme, vendime të përbashkëta

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon gatishmëri për të marrë vendime në konsultim me të tjerët duke i respektuar idetë dhe mendimet e tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; II.2; IV.5; V.8; VI.2,3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Eja të vendosim së bashku

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Kujton procesin e zgjedhjes së kryetarit të klasës;
- Jep shembuj të vendimmarrjes;
- Organizon një proces të zgjedhjes në klasë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektori, fotografi, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Shkathtësi për jetë, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Imagjinatë e drejtuar

Kujtojmë nga e kaluara si e kemi bërë përzgjedhjen e kryetarit të klasës. Nxënësit japin mendimet e tyre duke e rikujtuar procesin e përzgjedhjes.



Mendime të ndryshme, vendime të përbashkëta

Eja të vendosim së bashku

Situata 1. Në fillim të çdo viti shkollor organizojmë takimin me prindër. Tashmë dihet që, për të ecur mirë procesi edukativo-mësimor, bëhen zgjedhjet e këshillit të prindërve. Isha kurioz të dija nëse edhe prindërit ndiqnin të njëjtat rregulla siç i ndiqnim ne në zgjedhje...



- Krijoni një situatë ku paraqitet zgjedhja e kryetarit të klasës suaj.
- Tregoni vazhdimin e situatës së mësipërme.
- Cilat janë rregullat e zbatuara në secilën zgjedhje?

Mendime të ndryshme, vendime të përbashkëta

Eja të vendosim së bashku



Situata 2. Në klasën tonë kishte kohë që kishte ardhur një nxënëse e re, e cila vinte nga një qytet tjetër. Ne përhoqeshim të ishim të dashur me të, por vërehej se Jetës diçka i mungonte. Mësuesja na këshilloi t'i qëndronim afër. Një ditë, ajo erdhi vonë dhe e shqetësuar. Morëm vesh se jetonte me gjyshen e kujdesej për të. Prindërvë u ishte dashur të shkonin në një shtet tjetër për punë.



- Si do ta ndihmonit Jetën që ajo ta përballonte më lehtë mungesën e përkoqshme të prindërvë të saj?



Shkolla duhet t'u ofrojë mësuesve, prindërvë dhe nxënësve mundësinë për të shprehur mendimin e tyre, mundësinë për pjesëmarrje dhe vendimarrje. Pjesëmarrja demokratike fillon në nivel klase. Çdo klasë ka përfaqësuesin e saj, kryetarin e klasës, i cili përfaqëson klasën në këshillin e shkollës. Edhe prindërit zgjedhin përfaqësuesin e prindërvë të klasës, i cili bashkëpunon me mësuesin/in për zgjidhjen e problemeve që mund të kenë nxënësit. Prindërit i kërkojnë dhe i mbrojnë të drejtat e fëmijëve të tyre, nëpërmjet pjesëmarrjes në vendimarrje. Fëmija duhet të jetë në qendër të të gjitha marrëdhënieve të krijuara. Në shkollë duhet të ekzistojnë lidhje të ngushta mësues-nxënës. Nxënësit duhet t'i dëgjohet fjala dhe të aktivizohet në marrjen e vendimeve. Në mjedisin e shkollës duhet të ekzistojë respekti reciprok dhe toleranca. Kështu nxënësit do të ndihen më të vlerësuar dhe më aktivë në marrjen e vendimeve.

Klasa ndahet në dy grupe:

Grupi I: Tregoni një rast që keni arritur vendimarrjen e përbashkët si klasë. Si u bë e mundur një gjë e tillë?

Grupi II: Tregoni një rast kur keni arritur të merrni një vendim të përbashkët si klasë. Cilat ishin vështirësitë me të cilat u përballët?

Fjalët kyçe: vendimarrje e përbashkët, tolerancë, pjesëmarrje.

49



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Punë në grupe

Shqyrtohet situata e parë e dhënë në libër si dhe informacioni shtesë rreth vendimarrjes dhe organizimit.

Ndajmë klasën në dy pjesë:

Grupi A - Tregon një ngjarje ku procesi i vendimarrjes ka shkuar në mënyrë transparente.

Grupi B - Tregon një ngjarje ku procesi i vendimarrjes nuk ka shkuar ashtu si duhet.

Organizojmë zgjedhje në klasë.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Rjeti i diskutimit

Nxënësit diskutojnë dhe bëjnë pyetje për organizimin e përzgjedhjes së kryesisë së klasës, i krahasojnë me proceset e vendimarrjes gjatë viteve të kaluara.

Pyeten:

- A ishte procesi demokratik dhe transparent?

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përshkrimin e zgjedhjes së kryesisë së klasës, dhënien e shembujve të ngjashëm si dhe organizimin e një procesi zgjedhor në klasë.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mendime të ndryshme, vendime të përbashkëta

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon gatishmëri për të marrë vendime në konsultim me të tjerët duke i respektuar idetë dhe mendimet e tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; II.2; IV.5; V.8; VI.2,3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Në familje vendosim së bashku

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Liston disa rregulla në familje;
- Analizon tekstin;
- Përshkruan të drejtat dhe përgjegjësitë në familje.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografia, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Imagjinatë e drejtuar

Nxënësit shprehin mendimet e tyre se si i marrin vendimet në familjet e tyre.

- Cili është roli i vajzave apo grave në vendimmarrje në familje?
- Cili është roli i fëmijëve në vendimmarrje në familje?

Nga mendimet e nxënësve kalojmë te situata e dhënë në libër.



Mendime të ndryshme, vendime të përbashkëta

Në familje vendosim së bashku

Situata 1. Nënës i erdhi një ofertë e mirë pune. Dëgjoja shpesh bisedat me prindërit dhe dilemat e tyre. Motra më tha se kishte mundësi që të largoheshim nga qyteti ku banonim. Kisha gjithë shokët e shoqet në qytet, nuk më erdhi mirë...



- Vazhdoni situatën në formë dialogu mes prindërve e fëmijëve.
- A e jep mendimin tënd për çështjet që diskutohen në familjen tënde?
- Listoni disa çështje për të cilat është domosdoshmëri të jepni mendimin tuaj.

Situata 2. Në fund të vitit, traditë jona familjare është t'i dhurojmë njëri-tjetrit dhuratat. Zgjedhim gjërat që janë më të domosdoshme e më të përdorshme. Vendosëm t'i bënim një surprizë mamasë. Në mbrëmje, mblodha motrat e vëllezërit dhe u thashë të shkruanin në një letër dhuratën që mendonin për mamanë. Po si do të vendosim më pas? - pyeti vëllai i vogël...

Mendime të ndryshme, vendime të përbashkëta

Në familje vendosim së bashku



- Si mendoni ju se do të marrin vendimin për dhuratën e nënës?
- Po ti, me kë këshillohesh për vendimet që merr?



Në familje kemi të drejta dhe përgjegjësi. Ne duhet t'i respektojmë mendimet e anëtarëve të familjes, ta ndihmojmë dhe ta mbështesim njëri-tjetrin. Fëmijët duhet të kenë përgjegjësi, që u përshtraten moshës së tyre, sepse kështu ata ndihen të plotësuar dhe të rëndësishëm në familje. Përfshirja e fëmijëve në jetën e familjes është një nga parimet e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës. Fëmijët duhet të shprehin lirshëm mendimin që kanë.

Ja disa këshilla që duhen pasur parasysh:

- këshillohu në familje për problemet e ndryshme që mund të kesh;
- mbaj një kalendar për festat më të rëndësishme në familje;
- dëgjo me vëmendje se çfarë thonë pjesëtarët e tjerë të familjes;
- trego respekt për mendimet e anëtarëve të familjes;
- gjej fjalët e duhura për t'i përdorur në komunikim.

Fjalët kyçe: familje, pjesëmarrje, mendim i lirë, këshillë.

51




Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Përvijim i të menduarit

Shqyrtojme situatën e parë të dhënë në libër. Duke analizuar së bashku përcaktojmë disa fjalë që ndërlidhen me vendimmarrjen në familje.



Në tabelë listojmë disa rregulla, të drejta dhe përgjegjësi në familje.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Mendim i lirë

Paraprakisht përgatishim një situatë dhe nga kjo situatë, diskutojmë së bashku duke i argumentuar mënyrat e marrjes së vendimeve në familje si dhe barazinë gjinore.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për listimin e rregullave në familje, analizën e tekstit si dhe përshkrimin e të drejtave dhe përgjegjësi në familje.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mendime të ndryshme, vendime të përbashkëta

Rezultatet e të nxënit të temës:

Vlerëson solidaritetin si vlerë njerëzore dhe merr pjesë në aktivitete përkrahëse për njëritjetrin në shkollë dhe mjedis shoqëror.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; II.2; IV.5; V.8; VI.2,3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Në komunitetin tonë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Kujton disa rregulla në komunitet;
- Analizon tekstin;
- Përkrahur të drejtat dhe përgjegjësitë në komunitet.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektori, fotografi, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shkathtësi për jetë, Gjuhë dhe komunikim, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Shpreh mendimin e lirë

Përmes videoprojektorit shfaqim disa fotografi në lidhje me të drejtat në komunitet, barazinë gjinore, rregullat në shoqëri.

Diskutohen fotografitë dhe parashtrihen pyetje.



Mendime të ndryshme, vendime të përbashkëta

Në komunitetin tonë

Situata 1. Duke pritur në stacionin e autobusit, vura re një djalë me biçikletë, i cili po prishte si të tjerët. Sapo erdhi autobusi, djali tentoi të hynte brenda. Përballë portës ishte vendosur tabela ku shkruhej se ndaloheshin biçikletat e mjetet e tjera motorike. Një i moshuar aty pranë i tha djalit se duhej ta zbatonte rregullën. Është një vendim i marrë dhe i pranuar nga të gjithë. Në çast mendova: *Po fëmijët me karroca, lejohen që të lëvizin me autobus?*



- Si mendoni për rregullën e përshkruar më sipër?
- A duhen zbatuar të gjitha rregullat?
- A ju ka ndodhur të keni pasur dilema dhe të pyesni e këshilloheni me dikë tjetër?



Në komunitetin tonë

Situata 2. Në shkollat tona është shumë e vështirë ngrohja e mjediseve të brendshme. Menduam të përdornim ngrohëse, apo kondicionerë, por mësuesi na tha se rritet kostoja e energjisë. Menduam të bënim një takim me përfaqësuesit e komunës, të cilët ndoshta do të na ndihmonin ta gjenim një zgjidhje.



- Shkruani një kërkesë dhe përpiluni t'i bindni drejtuesit për atë që kërkon.
- Si mendoni të përfshiheni në vendime që ju përkasin dhe juve?



Vendimarrja është e rëndësishme në jetën e secilit prej nesh. Çdo ditë ne marrim vendime të rëndësishme, të cilat ndikojnë në jetën tonë. Vendimi është një proces që ka të bëjë me zgjedhjen mes dy apo më shumë alternativave. Në shoqëri, të gjithë duhet t'i njohim dhe t'i zbatojmë disa rregulla, të cilat janë të rëndësishme për të pasur mirëkuptim mes vete. Vendimi që është më i mirë për një person, nuk do të thotë se është më i miri edhe për personat e tjerë. Njerëzit e ndryshëm i shohin problemet në mënyra të ndryshme, rrjedhimisht zgjidhjet që propozojnë janë të ndryshme. Duhet të kemi parasysh pasojat që vijnë nga vendimet që marrim. Ato nuk duhet të dëmtojnë të tjerët. Çdo vendim që merret duhet të jetë në të mirë të shoqërisë. Vendimarrja varet nga njohuritë që kanë anëtarët e grupit. Pjesëmarrja në proceset vendimmarrëse është mundësi që u jepet qytetarëve për t'i shprehur mendimet e tyre.

Fjalët kyçe: komunitet, problem, marr pjesë, rregull.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Puna grupore

Lexohet pjesa e tekstit që është në libër.
Nxënësit i ndajmë në tre grupe.

Grupi A - Organizojnë diskutimet për barazinë gjinore në shoqëri.

Grupi B - Argumenton situatën e djalit me biçikletë, pro ose kundër.

Grupi C - Argumenton situatën e të moshuarit, pro ose kundër.

Diskutohet edhe më tutje për situatën.



Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Pesëvargëshi

Shkruhet një pesëvargësh me fjalën barazi.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për kujtimin e disa rregullave në komunitet, analizimin e tekstit si dhe përshkrimin e të drejtave dhe përgjegjësive në komunitet.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 23

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mendime të ndryshme, vendime të përbashkëta

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon vendimmarrjen dikur dhe sot në familje, shoqëri dhe institucione dhe shfrytëzon ato përvoja në vendimmarrjet e tij/saj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: V.8; VI.2,3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Institucionet dhe vendimet

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon institucionet lokale dhe ato qendrore;
- Përkufizon konceptin institucion;
- Analizon tekstin.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektori, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Kllaster

Përmes teknikës kllaster paraqiten disa institucione vendimmarrëse, veçojmë ato lokale dhe qendrore.



Mendime të ndryshme, vendime të përbashkëta

Institucionet dhe vendimet

Situata 1. Kishite ditë që kishim ndërprerje të ujit të pijshëm në banesë. Ndërmarrja e ujësjellësit nuk kishte njoftuar për mungesën e ujit. Duhej të kishim defekt. Babai pyeti nënën nëse ishte përshkruar në kontratë ndërprerja për arsye teknike. Ishte hera e parë që e dëgjoja dhe nuk isha interesuar kurrë për këto shërbime. M'u duk vetja i rritur...



- Listoni disa nga pikat që mendoni se do t'i lexonte fëmija në kontratë.
- Këshillohuni me prindërit dhe, bashkë me ta, lexoni kontratën tuaj me një nga institucionet e shërbimeve.



Situata 2. Përmes procesit të zgjedhjeve, zgjidhen përfaqësuesit e popullit - deputetët e parlamentit. Deputetët zgjedhin presidentin a presidenten, si njeriun më përbashkues. Sa e sa herë e kishim përfytyruar kreun e vendit, si human/e, demokrat/e, njerëzor/e, popullor/e...



- Si merret vendimi për zgjedhjen e presidentit?
- A keni parë ose ndjekur ndonjë proces votimi. Luteni mësuesin/en që t'ju shpjegojë një të tillë. Krahasojeni, pastaj, me votimet që keni bërë ju për zgjedhjen e ndonjë çështjeje në klasë.



Njerëzit jetojnë së bashku në një mjedis të caktuar, prandaj duhet t'i njohin dhe t'i zbatojnë disa rregulla. Ato mund të jenë rregulla shoqërore, të cilat nuk janë të shkruara, dhe rregulla ligjore, të cilat janë të detyrueshme për të gjithë. Shteti rregullon jetën e banorëve të një vendi. Për të bërë sa më mirë detyrat e tij, ekzistojnë institucionet qendrore dhe ato lokale. Institucionet kanë për detyrë që të kërkojnë zbatimin e këtyre rregullave. Institucionet qendrore drejtojnë gjithë vendin, kurse institucionet lokale plotë-sojnë nevojat e banorëve në komuna të ndryshme. Të gjithë njerëzit mbi 18 vjeç kanë të drejtë të votojnë, për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre për pushtetin qendror dhe atë lokal. Për pushtetin qendror, ata zgjedhin deputetët e parlamentit, të cilët miratojnë ligje në të mirë të shoqërisë. Deputetët zgjedhin qeverinë që do t'i drejtojë. Po ashtu, parlamenti zgjedh edhe presidentin e vendit, i cili përfaqëson unitetin e kombit.

Fjalët kyçe: institucion, vendim, rregull, ligj, komunë.

55

Diskutim – pyetje dhe përgjigje.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për dallimin e institucioneve lokale dhe atyre qendrore, për përkufizimin e konceptit institucion si dhe analizimin e tekstit.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Mësimdhënia e ndërsjellë

Lexohet teksti i dhënë në libër dhe analizohet duke parashtruar pyetje:

- Pse e pyeti babai nënën për kontratën me kompaninë e ujësjellësit?
- Cilat fjalë ishin me rëndësi të veçoheshin në kontratë.
- Po ju a keni lexuar ndonjëherë ndonjë kontratë që ka bërë familje juaj me ndonjë institucion?

Bazuar edhe në prezantimin e institucioneve lokale dhe qendrore, nxënësit kanë më shumë njohuri për funksionin e tyre.



Përforsimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve Shkrim i lirë

Nxënësve u shpërndahen fletë A4 në grupe, ku secili grup do të formulojë një koncept për fjalët: komunë, qeveri, kuvend komunal, gjykatë, parlament. Konceptet prezantohen nga përfaqësuesit e grupeve.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mendime të ndryshme, vendime të përbashkëta

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon vendimmarrjen dikur dhe sot në familje, shoqëri dhe institucione dhe shfrytëzon ato përvoja në vendimmarrjet e tij/saj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; II.2; IV.5; V.8; VI.2,3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vendimmarrja dikur dhe sot

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Kujton konceptin vendimmarrje;
- Bën dallimin me vendimmarrjen dikur dhe sot;
- Analizon tekstin.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, fotografi

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Shkathtësi për jetë, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Shpreh mendimin e lirë

Nga njohuritë paraprake, nxënësit i japin mendimet e tyre për konceptin vendimmarrje. Nga mendimet e nxënësve kalojmë në situatën e parë duke lexuar atë.



Mendime të ndryshme, vendime të përbashkëta

Vendimmarrja dikur dhe sot

Situata 1. Në shtëpinë e Bledit kishte filluar një diskutim interesant. Të gjithë pjesëtarët e familjes ishin përfshirë në të.
 - Ne duam që të dëgjohet zëri ynë në familje, - thoshte Bledi. - Edhe pse ne jemi fëmijë, duhet të na kërkohet mendimi për vendimet që merren në familje.
 - Kanë ndryshuar gjërat, - i drejtua babai Bledit. - Ne ju kemi marrë mendimin juve. Për shumë gjëra në familje, kemi vendosur së bashku. Kur unë kam qenë fëmijë si ti, - vazhdoi ai të fliste, - babai im nuk na pyeste fare, por vendoste vetë për të gjitha gjërat. Gjyshi yt, si kryefamiljar që ishte, i merrte të gjitha vendimet në familjen tonë, por edhe gjyshi ndryshoi me kalimin e kohës. Sot, ai ndihet shumë i lumtur kur dëgjon nipat dhe mbesat e tij tek shprehin mendimet e tyre lirshëm.
 Bledi u habit nga fjalët e babait. Ai donte të dinte më shumë rreth asaj që i tha babai. Biseda e tyre vazhdoi. Në fund, Bledi kuptoi se shumë gjëra kishin ndryshuar për të mirë nga e kaluara.

- ?**
- Për çfarë po bisedonte Bledi me babanë?
 - Çfarë kërkoi Bledi nga babai?
 - Pse u habit ai nga përgjigjja e babait?
 - Vazhdoni bisedën midis Bledit dhe babait!
 - Pyesni edhe ju prindërit tuaj dhe diskutoni së bashku në klasë, duke krahasuar se si merreshin vendimet në të kaluarën dhe si merren sot.

Vendimmarrja shërben për të zgjidhur në mënyrë të drejtë problemet me të cilat përballemi në jetën e përditshme. Vendimi merret duke zgjedhur alternativën më të mirë të mundshme. Vendimmarrja mund të bëhet me një numër të madh njerëzish, ku secili prej tyre ka mundësi të barabarta për të diskutuar. Vendimi duhet të merret nëpërmjet komunikimit në grup, pasi kështu merret vendimi i duhur. Sot, për shumë vendime që merren, dëgjohe mendimi i shumicës. Njerëz të ndryshëm kanë mendime të ndryshme, prandaj duhet të diskutojnë të gjithë anëtarët e grupit dhe të pajtohen për një vendim të përbashkët që duhet të merret. Kjo mundëson marrjen e vendimeve të drejta dhe gjetjen e zgjidhjeve më të mira për problemet me të cilat përballemi.

56 Fjalët kyçe: vendimmarrje, dikur, sot, grup.



57



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Përvijim i të menduarit

Nga situata e lexuar, diskutojmë dhe bëjmë pyetje:

- Për çfarë po bisedonte Bledi me babain?
- Çfarë kërkoi Bledi nga babai?
- Pse u habit ai nga përgjigja e babait?

Vazhdohet biseda e Bledit me babain.
Diskutim, pyetje-përgjigje.

Krahasojmë vendimmarrjen sot me vendimmarrjen dikur.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve

Shpreh mendimin e lirë

Nxënësve u jepet nga një fletë A4 të shkruajnë mendimin e tyre me njohuritë që kanë për vendimmarrjen sot dhe të krahasojne me vendimmarrjen dikur.

Nxënësit lexojnë mendimet e tyre – diskutim.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përkufizimin e konceptit vendimmarrje, për krahasimin e vendimmarrjes dikur dhe sot si dhe analizën e tekstit

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Vendi ku jetoj

Rezultatet e të nxënës të temës:

Përshkruan festën e Pavarësisë së Kosovës dhe simbolet shtetërore të saj (stemën, flamurin, himnin).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.1; II.2; IV.5; III.1; VI.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kosova - atdheu im

Rezultatet e të nxënës të orës mësimore:

- Përshkruan me fjalë atdheun - Kosovën;
- Analizon tekstin;
- Identifikon sistemin qeverisës në Kosovë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografii, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathësi për jetë, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Stuhi mendimesh

Nxënësit japin mendimet e tyre për Kosovën.

Nga mendimet e tyre kalojmë te situata e parë.



Vendi ku jetoj

Kosova - atdheu im

Situata 1. Mësuesi, kërkoj nga nxënësit të shkruajnë çfarë dinë për Kosovën. Nxënësit me shumë dëshirë thurën vargje, duke zgjedhur fjalët më të bukura për vendin tonë. Në klasë u organizua një garë për zgjedhjen e poezisë më të bukur. Ata i lexuan ato para klasës. Poezia më e bukur ishte ajo e Malit, të cilën vendosën ta dërgonin në redaksi për botim. Eja ta lexojmë edhe një herë së bashku...



Kosova

E dua Kosovën e maleve të Sharrit
E dua Kosovën e Adem Jasharit.
E dua Kosovën, të fortë e trimë
Të luftëtarëve e nënave heroike.
E dua Kosovën e qëndresës
Të fjalës e të besës.
E dua Kosovën e dashurisë
E dua Kosovën e mirësisë.
E dua për malet e gjelbëruara,
E dua për pasuritë e bekuara.
E dua Kosovën e Kushtetutës dhe të ligjit,
Të dua ashtu si je
Se për mua je më i bukur i ATDHE.



- Çfarë mendon për këtë poezi?
- Përse përmendet luftëtari Adem Jashari?
- U përmend "redaksia e botimit". Kërkojini mësuesin që t'ju shpjegojë se si mund t'i botoni shkrimet tuaja.
- Si e tregon ti dashurinë për vendin tënd?
- Përse ekzistojnë kushtetuta dhe ligji në një shtet?



Atdheu tregon rrënjët tona, vendi ku kemi lindur, tregon traditat dhe zakonet tona. Atdheu ynë është Kosova. Ne jemi krenarë për vendin tonë. Kosova ka trashëguar shumë bukuri natyrore. Ne krenohemi me vendin tonë të dashur. Ne krenohemi me historinë e Kosovës, e cila shërben si një udhërrëfyes për gjithë brezat e rinj. Kosova qeveriset me sistem demokratik, i cili përbëhet nga tri degë të pavarura të pushtetit: Parlamenti, Qeveria dhe Gjyqësori. Që të tria këto, punojnë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, të cilat nxirren nga Parlamenti.

60 Fjalët kyçe: Kosovë, atdhe, shqiptar, kosovar.



Vendi ku jetoj

Kosova – atdheu im

Situata 1. Mësuesi, kërkoi nga nxënësit të shkruajnë çfarë dinë për Kosovën. Nxënësit me shumë dëshirë thurën vargje, duke zgjedhur fjalët më të bukura për vendin tonë. Në klasë u organizua një garë për zgjedhjen e poezisë më të bukur. Ata i lexuan ato para klasës. Poezia më e bukur ishte ajo e Malit, të cilën vendosën ta dërgonin në redaksi për botim. Eja ta lexojmë edhe një herë së bashku...



Kosova

E dua Kosovën e maleve të Sharrit
E dua Kosovën e Adem Jasharit.
E dua Kosovën, të fortë e trimë
Të luftëtarëve e nënave heroike.
E dua Kosovën e qëndresës
Të fjalës e të besës.
E dua Kosovën e dashurisë
E dua Kosovën e mirësisë.
E dua për malet e gjelbëruara,
E dua për pasuritë e bekuara.
E dua Kosovën e Kushtetutës dhe të ligjit,
Të dua ashtu si je
Se për mua je më i bukur i ATDHE.



- Çfarë mendon për këtë poezi?
- Përse përmendet luftëtari Adem Jashari?
- U përmend "redaksia e botimit". Kërkojini mësuesin që t'ju shpjegojë se si mund t'i botoni shkrimet tuaja.
- Si e tregon ti dashurinë për vendin tënd?
- Përse ekzistojnë kushtetuta dhe ligji në një shtet?

Atdheu tregon rrënjët tona, vendi ku kemi lindur, tregon traditat dhe zakonet tona. Atdheu ynë është Kosova. Ne jemi krenarë për vendin tonë. Kosova ka trashëguar shumë bukuri natyrore. Ne krenohemi me vendin tonë të dashur. Ne krenohemi me historinë e Kosovës, e cila shërben si një udhërrëfyes për gjithë brezat e rinj. Kosova qeveriset me sistem demokratik, i cili përbëhet nga tri degë të pavarura të pushtetit: Parlamenti, Qeveria dhe Gjyqësori. Që të tria këto, punojnë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, të cilat nxirren nga Parlamenti.

60 | Fjalët kyçe: Kosovë, atdhe, shqiptar, kosovar.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Përvijim i të menduarit

Lexohet situata e parë dhe diskutohet duke u bërë pyetje:

- A ju pëlqeu poezia e Malit dhe pse?
- Çfarë përmbante ajo?
- Kush është Adem Jashari?
- Pse është e rëndësishme që çdo vend të ketë Kushtetutën dhe ligjet e veta?

Nënvizojmë fjalët: atdhe, qeveri, parlament, kushtetutë, ligje, sistem demokratik.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Bisedojmë së bashku

Nxënësit u përgjigjen me shkrim pyetjeve të dhëna në tekst duke e bërë një interaktivitet mes vete me pyetje dhe përgjigje.

Përgjigjet vlerësohen në fund të orës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përshkrimin me fjalë të Kosovës, analizimin e tekstit si dhe identifikimin e sistemit qeverisës në Kosovë.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Vendi ku jetoj

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan festën e Pavarësisë së Kosovës dhe simbolet shtetërore të saj (stemën, flamurin, himnin).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, II.2; III.1,2; VI.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pavarësia e Kosovës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon për Pavarësinë e Kosovës;
- Shpjegon ngjyrat dhe simbolet e flamurit të Kosovës;
- Interpretin himnin e Kosovës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Videoprojektori, fotografi, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Stuhi mendimesh, kllaster



Çfarë dini për Pavarësinë e Kosovës (mendimet parqiten në formë kllasteri).

Vendi ku jetoj

Pavarësia e Kosovës



Situata 1. Në familjen e Kledit po përgatiten për udhëtim. Ata do të shkojnë për pushime në Angli. Sa i emocionuar është Kledi 6-vjeçar, sepse është hera e parë që ai do të udhëtojë me aeroplan. Të gjithë po mbledhin gjërat e nevojshme dhe po i palosnin në valixhe.

Mamaja erdhi me pasaportat në dorë. Këto janë më të rëndësishmet, se pa to nuk mund të hyjnë në aeroplan. Kledi mori pasaportën në dorë dhe po e shikonte me kujdes.

- Babi, - pyeti ai. - Pse në pasaportë është flamuri ynë?

- Nuk është flamuri, biri im. Është stema e Kosovës, - tha babai.

- Çfarë është stema?

- Secili shtet ka flamurin, stemën dhe himnin e tij. Këto janë simbolet e shtetit. Simbolet e përfaqësojnë shtetin tonë në të gjithë botën. Edhe shteti ynë, Kosova jonë e dashur, që nga data 17 shkurt 2008, ka fituar Pavarësinë, është shpallur shtet dhe quhet Republika e Kosovës. 17 Shkurti është festa jonë shtetërore.

- Pse në flamur janë gjashtë yje? - vazhdoi Kledi.

- Sepse, përveç shqiptarëve, në Kosovë jetojnë edhe popuj të tjerë.

- Ua, - ndërhyri mamaja. - Vazhdoni një herë tjetër bisedën se koha po ikën e ne duhet të nisemi.

Kledi për herë të parë dëgjoji për simbolet e shtetit dhe iu duk shumë interesante.





Vendi ku jetoj

Pavarësia e Kosovës



- Kur është shpallur Pavarësia e Kosovës?
- Cilat janë simbolet shtetërore?
- Cilët popuj simbolizojnë vjet në flamurin e Kosovës?
- Kur dëgjohet himni i Kosovës?
- Si e festoni 17 Shkurtin në familje dhe në qytetin apo fshatin tuaj?
- Dëgjoni në klasë himnin e Kosovës, ngrihuni në këmbë dhe këndoni bashkë me mësuesen/in tuaj. Shpreh mendimin tënd për temën: "Ndihem krenar për vendin tim".



Pavarësia e Kosovës u shpall më 17 shkurt 2008. Kjo datë shënon festën më të rëndësishme shtetërore të Kosovës dhe festohet me shumë dashuri. Në të gjithë vendin tonë dhe në të gjitha vendet ku jetojnë shqiptarët, organizohen aktivitetet festive për ta shënuar këtë ditë. Shteti ynë krijoi simbolet shtetërore: flamurin, stemën dhe himnin shtetëror.

Flamuri i Kosovës ka ngjyrën e kaltër, mbi të është vënë një hartë e verdhë e Kosovës dhe ka gjashtë yje të bardha sipër saj. Yjet zyrtarisht nënkuptojnë gjashtë popujt - komunitetet etnike që jetojnë në Kosovë.

Stema e Kosovës është simbol i Republikës së Kosovës.

Himni është një këngë solemne, e cila ekzekutohet në ceremonitë shtetërore, në çdo veprimtari ndërkombëtare, në ngjarjet sportive ku vendi ynë është pjesëmarrës, si dhe në raste të tjera të përcaktuara me ligje përkatëse.



62 **Fjalët kyçe:** simbol shtetëror, flamur, stemë, himn, festë shtetërore, 17 Shkurti, pavarësi.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Pyetje-përgjigje

Nxënësit do t'u përgjigjen pyetjeve në tekst, në grupe. Njëri grup lexon pyetjen dhe tjetri grup përgjigjet.

Analizohet situata e dhënë në libër.

Nxënësit nxjerrin pyetje nga situata dhe u përgjigjen atyre.

Nënvizojmë fjalët: flamur, simbol, stemë, ngjyra, himni shtetëror.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Shkrim i lirë

Nxënësit shkruajnë një ese të shkurtër për Pavarësinë e Kosovës.

Esetë lexohen dhe vlerësohen në fund të orës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përshkrimin e Pavarësisë së Kosovës, për përshkrimin e simboleve të flamurit si dhe interpretimin e himnit të shtetit të Kosovës.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Vendi ku jetoj

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon regjionet e Kosovës dhe evidenton disa karakteristikë të tyre (gjeografike, kulturore, ekonomike).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; II.2; III.1,2; VI.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Regjionet e Kosovës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon regjionet e Kosovës;
- Evidenton disa karakteristikë të tyre;
- Analizon tekstin.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektori, fletë A4, harta gjeografike.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Stuhi mendimesh dhe përvijm i të menduarit

Para fillimit të mësimi bëhet një përvijm i orës së kaluar me pyetjet e përzgjedhura nga mësuesi/ja: Pyeten:

- Çfarë dini për Kosovën?
- A keni dëgjuar për regjionet e Kosovës?
- A dini ndonjë karakteristikë të regjioneve në Kosovë?

Vendi ku jetoj


Regjionet e Kosovës



Situata 1. Luna dhe Lisi janë shokë të mirë. Ata vendosën të mësonin mësimin "Regjionet e Kosovës", në shtëpinë e Lisi, sepse nëna e tij është mësuese gjeografike. Të gjithë nxënësit e duan shumë mësuesen Lirike, sepse ajo shpjegon mësimin përmes lojës.

Mësuesja Lirike kishte përgatitur hartën e Kosovës, ku një pjesë të saj e kishte ngjyrosur me të kaltër e një pjesë me të verdhë. Ajo shpjegoi se Kosova është e ndarë në dy regjione: Fusha e Kosovës dhe Rrafshi i Dukagjinit. Ajo vazhdoi duke iu treguar se Kosova ka shtatë qendra regjionale. Mori etiketat me emra dhe i vendosi tri në Rrafshin e Dukagjinit: Gjakova, Peja dhe Prizreni, kurse katër të tjera në Fushën e Kosovës: Ferizaj, Gjilani, Mitrovica dhe Prishtina. Etiketat me emrin e Prishtinës e kishte me ngjyrë të kuqe, që të dallohej nga qendrat e tjera regjionale, sepse Prishtina është kryeqyteti i Kosovës.

Luna dhe Lisi u kënaqën shumë. - Nuk do t'i harrojmë asnjëherë këto që mësuam sot, - thanë ata.





Vendi ku jetoj

Regjionet e Kosovës



- A mësoni edhe ju ndonjëherë përmes lojës?
- Cilat janë regjionet e Kosovës?
- Cilat janë qendrat regjionale të Kosovës?
- Në cilin regjion jetoni ju?
- Cili është kryeqyteti i Kosovës?
- Përmend disa karakteristika të regjioneve të Kosovës.

Njihuni me disa nga vendet karakteristike të qendrave regjionale të Kosovës.

Peja	Peja dallohet për Grykën e Rugovës dhe burimin e Drinit të Bardhë.
Gjakova	Gjakova dallohet për Kodrën e Çabratit, Lumin Erenik dhe Lumin Krena.
Prizreni	Në Prizren gjendet ndërtesa e Lidhjes së Prizrenit dhe malet e Sharrit me bukuritë magjepsëse.
Ferizaj	Në Ferizaj është ndërtuar Kampi i Ushtrisë Amerikane.
Gjilani	Gjilani dallohet për kalanë mesjetare të Artanës (Novobërdës).
Mitrovicë	Në Mitrovicë është miniera e Trepçës.
Prishtina	Në Prishtinë është Biblioteka Kombëtare "Pjetër Bogdani", Muzeu Kombëtar i Kosovës, Muzeu Etnografik i Kosovës, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" etj.

Hulumto dhe gjej disa vende karakteristike të regjionit ku jeton dhe të regjioneve të tjera të vendit tonë. Prezanto para klasës punën e bërë dhe diskutoni rreth saj.

64 | Fjalët kyçe: qendër regjionale, regjion, kryeqytet.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Insert

Analizojmë situatën e parë dhe vendosim:

√ - për informacionin e njohur.

+ - për informacionin e ri që e mësuam.

? - për informacionin e panjohur.

Diskutim për informatat e panjohura që janë hasur në tekst.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Tryezë e rrumbullakët

Nxënësit parashtrojnë pyetje njëri-tjetrit, të ndarë në grupe, duke krijuar një interaktivitet në mes grupeve.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për dallimin e regjioneve të Kosovës, për evidentimin e disa karakteristikave të regjioneve të Kosovës si dhe analizimin e tekstit.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Vendi ku jetoj

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon komunitetet etnike në Kosovë, përshkruan disa veçori dhe simbolet e tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; II.2; III.1,2; VI.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Komunitetet dhe veçoritë e tyre

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon komunitetet etnike në Kosovë;
- Tregon veçoritë dhe simbolet e tyre;
- Përkufizon termin komunitet etnik.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografia, fletë A4, videoprojektori.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Stuhi mendimesh

Flamuri i Kosovës vendoset në tabelë.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të mësuesit/es me kohë të caktuar, 3 minuta.

Pyeten:

- Çfarë paraqesin yjet në flamur?
- Cili është qëllimi i vendosjes së yjeve?

Nga përgjigjet nxënësve kalojmë te situata e parë.

Vendi ku jetoj



Komunitetet dhe veçoritë e tyre

Situata 1. Gjyshja e Kleas ka shumë dëshirë të qëndisë. Ajo i ka qëndisur Kleas shumë fustane e triko dhe të gjitha shoqeve u pëlqejnë. Në veshjet e Kleas duket se po çelin lulet shumëngryrëshe. Një ditë ajo vendosi të qëndiste flamurin e Kosovës. Punonte gjithë ditën se kishte dëshirë ta kishte gati për 17 Shkurtin - festën e Pavarësisë së Kosovës.

- Ke duar të arta, moj gjyshe! Më dukesh si Marigona e Flamurit, - i tha Klea. - Nuk kam parë flamur më të bukur!

Gjyshja po prekte me radhë yjet në flamur dhe po tregonte diçka nga tradita e secilit popull që jeton në vendin tonë.

- Secili popull që jeton në vendin tonë ka zakonet e tij, kulturën e tij, që e karakterizon atë. Është e rëndësishme që të gjithë popujt t'i respektojnë kulturat e njëri-tjetrit dhe të jetojnë në tolerancë.

- Ti je si një libër historie, moj gjyshja ime e dashur, - tha Klea dhe e përqafoi me shumë dashuri.



- Përmend komunitetet etnike që jetojnë në Republikën e Kosovës!
- Përshkruaj të drejtat e komuniteteve etnike në Republikën e Kosovës!
- Cilat gjuhë zyrtare fliten në Republikën e Kosovës?
- A i respekton secili komunitet në vendin tonë traditat dhe zakonet e popullit të tij?



Flamuri i Kosovës ka gjashtë yje të bardha. Yjet zyrtarisht nënkuptojnë gjashtë popujt - komunitete etnike që jetojnë në Kosovë: shqiptarët, serbët, turqit, boshnjakët, romët dhe goranët.

Gjuhë zyrtare në Kosovë janë: gjuha shqipe dhe gjuha serbe. Të gjithë kanë të drejtë të flasin gjuhën e tyre, t'i ndjekin zakonet, traditat, besimin fetar dhe të festojnë festat e tyre. Kjo tregon se të gjitha komunitetet në Kosovë respektohen dhe ato kanë të drejta të barabarta.



Fjalët kyçe: komunitet etnik, pakicë kombëtare, gjuhë zyrtare.

Vendi ku jetoj

Komunitetet dhe veçoritë e tyre



Situata 1. Gjyshja e Kleas ka shumë dëshirë të qëndisë. Ajo i ka qëndisur Kleas shumë fustano e triko dhe të gjitha shoqeve u pëlqejnë. Në veshjet e Kleas duket se po çelin lulet shumëngyrëshe. Një ditë ajo vendosi të qëndiste flamurin e Kosovës. Punonte gjithë ditën se kishte dëshirë ta kishte gati për 17 Shkurtin - festën e Pavarësisë së Kosovës.

- Ke duar të arta, moj gjyshi! Më dukesh si Marigona e Flamurit, - i tha Klea. - Nuk kam parë flamur më të bukur!

Gjyshja po prekte me radhë vjet në flamur dhe po tregonte diçka nga tradita e secilit popull që jeton në vendin tonë.

- Secili popull që jeton në vendin tonë ka zakonet e tij, kulturën e tij, që e karakterizojnë atë. Është e rëndësishme që të gjithë popujt t'i respektojnë kulturat e njëri-tjetrit dhe të jetojnë në tolerancë.

- Ti je si një libër historie, moj gjyshja ime e dashur, - tha Klea dhe e përqafoi me shumë dashuri.



- Përmend komunitetet etnike që jetojnë në Republikën e Kosovës!
- Përshkruaj të drejtat e komuniteteve etnike në Republikën e Kosovës!
- Cilat gjuhë zyrtare fliten në Republikën e Kosovës?
- A i respekton secili komunitet në vendin tonë traditat dhe zakonet e popullit të tij?



Flamuri i Kosovës ka gjashtë vje të bardha. Vjet zyrtarisht nënkuptojnë gjashtë popujt - komunitete etnike që jetojnë në Kosovë: shqiptarët, serbët, turqit, boshnjakët, romët dhe qoranët. Gjuhë zyrtare në Kosovë janë: gjuha shqipe dhe gjuha serbe. Të gjithë kanë të drejtë të flasin gjuhën e tyre, t'i ndjekin zakonet, traditat, besimin fetar dhe të festojnë festat e tyre. Kjo tregon se të gjitha komunitetet në Kosovë respektohen dhe ato kanë të drejta të barabarta.



Fjalët kyçe: komunitet etnik, pakicë kombëtare, gjuhë zyrtare.

65



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Diskutim i përbashkët

Analizojmë situatën e parë dhe diskutojmë bashkë me nxënësit duke bërë pyetje:

- Çfarë po i tregonte gjyshja Kleas?
- Cila ishte rëndësia e yjeve në flamur?
- Çfarë i tha Klea gjyshes?

Nënvizojmë fjalët: komunitet etnik, shqiptar, serb, boshnjak, turq etj.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Turi i Galerisë

Nxënësit në internet gjejnë për komunitetet në Kosovë dhe në grupe shkruajnë karakteristikat për secilin komunitet veç e veç.

Në google: Komunitet etnike në Kosovë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për identifikimin e komuniteteve etnike në Kosovë, për përshkrimin me fjalë të veçorive të tyre si dhe për përkufizimin e termit komunitet etnik.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Shoqëria dhe mjedisi
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Vendi ku jetoj

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Identifikon komunitetet etnike në Kosovë, përshkruan disa veçori dhe simbolet e tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; II.2; III.1,2; VI.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Fqinjët e Kosovës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon shtetet fqinje të Kosovës;
- Tregon ndonjë karakteristikë të tyre;
- Analizon tekstin.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, harta gjeografike, fotografi, puzzle.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Stuhi mendimesh


Nxënësve në grupe u jepet detyrë që të formojnë figura në formë mozaikësh (me puzzle) me shtetet si: Kosova, Mali i Zi, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Serbia. I vendosin në tabelë dhe diskutohet rreth tyre për gjuhët që fliten në këto shtete.

Me anë të hartës gjenden edhe anët e horizontit dhe tregohet që me këto shtete kufizohet Kosova.



Vendi ku jetoj
 Fqinjët e Kosovës

1 Përmend shtetet fqinje me të cilat kufizohet Kosova. Bisedoni për to.



Vendi ku jetoj

Fqinjët e Kosovës



- Çfarë sheh në fotografinë e dhënë?
- Çfarë bën polici?
- Çfarë po i dorëzon shoferi? Pse?
- Në cilin shtet ke shkuar ti? Me çfarë dokumenti e ke kaluar kufirin?

Cdo shtet është i rrethuar me shtetet përreth, që quhen shtete fqinje. Shtetet ndahen ndërmjet vete me kufij. Kështu, Kosova kufizohet me Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Serbinë dhe Malin e Zi. Pra, këto janë shtetet fqinje të Kosovës.

Hapësira e caktuar mes dy shteteve që shërben për të kontrolluar personat dhe mallrat që kalojnë nga një shtet në tjetrin quhet vendkalim kufitar. Në këto vende janë organet policore që regjistrojnë hyrjet dhe daljet e personave, të automjeteve dhe të mallrave nga një vend në tjetrin. Të gjithë personave që kalojnë kufirin, u kërkohet pasaporta dhe dokumente për mallrat që i transportojnë.

Kosova ka shumë pika kufitare. Disa nga vendkalimet kufitare që lidhin Kosovën me shtetet fqinje janë: Qafë-Morina, Qafë-Prushi, Morina, që lidhin Kosovën me Shqipërinë.

Vendkalimi kufitar "Kulla" lidh Kosovën me Malin e Zi.

Në secilën nga këto vendkalime kufitare është flamuri i të dyja shteteve që i lidh ai kufi.

Fjalët kyçe: shtet fqinj, vendkalim kufitar, kontroll, organe policore, pasaportë, dokument.

67



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Diskutim i përbashkët

Lexohet nga nxënësit teksti i dhënë në libër duke u përgjigjur pyetjeve që janë në libër.

Tregohet që shtetet që janë formuar me puzzle janë shtete fqinje të Kosovës.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Ditari dypjesësh

Ndajmë fletën në dy pjesë dhe në njërin anë vizatojnë hartën e vendit fqinj të Kosovës, në pjesën tjetër shkruajnë për këto shtete (ndonjë karakteristikë).

Harta	Karakteristika

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për identifikimin e fqinjëve të shtetit të Kosovës, për tregimin e ndonjë karakteristike të tyre si dhe analizën e tekstit.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Jeta në Kosovë dikur dhe sot

Rezultatet e të nxënësve të temës:

Krahason jetën në familje dikur dhe sot, në fshat dhe qytet, si rezultat i zhvillimeve shoqërore (shkollimit dhe punësimit masiv, në veçanti të femrës, funksionimit dhe menaxhimit të familjes, zhvillimit të transportit, elektrifikimit, ujësjellësit etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1,6; III.1,2; V.8; VI.3,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Familja dikur dhe sot

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Prezanton familjen e tij/saj;
- Analizon tekstin e dhënë;
- Dallon familjen tradicionale nga ajo bashkëkohore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografii.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Stuhi mendimesh


Ndahen në grupe nxënësit dhe secili grup paraprakisht sjellin nga një foto të familjes së tyre sa më të hershme dhe prezantojnë para grupit familjen e tyre.

Jeta në Kosovë dikur dhe sot

Familja dikur dhe sot



Situata 1. Dje, ulur para oxhakut në dhomën e ndenijes, duke dëgjuar kërcitjen e zjarrit, kujtova shtëpinë e madhe të fëmijërisë sime, në fshatin tonë, që, po ashtu, ishte me oxhak, rreth të cilit mblihdeshim për t'i dëgjuar historitë e gjyshit tim. Nën një çati jetonim 27 anëtarë. Gratë e shtëpisë përgatitnin ushqimin dhe na shtronin sofrën me radhë: së pari fëmijët, më pas burrat e në fund hanin gratë. Detyrë e grave ishte të kryenin punët e shtëpisë, të kujdeseshin e t'i rritnin fëmijët. Pak gra ishin të shkolluara e të punësuar. Vendimet në shtëpi i merrte gjyshi, se ishte i zoti i shtëpisë. Ishin kohë të vështira. Nuk kishim ujësjellës. Nuk kishim rrymë elektrike. Natën ndriçonim me qirinjtë ose me llambë vajguri. Sa emocion përjetova. Tani jetoj në qytet, në Pejë. U ktheva nga puna. Po përgatis darkën për gruan time njeke, e cila së shpejti do të kthehet nga spitali ku punon dhe për vajzën time studente që po vjen me makinë nga Prishtina. Ajo do të marrë në aeroport vëllanë e saj, i cili po studion në Londër. Epo, kësaj i thonë familje bashkëkohore!



- Si ishte familja dikur?
- Me çka merreshin gratë?
- Pse ishte jeta e vështirë?
- Kush i merrte vendimet në familje?
- Si është familja bashkëkohore? Si merren vendimet e si ndahen përgjegjësitë?

Familja është grupi i parë dhe më i vogël shoqëror në të cilën fillon jeta e njeriut. Familja shqiptare historikisht përbëhej nga një numër i madh anëtarësh, në të cilën jetonin deri në tre, përkatësisht katër breza: prindërit me fëmijët dhe gjyshërit. E nganjëherë edhe stërgjyshërit. Prandaj edhe quhej familje e zezjeruar. Familja ishte tradicionale, patriarkale që do të thotë se udhëhiqej nga i zoti i shtëpisë. Sot familja ka pësuar ndryshime të mëdha. Ndryshe prej familjeve tradicionale, në familjen bashkëkohore, e cila po zë vend gjithnjë e më shumë në Kosovë, jetojnë vetëm dy breza, që do të thotë se jetojnë prindërit me fëmijët. Ndarja e punëve në familje bëhet me marrëveshje. Kjo do të thotë se drejtimi i familjes bëhet bashkërisht, nga të dy prindërit.

Fjalët kyçe: familje, tradicionale, bashkëkohore, shumëgjeneratëshe.


Jeta në Kosovë dikur dhe sot

Familja dikur dhe sot



Situata 1. Dje, ulur para oxhakut në dhomën e ndenjjes, duke dëgjuar kërcitjen e zjarrit, kujtova shtëpinë e madhe të fëmijërisë sime, në fshatin tonë, që, po ashtu, ishte me oxhak, rreth të cilit mbledheshim për t'i dëgjuar historitë e gjyshit tëm.

Nën një çati jetonim 27 anëtarë. Gratë e shtëpisë përgatitnin ushqimin dhe na shtronin sofrën me radhë: së pari fëmijët, më pas burrat e në fund banin gratë. Detyrë e grave ishte të kryenin punët e shtëpisë, të kujdeseshin e t'i rritnin fëmijët. Pak gra ishin të shkolluara e të punësuara. Vendimet në shtëpi i merrte gjyshi, se ishte i zoti i shtëpisë. Ishin kohë të vështira. Nuk kishim ujësjellës. Nuk kishim rrymë elektrike. Natën ndriçonim me qirinj ose me llambë vajguri. Sa emocion përjetova. Tani jetoj në qytet, në Pejë. U ktheva nga puna. Po përgatis darkën për gruan time mjeke, e cila së shpejti do të kthehet nga spitali ku punon dhe për vajzën time studente që po vjen me makinë nga Prishtina. Ajo do të marrë në aeroport vëllanë e saj, i cili po studion në Londër. Epo, kësaj i thonë familje bashkëkohore!



- Si ishte familja dikur?
- Me çka merreshin gratë?
- Pse ishte jeta e vështirë?
- Kush i merrte vendimet në familje?
- Si është familja bashkëkohore? Si merren vendimet e si ndahen përgjegjësitë?

Familja është grupi i parë dhe më i vogël shoqëror në të cilën fillon jeta e njeriut. Familja shqiptare historikisht përbëhej nga një numër i madh anëtarësh, në të cilën jetonin deri në tre, përkatësisht katër breza: prindërit me fëmijët dhe gjyshërit. E nganjëherë edhe stërgjyshërit. Prandaj edhe quhej familje e zgjeruar. Familja ishte tradicionale, patriarkale që do të thotë se udhëhiqej nga i zoti i shtëpisë. Sot familja ka pësuar ndryshime të mëdha. Ndryshe prej familjeve tradicionale, në familjen bashkëkohore, e cila po zë vend gjithnjë e më shumë në Kosovë, jetojnë vetëm dy breza, që do të thotë se jetojnë prindërit me fëmijët. Ndarja e punëve në familje bëhet me marrëveshje. Kjo do të thotë se drejtimi i familjes bëhet bashkërisht, nga të dy prindërit.

Fjalët kyçe: familje, tradicionale, bashkëkohore, shumëgjeneratëshe.

69



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes DRTA

Hapen librat dhe nxënësit do të lexojnë situatën e dhënë dhe do ta analizojmë së bashku, duke i lexuar me ndalesa dhe duke parashtruar pyetje. Do të shprehin mendimet të gjithë nxënësit nëse ata kanë dëgjuar për familjen tradicionale ose bashkëkohore. Gjatë leximit, së bashku përgjigjen në pyetjet e dhëna në libër, ku dhe analizohet pjesa e dhënë në pjesën pas situatës.




Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Diagrami i Venit

Grupet e ndara punojnë *Diagramin e Venit* duke bërë dallimin se:

- Çka është familja?
- Çka është familja tradicionale dhe ajo bashkëkohore?

Familja tradicionale Familja Familja bashkëkohore



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për prezantimin e familjes, përgjigjet e dhëna dhe dallimin e familjes tradicionale nga ajo bashkëkohore.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Shoqëria dhe mjedisi
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Jeta në Kosovë dikur dhe sot

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Krahason jetën në familje dikur dhe sot, në fshat dhe qytet, si rezultat i zhvillimeve shoqërore (shkollimit dhe punësimit masiv, në veçanti të femrës, fuknksionimit dhe menaxhimit të familjes, zhvillimit të transportit, elektrifikimit, ujësjellësit etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.1,2; III.2; V.8; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Fshati dikur dhe sot

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruajnë fshatin e tyre;
- Analizojnë jetën në fshat dikur dhe sot;
- Krijon një tregim me fjalë kyçe.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Bashkëbisedim

Tregojnë për vendet që ata i vizitojnë në fundjavë. Pyeten:


- Cilat janë vendet që i vizitoni në fundjavë?
- Tregoni a janë fshatra a qytete.
- Çfarë dallojnë fshatrat nga qyteti ku ju jetoni ose anasjelltas?



Jeta në Kosovë dikur dhe sot

Fshati dikur dhe sot

1 Vështro fotografitë e dhëna dhe mundohu të bësh krahasimin mes fshatit dikur dhe sot.



- Si ishte jeta në fshat dikur e si është sot?
- Cilat profesione ushtrohen në fshat?
- Si punohej toka dikur e si sot?
- Cilat prodhime kultivohen në fshat?



Fshati është vendbanim në të cilin jeton një bashkësi e njerëzve, të cilët merren me bujqësi e blegtori. Fshati dikur kishte shtëpi të vogla dhe familje të mëdha. Ishte jetë më e vështirë. Toka punohej me plug, nuk kishte energji elektrike, nuk kishte ujësjellës. Shumë fshatra nuk kishin shkollë. Kryesisht, udhëtimi për në shkollë, për shkak të mjeteve atëbotë, ishte shumë i vështirë. Sot fshati ka ndryshuar shumë. Shtëpitë e mëdha e shumë moderne janë kudo. Puna në fusha bëhet me mjete bashkëkohore. Janë ndërtuar ferma shumë të përshtatshme për rritjen e kafshëve. Secili fshat ka energji elektrike, ujësjellës, rrugë të asfaltura. Për sa u përket këtyre aspekteve, fshati i sotëm pothuajse nuk ndryshon nga qyteti.

70 Fjalët kyçe: fshat, bujqësi, blegtori, fushë, stallë, fermë, rregull, disiplinë.



Jeta në Kosovë dikur dhe sot


Fshati dikur dhe sot

1 Vështro fotografitë e dhëna dhe mundohu të bësh krahasimin mes fshatit dikur dhe sot.

Fshati dikur



Të përbashkëtat



Fshati sot



- Si ishte jeta në fshat dikur e si është sot?
- Cilat profesione ushtrohen në fshat?
- Si punohej toka dikur e si sot?
- Cilat prodhime kultivohen në fshat?



Fshati është vendbanim në të cilin jeton një bashkësi e njerëzve, të cilët merren me bujqësi e blegtori. Fshati dikur kishte shtëpi të vogla dhe familje të mëdha. Ishte jetë më e vështirë. Toka punohej me plug, nuk kishte energji elektrike, nuk kishte ujësjellës. Shumë fshatra nuk kishin shkollë. Kryesisht, udhëtimi për në shkollë, për shkak të mjeteve atëbotë, ishte shumë i vështirë. Sot fshati ka ndryshuar shumë. Shtëpitë e mëdha e shumë moderne janë kudo. Puna në fusha bëhet me mjete bashkëkohore. Janë ndërtuar ferma shumë të përshatshme për rritjen e kafshëve. Secili fshat ka energji elektrike, ujësjellës, rrugë të asfaltura. Për sa u përket këtyre aspekteve, fshati i sotëm pothuajse nuk ndryshon nga qyteti.

70 Fjalët kyçe: fshat, bujqësi, blegtori, fushë, stallë, fermë, rregull, disiplinë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Dëgjim dhe diskutim

Dëgjojnë pjesën e lexuar nga libri me ndalesa, duke sqaruar se çfarë lexuan dhe diskutojnë bashkërisht.

Përgjigjen në pyetjet e parashtruara nga libri dhe plotësojnë Diagramin e Venit.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Shkrim i lirë

Shpërndahen fletë të bardha me fjalët kyçe: *fshat, bujqësi, blegtori, mjete pune, rrugët, stallë, fermë*. Në këto fletë kanë për detyrë të formojnë nga një tregim dhe të paraqesin me vizatim tregimin e formuar.

Diskutohen tregimet e shkruara me klasën.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për shprehjen e mendimit të lirë, plotësimin e Diagramit të Venit dhe formulimin e tregimit.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Jeta në Kosovë dikur dhe sot

Rezultatet e të nxënit të temës:

Krahason jetën në familje dikur dhe sot, në fshat dhe qytet, si rezultat i zhvillimeve shoqërore (shkollimit dhe punësimit masiv, në veçanti të femrës, fuknksionimit dhe menaxhimit të familjes, zhvillimit të transportit, elektrifikimit, ujësjellësit etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.1,2; III.2; V.8; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Qyteti dikur dhe sot

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon dallimin e fotografive në dikur dhe sot;
- Klasifikon fotot e qytetit dikur dhe sot;
- Identifikon të përbashkëtat dhe të veçantat e jetës dikur dhe sot në qytet.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, projektor, fotografi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Imagjinata e drejtuar

Përgatiten disa fotografi të ndryshme me pamje të qyteteve të ndryshme dikur dhe sot p.sh., Prishtina, Peja, Prizreni, Mitrovica etj. Fotografitë do të jenë të kthyer në anën e kundërt në mënyrë që fëmijët mos t'i shohin. Të gjithë do të tërheqin nga një foto dhe do ta hapin e do ta analizojnë ku detyrë kanë që ta dinë cili qytet është dhe a është qyteti dikur apo sot. Tabela ndahet në dy pjesë, ata do t'i vendosin fotot që janë paraqitur dikur dhe ato sot, paralel me qytetet sot dhe dikur. Secila foto e vendosur arsyetohet për vendin e vendosur.

Jeta në Kosovë dikur dhe sot



Qyteti dikur dhe sot

Situata 1. Klea jeton në Prishtinë. Ajo shpesh shkon te gjyshërit dhe bisedon me ta. Sot ajo me gjyshin shkuan në parkun e lagjes dhe biseduan për qytetin dikur dhe sot. Gjyshi tregoi: "Qyteti dikur ishte më i vogël, kishte banorë më pak. Nuk kishte shumë mjete komunikacioni. Ndërtesat ishin larg njëra-tjetrës. Merrnim shërbimet e nevojshme në të gjitha institucionet. Njerëzit merreshin me zeje të ndryshme, si farkëtarë, marangozë, këpucarë, rrobaqepës, plisaxhi e shumë të tjera. Tregtarët kishin dyqane të vogla nga të cilat siguronin jetesën. Kishte parqe të gjelbëruara në çdo lagje. Sot gjithçka duket sikur ecën me shpejtësi. Dendësi e ndërtesave, lagje të reja, qendra të mëdha tregtare, komunikacioni i pandalshëm, gjelbërim pak, sepse të gjitha pjesët e tokës shfrytëzohen për ndërtim. Ka zhvillim urbanistik e teknologjik. Të gjithë janë në lëvizje."



- Si ishte qyteti dikur?
- Si është qyteti sot?
- Pse gjyshi tha që gjithçka ishte në lëvizje?
- Çfarë mendon ti për ndotjen e ajrit në qytet dikur dhe sot? Pse?



Qyteti është vendbanim i madh dhe urban, në të cilin shumica e popullsisë jeton nga industria, tregtia dhe aktivitetet e shërbimit. Në qytete ka shumë ndërmarrje industriale, tregtare, institucione politike, shoqërore, shëndetësore, kulturore dhe administrative. Qytetet dikur kishin ndërtesa të ulëta, rrugë të ngushta, pak mjete komunikacioni, zona të gjelbra. Numri i spitaleve, shkollave dhe çerdheve nuk ishte i madh dhe të gjitha ishin institucione shtetërore. Qytetet sot kanë rrugë të gjera, komunikacion të dendur, parkingë të shumtë, ndërtesa të larta, kurse zonat e gjelbra janë zvogëluar shumë. Në qytete ka shumë shkolla shtetërore e private. Ka shumë kopshte e çerdhe, të cilat ofrojnë shërbime edukative dhe të kujdesit për fëmijët në kuadër të edukimit parashkollor. Ka spitale shtetërore e private, në të cilat njerëzit gjejnë shërbimin e duhur për t'u shëruar nga sëmundjet e ndryshme.

Fjalët kyçe: qytet, banor, institucion, shëndetësi, kulturë.

Jeta në Kosovë dikur dhe sot



Qyteti dikur dhe sot

Situata 1. Klea jeton në Prishtinë. Ajo shpesh shkon te gjyshërit dhe bisedon me ta. Sot ajo me gjyshin shkuan në parkun e lagjes dhe biseduan për qytetin dikur dhe sot. Gjyshi tregoi: "Qyteti dikur ishte më i vogël, kishte banorë më pak. Nuk kishte shumë mjete komunikacioni. Ndërtesat ishin larg njëra-tjetrës. Merrnim shërbimet e nevojshme në të gjitha institucionet. Njerëzit merreshin me zeje të ndryshme, si farkëtarë, marangozë, këpucarë, rrobaqepës, plisaxhi e shumë të tjera. Tregtarët kishin dyqane të vogla nga të cilat siguronin jetesën. Kishte parqe të gjelbëruara në çdo lagje. Sot gjithçka duket sikur ecën me shpejtësi. Dendësi e ndërtesave, lagje të reja, qendra të mëdha tregtare, komunikacioni i pandalshëm, gjelbërim pak, sepse të gjitha pjesët e tokës shfrytëzohen për ndërtim. Ka zhvillim urbanistik e teknologjik. Të gjithë janë në lëvizje."



- Si ishte qyteti dikur?
- Si është qyteti sot?
- Pse gjyshi tha që gjithçka ishte në lëvizje?
- Çfarë mendon ti për ndotjen e ajrit në qytet dikur dhe sot? Pse?



Qyteti është vendbanim i madh dhe urban, në të cilin shumica e popullsisë jeton nga industria, tregtia dhe aktivitetet e shërbimit. Në qytete ka shumë ndërmarrje industriale, tregtare, institucione politike, shoqërore, shëndetësore, kulturore dhe administrative. Qytetet dikur kishin ndërtesa të ulëta, rrugë të ngushta, pak mjete komunikacioni, zona të gjelbra. Numri i spitaleve, shkollave dhe çerdheve nuk ishte i madh dhe të gjitha ishin institucione shtetërore. Qytetet sot kanë rrugë të gjera, komunikacion të dendur, parkingë të shumtë, ndërtesa të larta, kurse zonat e gjelbra janë zvogëluar shumë. Në qytete ka shumë shkolla shtetërore e private. Ka shumë kopshte e çerdhe, të cilat ofrojnë shërbime edukative dhe të kujdesit për fëmijët në kuadër të edukimit parashkollor. Ka spitale shtetërore e private, në të cilat njerëzit gjejnë shërbimin e duhur për t'u shëruar nga sëmundjet e ndryshme.

Fjalët kyçe: qytet, banor, institucion, shëndetësi, kulturë.

71

SOT	DIKUR




Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Dëgjim dhe diskutim

Hapen librat, lexohet situata 1, përgjigjen në pyetjet e parashtruara në libër dhe nxënësit japin mendimet e tyre duke u ndihmuar nga ana e mësuesit/es. Po ashtu, analizohet edhe pjesa e dhënë në libër si informacion shtesë për qytetin se çka na ofron ai.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Thello dijet

Shpërndahet edhe nga një fletë në të cilën kanë të përgatitur nga një kllaster dhe e plotësojnë, duke u munduar që të identifikojnë ato që ishin dikur e sot nuk janë, ato që janë sot dhe të përbashkëtat e tyre.



Vlerësimi i nxënëseve:

Vlerësohen për dallimin dhe klasifikimin e fotove në vendin e duhur. Po ashtu edhe identifikimin, analizimin e të përbashkëtat e qytetit dikur dhe sot në Diagramin e Venit.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Jeta në Kosovë dikur dhe sot

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan degët ekonomike në vendbanimin e tij dikur dhe sot dhe vlerëson ndikimin e tyre në jetën e njerëzve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1,3; III.1,2; V.8; VI.3,7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Degët e ekonomisë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpreh njohuritë që ka për fjalën “ekonomi”;
- Krahason profesionet e anëtarëve të familjes;
- Dallon prodhimet industriale, prodhimet bujqësore dhe shërbimet.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto me profesione të ndryshme, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Kllaster

Nxjerr në tabelë fjalën “EKONOMIA”.

Nxënësit shprehin mendimet e tyre me shkrim se si e kuptoni fjalën “ekonomi” duke shkruar së paku tri fjali për këtë term, si dhe i lexojnë mendimet e tyre duke nxjerrë në tabelë disa nga këto fjali



Situata 1. Mësuesja u kërkoi nxënësve të mendonin dhe të shkruanin se çfarë u vinte në mendje kur përmendjej ekonomia. Secili nxënës filloi të shkruante në fletore. Më pas, ata lexuan mendimet e tyre dhe mësuesja i shkroi në tabelë.

Jeta në Kosovë dikur dhe sot

Degët e ekonomisë



- Proveni edhe ju në klasën tuaj të shkruani çfarë dini për ekonominë.
- Çfarë është ekonomia?
- Cilat janë degët e ekonomisë?
- Përmendni profesionet e prindërve dhe familjarëve tuaj dhe tregoni cilave degë të ekonomisë u takojnë.
- Krahasoni tabelën e plotësuar me shokun/shoqen e bankës.



Emri i familjarit	Profesioni	Dega e ekonomisë

Ekonomia merret me studimin e prodhimit të mallrave, shpërndarjen dhe shpenzimin e atyre mallrave dhe shërbimeve.

Degët e ekonomisë janë:

- Bujqësia, blegtoria dhe peshkimi, të cilat merren me prodhimin e ushqimeve që quhen prodhime bujqësore.

- Industria merret me prodhimet që dalin nga fabrikat, punëtoritë e minierat. Këto prodhime quhen prodhime industriale.

- Tregtia, hotelieria dhe turizmi.

Të gjitha degët e ekonomisë ekzistojnë qysh nga kohët të vjetra. Në ato kohë, puna është kryer nga një numër i madh i punëtorëve me mjete primitive dhe sasisë të prodhimeve ishin të vogla.

Sot, puna kryhet me numër më të vogël të punëtorëve, me makineri të specializuara dhe sasisë të prodhimeve janë shumë më të mëdha.

Fjalët kyçe: ekonomi, prodhim bujqësor, prodhim industrial.

73



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes DRTA

Hapen librat dhe nxënësit do të lexojnë situatën 1, pyetjet dhe do të përgjigjen së bashku duke e plotësuar tabelën e dhënë në libër. Pas plotësimit ata do të krahasojnë profesionet e familjarëve me shokun-shoqen e bankës. Më pas, tekstin e dhënë në libër e analizojmë duke i treguar profesionet e anëtarëve se cilës degë të ekonomisë i takojnë (bujqësia, blegtoria, miniera, tregtia, hotelieria, shëndetësia, policia etj.).



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënët Imagjinata e drejtuar (loja me shportë)

Nxënësit me radhë marrin nga një foto nga shporta me profesione të ndryshme e gjësunde dhe vendosin në tabelë te vendi i duhur ku paraprakisht tabela është e ndarë në tri pjesë, duke treguar se cilës degë të ekonomisë i takojnë.

Prodhimet industriale	Prodhimet bujqësore	Shërbimet

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për shprehjet e dhëna me shkrim, përgjigjet dhe dallimin e degëve të ekonomisë sipas fotove.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Jeta në Kosovë dikur dhe sot

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshekruan degët ekonomike në vendbanimin e tij dikur dhe sot dhe vlerëson ndikimin e tyre në jetën e njerëzve; Identifikon personalitete kontributdhënëse të vendit ku jeton dikur dhe sot dhe përshekruan rolin e tyre në fushat përkatëse (arsim, shëndetësi, ekonomi etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1,3; III.1,2; V.8; VI.3,7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vendi im dhe ekonomia

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përgjigjet në pyetjet e parashtruara;
- Analizon tekstin e dhënë;
- Shkruan për ekonominë e vendit tonë (fshat, qytet).

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathhtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Dëgjim dhe diskutim

Përmes projektorit do të shohin foto të vendit tonë (fabrika, uzina, sera, Prevallën, Brezovicën etj.). Parashtrihen disa pyetje lidhur me fotot e shikuara, si p.sh.:

- Çfarë patë?
- A e keni vizituar ndonjë nga këto vende?
- Për çka shërbejnë këto vende?



Jeta në Kosovë dikur dhe sot

Vendi im dhe ekonomia

Situata 1. Mira dhe Nili po luanin dhe bënin gara për njohuri të ndryshme. Sot, ata vendosën të luanin lojën: *Ekonomia e vendit tim*. Mira shkroi për punët që kryhen në fshat, kurse Nili për punët që kryhen në qytet.

Ekonomia në fshat	Ekonomia në qytet
Njerëzit në fshatra më së shumti merren me bujqësi, që do të thotë merren me punimin e tokës, kultivimin e drithërave, të frutave dhe të perimeve.	Njerëzit në qytete punojnë në fabrika, punishte, uzina, miniera. Ata marrin prodhime, të cilat i quajmë prodhime industriale.
Punimi i tokës dikur ishte shumë i vështirë, sepse punohej vetëm me parmendë. Duhej më shumë fuqi punëtore dhe shpenzohej më shumë kohë.	Po ashtu, edhe tregtia është zhvilluar në saje të rrjetit të dyqaneve e gendrave tregtare, të cilat janë të furnizuara me prodhime vendore dhe nga vende të ndryshme të botës.
Sot punimi i tokës është bërë shumë më i lehtë dhe më i shpejtë, si rezultat i mjeteve më të sofistikuar të punës.	Dikur njihnim dhe ushqeheshim vetëm me frutat dhe perimet e zonës sonë, kurse sot shijojmë edhe ato të vendeve më të largëta të botës.
Në fshatra njerëzit merren me blegtori, pra me rritjen e kafshëve dhe të shpendëve. Ata kanë ndërtuar ferma moderne, ku kultivojnë bimë dhe rriten kafshë nga të cilat sigurojnë produkte ushqimore.	Po ashtu, edhe prodhimet e vendit tonë gjenden në vende të ndryshme të botës.
	Njerëzit merren edhe me zeje të ndryshme.





- Pse punojnë njerëzit?
- Cilat degë të ekonomisë janë të zhvilluara në fshat e cilat në qytet?
- Cilat degë të ekonomisë janë të zhvilluara në vendin tonë?
- Pse mendon se në vendin tonë prodhohet rryma elektrike me thëngjill?



Vendi ynë ka një ekonomi relativisht të zhvilluar. Secili vend duhet të zhvillojë ato degë të ekonomisë të cilat përshtaten me pasuritë natyrore të atij vendi.

Duke shfrytëzuar tokën e punueshme, në vendin tonë është zhvilluar bujqësia, prej së cilës marrim shumë prodhime bujqësore, si: fruta, perime e drithëra.

Po ashtu, është e zhvilluar blegtoria – degë e ekonomisë, e cila merret me rritjen e kafshëve, si: delet e lopët, të cilat kanë mundësuar rritjen e prodhimit të mishit, të qumështit dhe të produkteve të tij.

Kosova prodhon energji elektrike, duke shfrytëzuar thëngjillin si pasuri nëntokësore.

Industria është e zhvilluar më tepër në ndërmarrje të vogla në sektorin privat, nga të cilat marrim prodhime industriale. Tregtia është mjaft e zhvilluar me mallra vendore dhe nga vende të ndryshme të botës.

Bukuritë natyrore në malet e Sharrit, me vendpushimin Brezovica, Prevala dhe Bjeshkët e Nemuna, me vendpushimin në Bogë, kanë mundësuar zhvillimin e turizmit dimëror në vendin tonë.

Në Kosovë ekziston numër i konsiderueshëm i bankave, me punëtorë të kualifikuar, të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme bankare për klientë.

Fjalët kyçe: bujqësi, blegtori, industri, turizëm, bankë.

75



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Dëgim dhe diskutim

Lexohen të dhënat e paraqitura dhe pjesa e shkruar në tekst dhe ato që janë më të rëndësishme shënohen në tabelë si p.sh.: ekonomia në fshat, ekonomia në qytet, bukuritë natyrore, zejet etj. Pas diskutimit, do të përgjigjen në pyetjet e parashtruara nga libri.

Po ashtu, do të analizojmë edhe pjesën e dhënë në libër, informatat rreth ekonomisë së vendit tonë.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Thello dijet

Ndahen në dy grupe dhe kanë për detyrë të shkruajnë për ekonominë që zhvillohet në fshat dhe ekonominë që zhvillohet në qytet të vendit tonë mbi informatat e marra më lartë, duke u bazuar në ato që i kanë dëgjuar dhe analizuar deri tani. Prezantojnë para klasës dhe e sqarojnë çdo mendim të dhënë rreth ekonomisë së vendit tonë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për punën në grup, përgjigjet e dhëna dhe shprehjen e mendimit të lirë me shkrim.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Jeta në Kosovë dikur dhe sot

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon sportet dhe sportistët, artet dhe artistët që kanë ndikuar në shoqërinë kosovare dikur dhe sot (nga futbollit, hendbolli, muzika, piktura, filmi, drama etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.3; V.8; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Njerëzit që nuk harrohen

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon fotografitë e paraqitura në projektor;
- Diskuton situatat e dhëna;
- Shkruan emra të njerëzve të njohur nga vendi.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, fotografi, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Parashikim me terma paraprakë

Me anë të projektorit vendosen disa fotografi ku janë të paraqitura disa nga njerëzit e njohur të Kosovës në fusha të ndryshme. P.sh., nxënësit identifikojnë dhe arsyetojnë kush janë dhe shtohen informacionet gradualisht duke i marrë nga nxënësit dhe nga mësuesi/ja, pastaj vazhdohet me foto të tjera.



Jeta në Kosovë dikur dhe sot

Njerëzit që nuk harrohen

Situata 1. Ne jemi të lumtur që kemi shkollat në gjuhën shqipe. Cilët janë njerëzit që kontribuan për hapjen e tyre? Ata janë shumë. Mëso për disa nga ta, të cilët janë të paharrueshëm për ne dhe gjeneratat që do të vijnë.



Ernest Koliqi pati rol të rëndësishëm në hapjen e shkollave shqipe në Kosovë. Për shkak të mungesës së mësuesve në Kosovë, ai u kujdes që të sillte mësues nga Shqipëria.

Disa nga mësuesit që ndikuan në përhapjen e djes në Kosovë ishin: Mehmet Gjevori, Tajar Hatipi, Vezire Xherina, Beqir Kastrati e shumë të tjerë, të cilët lanë gjurmë të pashlyeshme në arsimin e vendit tonë.



Mati Logoreci ishte mësuesi i parë në shkollën "Shkolla Shqipe e Djenve" në Prizren.



Sevasti Qiriazhi ishte atdhetare dhe nismëtare e arsimit shqip për gra.

Sot, në vendin tonë, punon një numër i madh i mësimdhënësve profesionistë, të cilët janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë për arsimimin e brezave të rinj dhe punojnë me përkushtim e dashuri.



- Cilat shkolla janë në qytetin apo fshatin tënd?

- Përmend emrat e njerëzve të qytetit apo të fshatit tënd që dhanë kontribut në arsim.

- Pse mendon se këta njerëz nuk duhet të harrohen? Përmend së paku tri arsye.

Jeta në Kosovë dikur dhe sot

Njerëzit që nuk harrohen



Situata 2. Mali shkon rregullisht te dentisti. Shumë i pëlqen kur i sheh gjithë ato mjete, me të cilat ndreqen dhëmbët. Edhe butësia e dentistit ka bërë që Mali të kujdeset për shëndetin e dhëmbëve me shumë dëshirë.


Një ditë, ai e pyeti gjyshin:

- Gjysh, si ka qenë mjekësia në kohën tënde?

- Në kohën time, - tha gjyshi, - nuk kishte shumë mjekë. Mjekët duhej të shkolloheshin në vende të tjera, sepse te ne nuk kishte shkolle. Ata ishin shumë të kujdesshëm dhe shëronin shumë njerëz, edhe pse nuk kishin

mjetet që janë sot. Disa nga mjekët e parë të vendit tonë ishin: Dr. Tefik Rashiti, Dr. Xheladin Deda, Dr. Ali Sokoli, gjinekologja e parë Dr. Sehadete Mekuli e të tjerë. Tani jam plakur, biri im, e nuk po mbaj mend shumë emra. E sot ka shumë mjekë për të cilët duhet të flasim me respekt, pasi me punën dhe kujdesin që tregojnë, janë gjithmonë në shërbim të popullit.

Gjithmonë, gjyshi është i gatshëm ta shuajë kureshtjen e Malit për pyetjet që i bën.



- Përmend emrat e mjekëve dhe të infermierëve të qytetit apo të fshatit tënd, të cilët kanë dhënë kontribut në shëndetësi.
- Cili është mjeku i familjes sate?
- Çfarë mendon ti për punën e mjekëve?



Vendi ynë ka arsim, shëndetësi e ekonomi, duke iu falënderuar punës së paladshme të specialistëve të këtyre fushave, të cilët nuk ndalen asnjëherë për të mirën e vendit tonë.

Sot, në vendin tonë, sa i përket cilësisë, mësimdhënia bashkëkohore ka dallime të mëdha me atë tradicionale. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe e Inovacionit (MASHTI) organizon punën me tekste, plane e mjete mësimore të përshtatshme për të gjitha moshat e fëmijëve. Mësuesit luajnë një rol shumë të rëndësishëm për arsimin e vendit tonë. Mbarëvajtjen e punës në shëndetësi e menaxhon Ministria e Shëndetësisë, e cila siguron furnizimin me pajisje dhe mjete të nevojshme për institucionet shëndetësore, si ambulancat e spitalet e vendit tonë. Mjekët janë të kualifikuar dhe të specializuar në drejtime të ndryshme. Për dallim nga mjekët e dikurshëm, sot ata shkollohen në vendin tonë, në Universitetin e Prishtinës. Për zhvillimin e vendit dhe rritjen e mirëqenies së popullit tonë, kontribuojnë edhe ekonomistët.

Fjalët kyçe: arsim, shëndetësi, ekonomi, specialist, kontribut.

77



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Pyetjet për mua

Diskutohen fotografitë e paraqitura në libër dhe informatat e dhëna që janë të vendosura krahas fotove, parashtrohen pyetjet p.sh.:

- Pse mendoni që janë të rëndësishme këto personalitete?
- Për cilët nga këto personalitete keni dëgjuar më parë?
- Cili është mjeku i familjes tuaj?



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Shkrim i lirë

Duke rikujtuar ato që i mësuam nga lart, në fletët A4 paraqesin emra të njohur të personaliteteve në fusha të ndryshme duke përfshirë edhe ato nga ditët e sotme.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për identifikimin e personaliteteve, përgjigjet e dhëna dhe shkrimin e njerëzve të njohur në fusha të ndryshme.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Jeta në Kosovë dikur dhe sot

Rezultatet e të nxënësve të temës:

Identifikon sportet dhe sportistët, artet dhe artistët që kanë ndikuar në shoqërinë kosovare dikur dhe sot (nga futbollit, hendbollit, muzika, piktura, filmi, drama etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.3; III.3; V.8; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2,3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njëësia mësimore: Kultura - pasuri kombëtare

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Shpreh mendimin për fotografitë e paraqitura;
- Diskuton për fotografitë duke i arsyetuar mendimet;
- Klasifikon emrat e përmendur në fushat përkatëse.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, fotografi, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Imaginatë e drejtuar

Në tabelë vendosen disa fotografi në të cilën janë të paraqitura disa nga personalitetet e njohura të vendit tonë. P.sh., nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe shtohen informacione gradualisht duke i marrë nga nxënësit dhe nga mësuesi/ja, pastaj vazhdohet me fotot të tjera.



Jeta në Kosovë dikur dhe sot

Kultura - pasuri kombëtare

Situata 1. Një ditë, në klasën e Kleas, mësuesi kërkoi nga nxënësit të bënin një hulumtim për njerëzit që dhanë kontribut në fusha të ndryshme të artit, si: muzikë, sport, teatër, film e pikturë. Ata vendosën që të punonin në grupe dhe pastaj të prezantonin para klasës.

Grupi i parë: Sportet kolektive


Sportet më të njohura në Kosovë janë: futbollit, basketbollit, hendbollit dhe volejbollit. Ne si grup mblodhëm shënime për futbollin. Futbollit në Kosovë është një ndër sportet më të zhvilluara. Në tërë Kosovën ka shkollat e futbollit në të cilat ushtrohen shumë fëmijë dhe nga aty kanë dalë shumë talentë.



Në fotografi është paraqitur Fadil Vokrri, emër i njohur i futbollit kosovar.

Grupi i dytë: Sportet individuale

Sportet individuale janë ato që i sillen sukseset më të mëdha Kosovës. Në fotografi është paraqitur njëra ndër sportistet më të njohura kosovare, e cila bëri që emri i Kosovës të përmendej kudo nëpër botë.



Majlinda Kelmendi, xhudistja e cila i dha Kosovës titullin e parë botëror të xhudos dhe mori edhe shumë medalje të tjera të arta.



Grupi i tretë: Muzika në Kosovë
Muzika është pjesë e kulturës së një populli. Në Kosovë fillimisht ishte e zhvilluar muzika folklorike, popullore e më pas u zhvilluan edhe zhanret e tjera, si: muzika klasike, moderne e të tjera.



Ymer Riza ishte njëri prej këngëtarëve të parë shqiptarë të muzikës popullore me sharki e çifteli. Ai u konsiderua si legjenda e folklorit shqiptar.



Nexhmije Pagarusha, këngëtare e muzikës popullore dhe e operës. Ajo ishte edhe aktore e suksesshme në film dhe në teatër. Njihet si *Bilbili i Kosovës* dhe *Mbretëresha e muzikës shqiptare*.

Këngëtarët me prejardhje nga vendi ynë, që janë bërë shumë të famshme dhe kanë arritur sukses të madh nëpër botë, janë Rita Ora dhe Dua Lipa.



Grupi i katërt: Filmi, drama e piktura në Kosovë



Bekim Fehmiu ishte aktori i parë kosovar i teatrit dhe i filmit. Ai luajti në më shumë se 40 filma.

Teatri e filmi

Teatri Kombëtar i Kosovës u formua në vitin 1946 e më pas u hapën teatrot amatorë në të gjitha qytetet e Kosovës.

Piktura

Vendi ynë ka pasur dhe vazhdon të ketë piktorë të njohur. Ata mbeten të paharruar me veprat e tyre.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Pyetjet për mua

Diskutohen fotografitë e paraqitura në libër dhe informatat e dhëna që janë të vendosura krahas fotove, parashtrohen pyetjet p.sh.:

- Pse mendoni që janë të rëndësishme këto personalitete?
- Në cilat fusha të kulturës janë të njohur?
- A mendoni se Kosova ka një kulturë të zhvilluar?

Me anë të projektorit paraqiten figura të njohura kulturore, në internet hulumtohet drejtpërdrejt dhe shkruhen në tabelë duke i ndarë në fusha kulturore.



Përforsimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Tabela e koncepteve

Duke i rikujtuar ato që i mësuam nga lart, në tabelë shënojmë:

FUSHA	Emrat e njohur	Veprat
Sport	Lorik Cana, ...	
Muzikë	Rita Ora, Nexhmije Pagarusha, ...	Pop muzikë, popullore, opera
Teatër	Leze Qena	
Film	Faruk Begolli	
Pikturë	Ibrahim Kodra	

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e dhëna, për shprehjen e mendimit të lirë dhe klasifikimin e personaliteteve kulturore të vendit tonë.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Traditat dhe trashëgimia jonë

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon veshjet e krahinave të ndryshme të Kosovës dhe disa nga tiparet karakteristike të tyre; Mbledh dhe përkujdeset për eksponatet nga trashëgimia; Jep kontribut në pasurimin e arkivës së familjes dhe muzeut të shkollës.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1; III.1; V.8; VI.3,7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ruajmë traditat tona

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpreh mendime rreth fjalës “traditë”;
- Analizon konceptin traditë sipas mendimit të tij/saj;
- Shkruan për traditat tona.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathhtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Kllaster

Në mes të tabelës shënohet fjala “TRADITË”. Merren mendimet e nxënësve dhe shkruhen përreth se çka ata mendojnë që është tradita e një vendi.



Traditat dhe trashëgimia jonë

Ruajmë traditat tona

Situata 1. Mali, bashkë me prindërit e tij, u fuan për vizitë te disa miq të vjetër në qytetin e Shkodrës, në Shqipëri. Gjatë vizitës së tyre, Mali provoi një pjatë me ushqime tradicionale që s’e kishte ngrënë kurrë më parë.

Në bashkëbisedim me prindërit, ai kishte kuptuar që pothuajse çdo vend kishte karakteristikat e tij në ushqim, në veshje, në të folur, që e dallonin nga vendet e tjera. Për Malin, ushqimi ishte më i veçantë se ushqimet që ai kishte provuar. Ajo që i bëri shumë përshtypje ishte mikpritja që iu bë në familjen shkodrane dhe humori që i karakterizonte ata gjatë gjithë kohës. Familja e Malit u prit me shumë dashuri. Atyre u shërbyen çaj dhe ëmbëlsira, duke kaluar, kështu, çaste shumë të bukura.

Mali u miqësua shumë me Tomorin, djalin e familjes shkodrane dhe së bashku kaluan tërë pasditen. Tomori i kishte ndarë të gjitha lodrat me Malin dhe e kishte bërë atë që të ndihet si në shtëpinë e vet.

Gjatë kthimit për në shtëpi, Mali i tha babait që ishte befasuar nga mikpritja, për faktin se si mund të ndihesh si në shtëpinë tënde, kur ishe aq shumë kilometra larg nga njerëzit. Babai i tha Malit se shqiptarët këtë traditë e kishin të trashëguar nga paraardhësit.



Traditat dhe trashëgimia jonë

Ruajmë traditat tona



Ndahuni në grupe dhe diskutoni për fotografitë e dhëna.

- Përmend tri ushqime tradicionale.
- Trego tri elemente të traditës sonë kombëtare.
- Si e kupton fjalën "mikpritje"?



Kultura ka të bëjë me mënyrën e jetesës së një komuniteti a shoqërie. Ajo përfshin shumë elemente, si: gjuhën, muzikën, artet, traditat, besimet, doket, zakonet etj.

Traditë konsiderohen pikëpamjet, zakonet, virtytet.

Secili popull e ka traditën e tij, si: në arkitekturën e qytetit, në ndërtimin dhe rregullimin e shtëpive, në organizimin e festave të ndryshme, në mënyrën e gatimit etj. Shqiptarët dallohen për mënyrën e organizimit të dasmave tradicionale.

Këto janë formuar historikisht në jetën e një populli dhe ruhen e trashëgohen. Vendi ynë ka një traditë mjaft të pasur, e cila ruhet dhe përcillet brez pas brezi.

Fjalët kyçe: traditë, zakon, ushqim, mikpritje.

83



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Leximi i drejtuar

Lexohet situata e dhënë me ndalesa dhe pastaj parashtrohen pyetje për pjesën e lexuar dhe çfarë mendoj rreth situatës së dhënë. Kështu vazhdohet deri në fund të tekstit dhe pastaj parashtrohen edhe pyetjet që janë në libër.

- Përmend tri ushqime tradicionale që di.
- Trego tri elemente të traditës sonë kombëtare.
- Si e kuptoni fjalën "mikpritje"?



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Shkrim i lirë

Paraqiten fjalët kyçe: traditë, zakon, ushqim, mikpritje, dasmë. Nxënësit shkruajnë shkurtimisht duke përdorur fjalët kyçe në shkrim ku dhe shpalosin disa nga traditat tona të cilat ruhen brez pas brezi.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për mendimet e dhëna, pjesëmarrjen në diskutim dhe për përshkrimin e traditave tona.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Traditat dhe trashëgimia e jonë

Rezultatet e të nxënësve të temës:

Merr pjesë në mënyrë aktive në shënimin e ndonjë feste tradicionale në shkollë dhe komunitet; Dallon veshjet e krahinave të ndryshme të Kosovës dhe disa nga tiparet karakteristike të tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.3; II.1,2,6; III.1,2,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1; 2.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kulturat janë të shumëllojshme

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Dallon kulturat e ndryshme etnike në Kosovë;
- Analizon elementet kulturore të popujve që banojnë në Kosovë dhe nga jashtë;
- Shpreh mendimin për elementet kulturore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri bazë, interneti, projektori, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësve

Stuhi mendimesh dhe përvijim i të menduarit

Para fillimit të mësimin bëjmë një përvijim të orës së kaluar me pyetjet e përzgjedhura nga mësuesi/ja. Nxënësit shprehin mendimet e tyre duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Çfarë di për kulturat e popujve të Kosovës?
- A respektohen kulturat e popujve të Kosovës?
- Çfarë kuptoni me fjalën kulturë?
- Kush bën pjesë në kulturën e një populli?



Traditat dhe trashëgimia jonë

Kulturat janë të shumëllojshme

Situata 1. Andra i ftoi të gjithë shokët e shoqet për ditëlindje. Jonit, që i pëlqente të ilustronte çdo ngjarje, po i bënte përshtypje fakti që në shtëpinë e Andrës kishte shumë piktura në mur e shumë libra në bibliotekë. Jonin po e mrekullonte fakti që në çdo pikturë burrat kishin të vendosur plisa në kokë e gratë kishin veshje plot ngjyra. Veshjet e tyre ishin të ndryshme nga veshjet e sotme. Pikturat tregonin historinë e popullit tonë e librat mbanin emra të autorëve të mëdhenj shqiptarë, si: vëllezërit Frashëri, Gjergj Fishta, Asdreni, Ismail Kadare etj. Aty kishte edhe fotografi të Motrës Tone dhe motrave Qiriazi. Kur prindërit e Andrës erdhën për t'i përsëndetur fëmijët, Joni e pyeti mamanë e Andrës: - A mund të huazoj një nga këta libra që ta lexoj gjatë pushimit të verës? Zonjës iu bë qejfi, buzëqeshi lehtë e i tha se këta libra ishin për të rriturit. Ajo i premtoi që kur të rritej, do t'ia huazonte të gjithë librat, sepse vetëm kështu do të mund të shikonte se çfarë shkrimesh me vlerë kanë shkruar këta shkrimtarë. Joni, i mrekulluar, e pyeti: - A janë të gjithë shqiptarë? - Po, - tha zonja, - mirëpo për të njohur se sa e bukur është bota dhe sa shumë kultura të ndryshme ekzistojnë, në duhet t'i lexojmë edhe autorët e huaj. Joni u pajtua me këtë mendim dhe iu bashkua shokëve.

- ? - Diskutoni rreth situatës së dhënë.
- Si lidhen librat me kulturën e një vendi?
- A ke dëgjuar apo parë ndonjë element të veçantë të ndonjë kulture tjetër?
- Ç'është për ty kultura?

Me zhvillimin e njeriut, zhvillohet edhe kultura e tij. Kultura është tërë trashëgimia shoqërore e një grupi njerëzish, përfshirë këtu mënyrën e të menduarit, të të vepruarit, stilin e jetës, besimet kolektive, vlerat, normat morale etj. Kultura, po ashtu, përfshin tërësinë e aritjeve të një populli dhe të të gjithë njerëzve në fushën e prodhimit dhe në zhvillimin shoqëror e mendor. Gjuha, feja, zakonet shoqërore, si veshja, ushqimi etj., pastaj muzika dhe artet e tjera, të gjitha këto përbëjnë kulturën e një njeriu, të një grupi shoqëror apo të një populli të caktuar.

84 Fjalët kyçe: kulturë, libër, pikturë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Të nxënësit me këmbime

Lexojmë situatën 1 dhe i analizojmë pjesët duke parashtruar pyetje:

- Si lidhen librat me kulturën e një vendi?
- Thuaj një shkrimtar të huaj që ia ke lexuar veprat.
- Vepra “Liza në botën e çudirave” kulturën e cilit vend e paraqet?

Marrim përgjigjet nga nxënësit duke e analizuar dhe paraqitur konceptin kulturë në fusha e dimensionet e ndryshme.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Tryezë e rrumbullakët

Nxënësit parashtrojnë pyetje njëri-tjetrit rreth elementeve kulturore të ndarë në çifte ku mund të ndërhyjë edhe njëri edhe tjetri gjatë parashtrimit të pyetjes nga çifti tjetër duke i shprehur mendimet, llojet e ndryshme kulturore.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për dallimin e kulturave etnike në Kosovë dhe karakteristikat e tyre dalluese me mendimet e dhëna.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Traditat dhe trashëgimia e jonë

Rezultatet e të nxënësve të temës:

Identifikon institucionet kulturore si teatrot, muzet, si dhe lokalitetet arkeologjike, historike dhe natyrore të vendit dhe përshkruan aktivitetet që zhvillohen në to.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.1,3; II.1; III.1,2; V.8; VI.3,7,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1; 2.2; 2.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Institucionet kulturore

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Identifikon fotot e paraqitura;
- Vlerëson rëndësinë e institucioneve kulturore;
- Dallon institucionet kulturore sipas llojit (teatër, kinema, bibliotekë etj.).

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor, internet.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Shkathësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Stuhi mendimesh

Në tabelë vendosen foto me institucione të ndryshme kulturore. Merren mendimet e nxënësve dhe emërtohen pas identifikimit të tyre p.sh.: Biblioteka Kombëtare, Shtëpia e Lidhjes së Prizrenit, Teatri Kombëtar etj.



Traditë dhe trashëgimia jonë

Institucionet kulturore

Situata 1. Fëmijët e klasës së katërt vizituan kryeqytetin e Kosovës, Prishtinën, së bashku me mësuesen e tyre. Gjatë kthimit për në qytetin e tyre, fëmijët po bashkëbisedonin me mësuesen për vendet që vizituan. Secili fëmijë po tregonte se çfarë i kishte bërë përshtypje. Rronit i kishte bërë përshtypje Teatri i Kukullave, sepse për të koha aty ishte çlodhëse, e këndshme dhe shumë edukative. Albanës i kishte bërë përshtypje shumë Muzeu i Kosovës. Aty ajo kishte mësuar më shumë për paraardhësit dhe historinë e popullit tonë. Bora ishte mahnitur nga arkitektura e Bibliotekës Kombëtare “Pjetër Bogdani” dhe thoshte se mezi priste që të bëhej studente mjekësie e të lexonte aty. Përshtypje fëmijëve u kishte bërë dhe Teatri Kombëtar, Galeria e Arteve e vendet e tjera që i kishin vizituar shkurt, por te secila prej tyre kishin mësuar diçka të veçantë.



- Cilat janë institucionet kulturore në Kosovë?
- Përmend disa institucione kulturore në qytetin tënd.
- Pse Borës i bëri përshtypje Biblioteka Kombëtare “Pjetër Bogdani”?
- Nëse ke vizituar ndonjërin nga institucionet e përmendura, ndaj me shokët e shoqet përshtypjet e tua.

Traditat dhe trashëgimia jonë

Institucionet kulturore

Institucionet kulturore janë institucione që shërbejnë për ruajtjen, kultivimin, promovimin, interpretimin dhe shpërndarjen e njohurive që kanë të bëjnë me njohuritë kulturore, përfshirë këtu edhe njohuritë nga fusha e shkencës, e mjedisit etj.

Ato bëjnë informimin dhe edukimin e qytetarëve për kulturë, shkencë dhe mjedis. Institucionet kulturore luajnë rol kryesor për mirëmbajtjen, ruajtjen, "ringjalljen", interpretimin dhe dokumentimin e trashëgimisë së komunitetit të atij vendi.

Ato përbëhen nga: muzetë, teatrot, kinematë, bibliotekat, galeritë etj. Këto institucione u mundësojnë njerëzve të mësojnë dhe të njihen me kulturën e vendit të tyre.

Njerëzit që duan të mësojnë për historinë e një vendi vizitojnë muzetë. Në teatro luhen shfaqjet, ku shikojmë aktorët në skenë, kurse në kinema shfaqen filma të ndryshëm.

Në biblioteka, lexuesit shfrytëzojnë libra të ndryshëm dhe në galeri shikojnë njerëzit të cilëve u pëlqejnë ekspozitat artistike (p.sh.: piktura).



Fjalët kyçe: institucion kulturor, galeri, teatër, bibliotekë.

87



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

DRTA

Lexohet situata e dhënë me ndalesa dhe pastaj parashtrihen pyetje për pjesën e lexuar dhe çfarë mendojnë për vendet e përmendura. Kështu vazhdohet deri në fund të tekstit dhe pastaj parashtrihen edhe pyetjet që janë në libër.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Mendim i lirë

Paraqitet me anë të projektorit një dokumentar i shkurtër për institucionet kulturore të vendit tonë (zgjedh dokumentarin nga interneti drejtpërdrejt) dhe pastaj diskutohet lidhur me rëndësinë duke e bërë dallimin e tyre se cilat ishin ato institucione, çfarë ruhet, ekspozohet, luhet në to...?

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për përgjigjet e dhëna, për pjesëmarrje në diskutim dhe dallimin e institucioneve kulturore.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Traditat dhe trashëgimia e jonë

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon veshjet e krahinave të ndryshme të Kosovës dhe disa nga tiparet karakteristike të tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1,7; III.1; V.8; VI.3,7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Veshjet tradicionale

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Rikujton njohuritë që i ka për veshjet tradicionale;
- Analizon veshjet tradicionale të trevave të Kosovës;
- Përshkruan veshjen tradicionale që i pëlqen;
- Ilustron tri elemente të një veshjeje tradicionale.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, projektor, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathësi për jetë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndet, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Imagjinatë e drejtuar


Në tabelë vendosim disa foto të veshjeve tradicionale të trevave të ndryshme të Kosovës. Këto foto shikohen së bashku me nxënësit dhe pastaj ata shprehin mendimet e tyre se cilës trevë të Kosovës mund t'i takojnë.



Traditat dhe trashëgimia jonë

Veshjet tradicionale

Situata 1. Klea me prindërit kishin vendosur të kalonin një fundjavë në Bjeshkët e Nemuna, në Bogë. Ai vend aq i bukur me natyrë mbresëlënëse, Kleas i ofronte qetësi e kënaqësi. Ndërkohë që po ktheheshin nga pushimi i shkurtër, Klea po u thoshte prindërve që këto male ishin shumë të bukura. Nëna e Kleas, që çmonte shumë traditën e popullit tonë, shtoi se ky vend, përveç që kishte relief të mrekullueshëm, kishte dhe shumë veçori të tjera që e bënin kaq të bukur. Nëna filloi të tregonte për veshjen tradicionale të Rugovës dhe, ndërkohë që po fliste për ngjyrat e kësaj veshjeje, punën e dorës e të tjera, Klea vetëm mrekullohej dhe vendosi që të kërkonte në internet këto veshje e të bënte një prezantim për to para klasës. Ajo donte që të nxishte dhe shokët e shoqet e klasës që të njihnin veshjet tradicionale të trevave të Kosovës, sepse pothuajse çdo vend ka veshjen e vet karakteristike.



- Çfarë rëndësie kanë veshjet tradicionale?
- Përmend dy gjëra të veçanta që Klea i mësoi në këtë udhëtim.
- Po ju, a keni dëgjuar për ndonjë veshje tjetër tradicionale? Diskutoni së bashku.
- Po në shtëpinë tuaj, a keni ndonjë veshje tradicionale?

Veshja tradicionale është një veshje që është përdorur tradicionalisht dhe është trashëguar nga e kaluara e një vendi apo krahine. Secili rajon i një vendi dhe secili shtet ka veshjet tradicionale të tij, p.sh.: veshja e Rugovës, e Hasit, e Tropojës etj. Veshja popullore e grave të Hasit ka karakteristika përdorimin e dërrasës, e cila mbulohet me veshje me motive dekorative, me ngjyra të ndryshme, ku mbizotëron e kuqja. Po ashtu, vlen të përmendet veshja e ngjyra të ndryshme, e përbërë nga këmisha me mëngë të shkurtra prej pëllhure. Çdo veshje ka një histori dhe karakterizohet nga elemente të veçanta që e veçojnë nga veshjet e tjera të një treve, të një krahine apo të një regjioni. Veshjet popullore janë shumë të kërkuara për ditët e festave dhe për ahengje të ndryshme. Veshjet e grave karakterizohen me qëndisje dhe ngjyra të ndryshme, kurse veshjet e burrave kryesisht janë punime leshi: tirq, këmishë, jelek dhe plisi që e karakterizojnë burrin tradicional shqiptar.



Veshje e Rugovës



Veshje e Drenicës

Fjalët kyçe: veshje tradicionale, traditë, kulturë, zakon.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
DRTA

Hapen librat dhe nxënësit do të lexojnë situatën 1 dhe do ta analizojmë së bashku. Do t'i shprehin mendimet të gjithë nxënësit nëse ata kanë dëgjuar ose parë fotografi të ndryshme të gjyshërve ose prindërve, martesat si i kanë bërë ata me veshje tradicionale.

Parashtron pyetjet e dhëna në libër dhe marrim përgjigjet e mendimet e nxënësve.



Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Diskutim për njohuritë paraprake

Shpërndahen fletët A4 për secilin nxënës dhe plotësojnë detyrat e dhëna.

- Përshkruaj veshjen tradicionale që të pëlqeu më shumë nga fotot apo veshjet që i ke parë.
- Ilustro tri elemente nga veshja tradicionale që të pëlqen.

Nxënësit në mënyrë të pavarur punojnë dhe paraqesin para shokëve e shoqeve punimet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për rikujtimin e njohurive paraprake, analizën, përshkrimin dhe ilustrimin e bërë.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Traditat dhe trashëgimia e jonë

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon ngjarje nga tradita e lashtë (dasmat, festat dhe ritet e tyre si Shën Gjergji etj.) dhe nga tradita kombëtare, shtetërore dhe përshkruan format e shënimit të tyre në familje, në shkollë, në komunitet. Merr pjesë në mënyrë aktive në shënimin e ndonjë feste tradicionale në shkollën dhe komunitet.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.3; III.2,3; V.8; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pjesëmarrja jonë në festë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përgjigjet në pyetjet e parashtruara;
- Analizon situatën e dhënë;
- Klasifikon llojet e festave.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Stuhi mendimesh

Parashtrihen disa pyetje lidhur me festat, si p.sh.:

- Çfarë festash festojmë ne?
- Cila është festa e fundit që e keni festuar?
- Si ka qenë ambienti ku keni festuar?
- Po veshja e juaj si ishte?
- Çfarë dhuratash keni dhënë ose marrë?



Traditat dhe trashëgimia jonë

Pjesëmarrja jonë në festë

Situata 1. Nea, shoqja e klasës së Teos dhe Amit, kishte organizuar dasmën e motrës në shtëpinë e saj. Po martohej motra e saj dhe ajo kishte dëshirë të fronte shokët dhe shoqet e klasës, që disa të mbanin fustanin e nuses e të tjerët lule. Ajo, bashkë me prindërit e vëllezërit e saj, kishin përgatitur shtëpinë, duke zbukuruar dhomën e ndenjjes dhe kishin përgatitur ëmbëlsira e ushqime nga më të ndryshmet. Ndërkohë që Teo po përgatitej për dasmë, nëna iu afrua dhe po i tregonte se sa e rëndësishme ishte që të respektonte familjen e Neas dhe përgatitjet e tyre për dasmë. Nëna po tregonte se sa e rëndësishme ishte që ai të shkonte në orarin e caktuar të shtëpia e shoqes së tij. Ajo gjithashtu i tha se duhej të mendonte që t'i bënte edhe një dhuratë e cila do ta gëzonte shumë atë, pasi të gjithë bëjnë dhurata në raste të tilla. Sa gjëra të bukura mësoi Teo! Ai përjetoj emocione të shumta, të cilat nuk do t'i harrojë kurrë.



Traditat dhe trashëgimia jonë

Pjesëmarrja jonë në festë

- Pse është e rëndësishme të zbukurohet ambienti për një festë të caktuar?
- Sa është e rëndësishme dhurata për ju?
- Si duhet të veprojmë gjatë festës, në të cilën jemi të ftuar?
- Si duhet të veprojmë gjatë një feste, në të cilën jemi mikpritësit?

Festa është një ditë që veçohet nga të tjerat, sepse lidhet me një ngjarje të caktuar gazmore. Dita e festës dallon nga ditët e tjera sepse përgatitjet ushqim më i veçantë, veshjet dallojnë nga ato të përditshmet etj. Gjatë ditëve të festave, jemi të lumtur dhe festojmë së bashku me prindërit, kushërinjtë, miqtë dhe shokët. Zakonisht gjatë festave marrim dhe japim dhurata, vallëzojmë, këndojmë etj. Festat mund të jenë individuale, familjare, shtetërore, kombëtare, ndërkombëtare, fetare etj. Festat individuale janë festa që i takojnë një individ, p.sh., festa e ditëlindjes. Festat shtetërore janë festa që feston një shtet, p.sh., Pavarësia e Kosovës. Festa kombëtare është festë që feston një komb, një popull kudo që ndodhet, p.sh., të gjithë shqiptarët që jetojnë nëpër vende të ndryshme të botës festojnë Pavarësinë e Shqipërisë. Festa ndërkombëtare është festë që festohet në të gjithë botën, p.sh. Dita e Gruas.

91



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Dëgjim dhe diskutim

Lexohet situata e dhënë si dhe analizohet gjatë leximit duke nxjerrë të dhëna nga libri në tabelë. Pas diskutimit, do të përgjigjen në pyetjet e parashtruara nga libri.

Në një kënd në tabelë, nxjerrim festat e ndryshme që festohen në vendin tonë dhe në botë. P.sh.: Viti i Ri, Bajrami, Krishtlindjet, “28 Nëntori”, “17 Shkurti”, Pashkët, ditëlindja etj...



Përforsimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Imagjinatë e drejtuar - Dy yje një dëshirë

Klasifikojnë festat e përmendura më lartë dhe i shkëmbejnë fletoret me shokun/shoqen duke e vërtetuar saktësinë e njëri-tjetrit me teknikën Dy yje një dëshirë..

Festa individuale	Festa shtetërore	Festa kombëtare	Festa ndërkombëtare
Martesa	“17 Shkurti”	“Lidhja e Prizrenit”	Viti i Ri

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për përgjigjet e dhëna, shprehjen e mendimit të lirë dhe klasifikimin e festave në fletoret e tyre.

Detyrë:

Të plotësojnë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Shoqëria dhe mjedisi
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Resurset dhe trashëgimia e vendit tim

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Përshkruan disa nga pasuritë kryesore natyrore të Republikës së Kosovës dhe shpjegon rëndësinë e shfrytëzimit racional të tyre për të mirën e gjeneratave të tashme dhe të ardhshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.1.2; IV.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 5.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njëësia mësimore: Shfrytëzimi i pasurive natyrore


- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan vendet e përmendura;
 - Tregon pasuritë natyrore të vendit, ato tokësore dhe nëntokësore;
 - Shpjegon rëndësinë shfrytëzimit të pasurive natyrore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, tekste të nxjerra nga interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

 **Parashikimi:**
Përgatitja për të nxënë
Stuhi mendimesh

- Nxitje e të menduarit të nxënësve:
- A e keni vizituar ndonjëherë Grykën e Rugovës?
 - Po për Minierën e Trepçës a keni dëgjuar?
 - Çfarë di për lumin Drini i Bardhë?



Resurset dhe trashëgimia e vendit tim

Shfrytëzimi i pasurive natyrore


Situata 1. Klea: Përsëritje, Rita! Më duhet të shkruaj një artikull informues për shfrytëzimin e pasurive natyrore në Kosovë dhe nuk kam asnjë ide se çfarë do të shkruaj. A mund të më ndihmosh me ndonjë informacion?
 Rita: Sigurisht. Atëherë, fillimisht duhet të përmendet që Kosova ka pasuri natyrore të bollshme. Ka pyje, lumenj, male, tokë bujqësore dhe shumë pasuri nëntokësore. Kosova për nga pasuritë natyrore është ndër vendet më të pasura në Evropë. Pasuritë natyrore ndahen në:

Pasuri mbitokësore	Pasuri nëntokësore
1. Toka e punueshme, e cila shfrytëzohet për zhvillimin e bujqësisë.	1. Thëngjilli linjit, i cili shfrytëzohet për prodhimin e energjisë elektrike në Termocentralin "Kosova".
2. Lumenjtë, të cilët i shfrytëzojmë për ujë të pijshëm apo ujë.	2. Ka shumë minerale e më së shumti plumb, i cili nxirret nga minierat e Trepçës në Mitrovicë.
3. Liqenet artificiale, të cilat shfrytëzohen për ujë të pijshëm.	3. Xehe të shumta.
4. Pyjet, drurët e të cilave shfrytëzohen për ngrohje apo për prodhimin e gjësendeve të ndryshme. Po ashtu, ato janë të rëndësishme për llojllojshmërinë e bimëve.	
5. Kosova ka shumë lloje të bimëve.	

Klea: Uaaa, nuk e kam ditur që vendi ynë ka kaq shumë pasuri natyrore. Faleminderit, Rita! Besoj që me këto informacione artikulli im do të informojë shumë njerëz për pasuritë tona natyrore!

Resurset dhe trashëgimia e vendit tim

Shfrytëzimi i pasurive natyrore



Ujëvarat e Mirushës



Liçeni i Badovcit



Drini i Bardhë



Liçeni i Batllavës

- Bisedoni rreth situatës së dhënë.
- Me çfarë është e pasur Kosova?
- Përmendni lumin ose liçenin artificial që gjendet në regjionin ku jetoni ju.
- Pse duhet të kemi kujdes për ruajtjen e pasurive natyrore?



Pasuri natyrore janë të mirat materiale që gjenden në natyrë dhe që mund të përdoren nga njeriu për të përmirësuar jetën e tij. Kosova, edhe pse është një vend me një sipërfaqe të vogël, ka pasuri të shumta natyrore. Një pjesë e tyre është përdorur për zhvillimin ekonomik, kurse pjesa tjetër mund të shfrytëzohet në të ardhmen. Kosova është e pasur me toka të punueshme, që shfrytëzohen për kultivimin e drithërave, të perimeve e frutave. Ndër pasuritë e Kosovës janë edhe lumenjtë, liçenet, pyjet dhe pasuritë nëntokësore.

Fjalët kyçe: pasuri natyrore, ujë, lumë, liçen, tokë, pyll.

93



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Di - Dua të di - Mësova

Nxënësve në grupe u shpërndahet një tekst apo situatë dhe pas leximit të tekstit në tabelën e dhënë, në fletë A4 shkruajnë:

Di	Dua të di	Mësova
Pasuritë tokësore të vendit tim:	Pasuritë nëntokësore:	Shfrytëzimi i pasurive tokësore dhe nëntokësore:

Të njëjtën e vizatojmë në tabelë dhe plotësojmë bashkë me nxënësit.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Pyetje-përgjigje/tryezë e rrumbullakët

Secili nxënës mund të bëjë pyetje dhe të përgjigjet në pyetjet e dhëna nga të tjerët. Nxënësit hulumtojnë më shumë në internet për pasuritë tokësore dhe nëntokësore të vendit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për identifikimin dhe mënyrën e shfrytëzimit të pasurive tokësore dhe nëntokësore.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Shoqëria dhe mjedisi
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Resurset dhe trashëgimia e vendit tim

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Identifikon disa nga pasuritë humane dhe të trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës dhe shpjegon rëndësinë e tyre për vendin.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3,4; II.1,2,7; III.1; V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2,3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njëësia mësimore: Shfrytëzimi i pasurive nëntokësore

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Numëron disa nga pasuritë nëntokësore;
 - Zgjeron njohuritë duke u përgjigjur;
 - Diskuton për përdorimin e fjalëve kyçe.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.


Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto të objekteve të pasurive nëntokësore.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuha dhe komunikimi, Art, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Parashikim me terma paraprakë

Numërohen disa nga pasuritë nëntokësore të cilat deri më tani nxënësit i kanë mësuar, por mundohemi që të shtojmë edhe disa të reja dhe t'i caktojmë se ku gjinden ato në vendin tonë.



Resurset dhe trashëgimia e vendit tim
Shfrytëzimi i pasurive nëntokësore

Situata 1. Pas mbërritjes së fundit të turistëve, udhërrëfyesi u drejtua për të grupi japonez dhe filloi bisedimin me ta. Ai nuk e dinte arsyen përse ky grup kishte ardhur prej së largu në Kosovë, prandaj menjëherë u interesua që ta shuante këtë kureshtje.

- Përhëndetje dhe mirë se erdhët në Kosovë! Jam i lumtur që keni ardhur në shtetin tonë.

- Konnichiwa (përhëndetje), faleminderit shumë për mikpritjen! Shpresoj të kalojmë mirë së bashku!

- Meqë jemi duke biseduar, mund t'ju pyes pse zgjodhët pikërisht Kosovën për ta vizituar?

- Ne jemi duke bërë disa hulumtime për pasuritë nëntokësore të vendeve të Evropës dhe, ndër to, zgjodhëm edhe Kosovën. Për pasuritë nëntokësore të vendit tuaj nuk kishte shumë informacione në internet, prandaj ato që do t'i mësojmë gjatë kohës sa jemi këtu do t'i shfaqim në uebfaqe.

- Para se t'i vizitojmë vendet që ju nevojiten për hulumtim, mund t'ju tregoj në pika të shkurtra për pasuritë tona nëntokësore. Kosova ka një nëntokë mjaft të pasur, duke filluar nga thëngjilli linjit - me sasi më të madhe, i cili shfrytëzohet për prodhimin e energjisë elektrike në Termocentralin "Kosova A" dhe "Kosova B", minerale të plumbit, të zinkut, të argjendit, të arit e shumë të tjera. Miniera më aktive është "Trepça", e cila ndodhet në Mitrovicë.

- Sipas atyre që thatë ju, Kosova qenka mjaft e pasur me minerale.



Resurset dhe trashëgimia e vendit tim

Shfrytëzimi i pasurive nëntokësore

- Bisedoni për situatën e dhënë.
- Cilat janë pasuritë nëntokësore të Kosovës?
- Përsë përdoren ato?
- A duhet të kemi kujdes në shfrytëzimin e tyre? Pse?
- A mendon edhe ti se me gjithë këto pasuri nëntokësore mund të zhvillohet më shumë ekonomia e vendit tonë?

Kosova ka shumë pasuri natyrore. Pasuritë natyrore që nxirren nga toka quhen pasuri nëntokësore. Zbulimi, shfrytëzimi dhe përpunimi i tyre janë shumë të rëndësishme për ekonominë e vendit. Pasuritë nëntokësore janë: shkëmbinjtë, mineralet, xehet dhe lëndët djegëse. Lëndët djegëse janë: thëngjilli, nafta dhe gazi natyror. Kosova është e pasur me thëngjill, nga i cili prodhohet energjia elektrike në Termocentralin e Kosovës. Ka shumë minerale e më së shumti plumb, që nxirret nga minierat e Treçës në Mitrovicë. Tregohet interesim i madh për gjetjen e gazit natyror në Kosovë dhe shfrytëzimin e tij për prodhimin e energjisë. Këto pasuri duhen shfrytëzuar sa më arsyeshëm, sepse harxhimi i pakontrolluar i tyre shkakton humbje, duke qenë se këto pasuri janë të parapërtëritshme.



Fjalët kyçe: pasuri nëntokësore, minerale, minierë, lëndë djegëse, thëngjill.

95



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Përvijim i të menduarit

Prezantohen disa foto të “Treçës”, “Termocentralit Kosova A dhe B”. Parashtrihen disa pyetje lidhur me këto foto si p.sh.:

- Çfarë janë këto foto?
- Cilat janë prodhimet në këto objekte?
- Çfarë na nevojiten ato prodhime?

Lexohet mësimi që gjendet në libër dhe komentohen rastet që përmenden në tekst po ashtu edhe përgjigjen në pyetjet që janë në libër poshtë tekstit. Lexohet edhe pjesa shtesë në libër me ndalesa dhe sqarime më të hollësishme.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Fjalët kyçe

Nxënësit kanë për detyrë të shkruajnë një ese me fjalët kyçe që janë në fund të mësimit. Lexohen dy ose tri tregime nga nxënësit dhe diskutohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mendimet e dhëna për pasuritë nëntokësore, përgjigjet e dhëna dhe për tregimet e shkruara me fjalët kyçe.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Shoqëria dhe mjedisi
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Resurset dhe trashëgimia e vendit tim

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Përshkruan disa nga pasuritë kryesore natyrore të Republikës së Kosovës dhe shpjegon rëndësinë e shfrytëzimit racional të tyre për të mirën e gjeneratave të tanishme dhe të ardhshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3,4; II.1,2,7; III.1; V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2,3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shfrytëzimi i pasurive mbitokësore

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Numëron disa nga pasuritë mbitokësore;
 - Dallon rëndësitë e pasurive mbitokësore;
 - Interpreton në mënyrë figurative pasuritë mbitokësore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë të bardha.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuha dhe komunikimi, Art, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Karakteristikat e pasurive mbitokësore

Kërkohet nga nxënësit që të formojnë një rreth duke ua dhënë nga një fletë të bardhë, detyrë e tyre është që të shkruajnë tri pasuri mbitokësore dhe karakteristikat e tyre. Pasi t'i kenë përfunduar në grup diskutojnë dhe i bashkojnë idetë e tyre dhe i shkruajnë në një fletë të përbashkët dhe i lexojnë para klasës, formohen njohuritë e përbashkëta dhe shënohen në tabelë.



Resurset dhe trashëgimia e vendit tim
 Shfrytëzimi i pasurive mbitokësore

Situata 1. Një ditë Rona dhe Aldi kishin mësuar për pasuritë mbitokësore të Kosovës. Për shkak se ishte shumë i lodhur, Aldi nuk e kishte kuptuar shumë mirë këtë mësim.
 - Jo! Nuk arrij ta kuptoj dot! Rona, a mund të m'i përmendësh edhe një herë disa shembuj?
 - Po, sigurisht. Pasuritë mbitokësore janë të gjitha pasuritë që gjenden mbi sipërfaqen e tokës. Pjesa më e madhe e tokës në Kosovë, më tepër se gjysma e saj, është tokë e punueshme, nga e cila mundësohet zhvillimi i bujqësisë. Pjesa tjetër është tokë pyjore me malet më të njohura që janë: Bjeshkët e Nemuna, malet e Sharrit, malet e Pasitrikut e shumë male të tjera.
 - Rona, më duket se përveç tokave, përmendëm edhe faktorë të tjerë që pasurojnë vendin tonë.
 - Po, pasuri tjetër është edhe druri. Është shumë e rëndësishme që prerja e drurëve të bëhet në mënyrë të kontrolluar.
 - E më pas folëm për pasuritë ujore.
 - Aq sa di unë, pasuritë ujore përfshijnë liqenet, lumenjtë, ujërat minerale dhe termike.
 - Të lumtë, Rona!
 - Çili është lumi më i gjatë nga këta që përmende?
 - Drini i Bardhë.
 - Po ujërat minerale dhe termike?
 - Ujërat kryesore minerale dhe termike njihen si banja shëruese, pasi përbajnë minerale dhe shumë njerëz gjejnë shërim në këto ujëra.

- ?**
- Bisedoni për situatën e dhënë.
 - Cilat janë pasuritë mbitokësore të vendit tonë?
 - Cilat janë malet kryesore të vendit tonë?
 - Pse janë të rëndësishme malet?
 - Cilët janë lumenjtë më të mëdhenj të vendit tonë?

! Pasuritë mbitokësore janë të gjitha pasuritë që gjenden mbi sipërfaqen e tokës. Pasuri mbitokësore janë: ujërat (lumenjtë, liqenet, detet, oqeanet), fushat, malet, kafshët e bimët. Pasuritë mbitokësore janë pasuri që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit. Druri karakterizohet si burim kryesor i ngrohjes dhe i prodhimit të shumë sendeve në doli të njeriut. Pasuritë ujore përfshijnë liqenet, lumenjtë, ujërat minerale dhe termike. Liqenet më të njohura janë: liqeni i Radoniqit, i Gazivodës, ai i Batllavës, i Përlepnicsës dhe i Badovcit. Ndërsa, lumenjtë kryesorë janë: Drini i Bardhë, Lepenci, Morava dhe Ibrit. Ujërat kryesore minerale dhe termike janë Banja e Pejës, Banjaska dhe Banja e Kllokotit. Të gjitha këto njihen si banja termale shëruese, të cilat shfrytëzohen për shërimin e shumë sëmundjeve.



Fjalët kyçe: pasuri mbitokësore, tokë pjellore, pyll, lumë, liqen, ujë termal.

97



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: **Përpunimi i përmbajtjes** *Përvijim i të menduarit*

Numërohen malet dhe lumenjtë e Kosovës, bisedohet për rëndësitë e këtyre maleve dhe lumenjëve dhe në të njëjtën kohë shënohen në tabelë.

Lexohet mësimi nga libri dhe diskutohen pjesët shtesë dhe pyetjet që gjenden në libër.



Përforcimi: **Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit** *Përshkrim*

Paraqesin me anë të një vizatimi të gjitha ato që i kanë mësuar dhe lexuar. Vendosen në klasë duke i diskutuar disa nga punimet e bëra dhe për-
zjedhet punimi më i bukur dhe më kuptimplotë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për shkrimet e bëra, për mendimet e dhëna dhe vizatimet e paraqitura.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Shoqëria dhe mjedisi
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Resurset dhe trashëgimia e vendit tim

Rezultatet e të nxënës të temës:

Përshtatshme disa nga pasuritë kryesore natyrore të Republikës së Kosovës dhe shpjegon rëndësinë dhe shfrytëzimin racional të tyre për të mirën e gjeneratave të tashme dhe të ardhshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3,4; II.1,2,7; III.1; V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2,3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shfrytëzimi i arsyeshëm i pasurive natyrore

Rezultatet e të nxënës të orës mësimore:

- Klasifikon burimet e ripërtëritshme dhe të parapërtëritshme;
- Arsyeton përdorimin e burimeve të ripërtëritshme
- Konfirmon kuptimin e ndarjes së energjive të ripërtëritshme dhe atyre të parapërtëritshme.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografitë e burimeve të energjisë dhe fletët me tabelë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuha dhe komunikimi, Art, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënës

Parashikim me terma paraprakë

Shpërndahen në grupe disa fotografi në të cilat do të ketë ujëvara, male, miniera (Trepça), burime të naftës, dielli (i paraqitur në disa pozita) etj. Poshtë fotove do të shkruajnë çfarë ata dinë për këto bukuri natyrore. Së bashku do t'i ndajmë në burime të ripërtëritshme dhe të parapërtëritshme.



Resurset dhe trashëgimia e vendit tim

Shfrytëzimi i arsyeshëm i pasurive natyrore

Situata 1. Zilja e orës së fundit ra dhe nxënësit dolën me vrap nga shkolla për të luajtur me njëri tjetrin. Nga ky grup u ndanë dy shoqë, të cilët kishin për detyrë të bënin një punim rreth ruajtjes së pasurive natyrore. Kështu, ata filluan të mbledhnin informacionet që do t'i prezantonin para klasës.

- O Mali, di ti ndonjë gjë se si ndahen pasuritë natyrore?
 - Në një enciklopedi që e kam lexuar më parë, thuhet se pasuritë natyrore janë toka së bashku me mineralet e saj, ujërat, rrezet e diellit dhe atmosfera. Ato ndahen në burime të ripërtëritshme dhe të parapërtëritshme.

- Për t'i shfrytëzuar këto pasuri në mënyrë të arsyeshme, si ide më e përshtatshme do të ishte shfrytëzimi më i madh i paneleve diellore dhe i helikave që lëvizin me ndihmën e erës, pasi pasuritë nëntokësore, si qymyri, nafta dhe gasi natyror së bashku me ujërat janë burime të parapërtëritshme, - tha Klea.

- Këtu mendimi mund t'ia shtojmë faktin se burimet e parapërtëritshme mund të harxhohen një ditë dhe kështu brezat e ardhshëm nuk do të kenë mundësi që t'i përdorin ato.

- Nafta, qymyri dhe gasi natyror janë shkaktarë të ndotjes së ambientit duke e ulur cilësinë e ajrit. Në fillim, duhet të mbijellim disa pemë, në mënyrë që brezat e ardhshëm, por edhe ata që janë tani, të kenë një ajër të pastër. Pastaj, mund të mbajmë edhe sesione informuese nëpër shkollë se si mund të kursejmë ujin dhe energjinë elektrike, duke i përdorur në masë të caktuar.

- Të shkojmë më shpejt në shtëpi dhe t'i shkruajmë këto mendime.

Duke biseduar, Mali dhe Klea erdhën në përfundim se mënyra më e mirë për ruajtjen e resurseve natyrore është që burimet e ripërtëritshme të përdoren më shumë se ato të parapërtëritshme dhe se secili prej nesh të vetëdijësohet për përdorimin e arsyeshëm të tyre.



- Për çka biseduan Mali e Klea?
- Si ndahen pasuritë natyrore?
- Pse është e rëndësishme të shfrytëzohen burimet natyrore në mënyrë të arsyeshme?
- Pse duhet t'i përdorim më shumë energjinë e erës dhe atë diellore?

98 Fjalët kyçe: pasuri natyrore, të parapërtëritshme, të ripërtëritshme, diell, ujë, ajër, lëndë djegëse.



Pasuri natyrore ose burime natyrore janë të mirat materiale që gjenden në natyrë dhe që mund të përdoren nga njeriu. Ato ndahen në burime të ripërtëritshme (që janë dielli e ajri) dhe të paripërtëritshme (lëndët djegëse, si qymyri, nafta dhe gazi natyror, si dhe uji). Burimet natyrore duhet të shfrytëzohen në mënyrë të arsyeshme, sepse shfrytëzimi i pakontrolluar i tyre shkakton shterjen ose harxhimin e tyre, për shkak se ato janë të paripërtëritshme. Po ashtu, shfrytëzimi i këtyre burimeve shkakton edhe ndotjen e ambientit. Në botë, sot po punohet që të prodhohet energjia me shfrytëzimin e rrezeve të diellit dhe të erës, sepse janë burime të ripërtëritshme dhe ruajnë ambientin nga ndotja.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
 DLTA

Lexohet mësimi me ndalesa, duke u munduar që pas çdo ndalesë të merren mendimet e nxënësve dhe t'i shprehin mendimet e tyre se çfarë ata mendojnë që do të ndodhë në vazhdim duke u bazuar në bisedat e fëmijëve në tekst.

Parashtrihen edhe pyetjet që janë në fund të mësimi.



Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve
 Tabela e koncepteve

Plotësohet tabela dhe diskutohet.

	Lëndët e ripërtëritshme	Lëndët e paripërtëritshme
Uji		
Qymyri		
Ajri		
Lëndët djegëse		
Dielli		
Gazi natyror		

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mendimet e dhëna për figurat në fotografi, përgjigjet e dhëna dhe për plotësimin e tabelës në mënyrën e duhur.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Resurset dhe trashëgimia e vendit tim

Rezultatet e të nxënësve të temës:

Identifikon disa nga pasuritë humane dhe të trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës dhe shpjegon rëndësinë e tyre për vendin.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.1,3,4; II.1,2,7; III.1; V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2,3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njëësia mësimore: Pasuritë humane

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Tregon njohuritë që ka për fjalët e dhëna;
- Bën dallimin midis pasurive natyrore dhe humane;
- Provon të plotësojë tabelën me fjalët e duhura.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hamer ose flipçart.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuha dhe komunikimi, Art, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Parashikim përmes fjalëve kyçe

Shkruhen në tabelë fjalët: lum, drunj, mjeke, murator, diell, polic, lule etj. Nxënësit do të japin mendimet e tyre se çfarë dallojnë ato në mes vete, diskutohet dhe merren mendimet e tyre.



Resurset dhe trashëgimia e vendit tim

Pasuritë humane

Situata 1. Një ditë, Rona në një revistë pa një detyrë, ku kishte shumë fotografi. Mbi to shkruhej udhëzimi:
 • Luaj dhe mëso.
 • Ndaj fotografitë në dy grupe.
 • Trego se çka janë pasuritë natyrore dhe humane.
 Rona ka dëshirë të tregojë zgjidhjen e detyrës, prandaj edhe e publikoi atë në librin tonë.



100

Resurset dhe trashëgimia e vendit tim



Pasuritë humane

Pasuri natyrore	Pasuri humane apo njerëzore
Dielli, ujërat, pyjet, bimët etj.	Mjekët, mësuesit, policët, muratorët etj.

Në grupin e parë "Pasuri natyrore" bëjnë pjesë të gjitha pasuritë që gjenden në natyrë, pra ato që i shohim si pjesë përbërëse e natyrës. Në grupin e dytë "Pasuri humane apo njerëzore" bëjnë pjesë njerëzit që përdorin aftësitë e tyre për të kryer një shërbim.
- Të dashur, moshatarë të mël! Në tabelën më lart, shtoni edhe të tjera në listën e pasurive natyrore dhe njerëzore, - tha Rona.

- Trego sipas mendimit tënd pse quhen pasuri natyrore dhe pse pasuri humane.

- Shiko nga dritarja dhe shkruaj cilat pasuri natyrore po sheh.



- Mendo për anëtarët e familjes sate dhe shkruaj pasuritë humane që përfaqësojnë ata.

Vendi ynë është mjaft i pasur me pasuri natyrore. Edhe më të pasur e bëjnë atë pasuritë humane apo njerëzore. Nxënësit në vendin tonë shkollohen dhe përgatiten për t'i shërbyer shtetit. Pasuri humane, që ndryshe mund të themi edhe burime njerëzore, janë tërë fuqia punëtore e një vendi dhe njohuritë që kanë ata për të ushtruar një profesion. Burimet njerëzore pa dyshim që janë shtytësi kryesor i zhvillimit ekonomik të vendit. Sa më të ditur që të jenë njerëzit, aq më të aftë janë ata për shprehjen e aftësive të tyre për të kryer një shërbim.

Fjalët kyçe: pasuri humane, aftësi, shërbim.

101



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Përvijim i të menduarit

Të gjithë nxënësit shprehin mendimet e tyre pas leximit të mësimit dhe në të njëjtën kohë plotësohen pjesët e zbrazëta në libër.

Parashtrihen pyetjet që gjenden në pjesën e fundit të mësimit.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit INSERT

Vendoset një hamer ku nxënësit do të dalin me radhë dhe do ta plotësojnë, si p.sh.:

Pasuri natyrore	Pasuri humane apo njerëzore

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mendimet e dhëna, për fjalët e dhëna, për pjesëmarrje në diskutim dhe për plotësimin e tabelës në mënyrë të duhur.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Shoqëria dhe mjedisi
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Resurset dhe trashëgimia e vendit tim

Rezultatet e të nxënësve të temës:
 Identifikon disa nga pasuritë humane dhe të trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës dhe shpjegon rëndësinë e tyre për vendin.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.1,3,4; II.1,2,7; III.1; V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2,3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njëësia mësimore: Ruajmë trashëgiminë kulturore

- Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:**
- Rikujton objektet e trashëgimisë kulturore;
 - Identifikon objektet kulturore që i dëgjon;
 - Zgjeron idetë për trashëgiminë kulturore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuha dhe komunikimi, Art, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Leksikoni i përparuar me parapërgatitje të nxënësve

Nxënësit bashkohen në dyshe. Secila dyshe duhet të bëjë një listë të të gjitha gjërave që i dinë për trashëgiminë kulturore (3 minuta kohë), pastaj dyshet duhet t'ua tregojnë idetë edhe të tjerëve në grup.

Shkruhet në tabelë një listë me mendimet e nxënësve.



Resurset dhe trashëgimia e vendit tim
 Ruajmë trashëgiminë kulturore

Situata 1. Familja Gashi kishte dalë për ta kaluar fundjavën në qytetin e Prizrenit. Jonila, 10-vjeçare, po e shijonte shumë atë udhëtim. Kurioziteti i saj u shtua kur pa gjithë ato ndërtesa të vjetra: muze, kala dhe vende që përfaqësonin denjësisht kulturën e vendit tonë. E kush tjetër do të mund t'i jepte përgjigje më të saktë sesa babai i saj, zëjtar në qytetin e Gjakovës!
 - Babi, a mund të më tregosh prapë se çka konsiderohet *trashëgimi kulturore*?
 - Po, Jonila. Të gjitha parqet natyrore, galeritë e artit, kalatë, kullat, monumentet fetare, rrugicat e ngushta, shatërvanët dhe shumë objekte të tjera janë elemente që kanë rëndësi të madhe për ruajtjen e kulturës dhe të traditës shqiptare.
 - Të gjitha këto që i përmende qenkan objekte. A ka edhe gjëra të tjera që përfaqësojnë trashëgiminë kulturore?
 - Po, sigurisht. Trashëgimia jomateriale përfshin gjuhën dhe krijimtarinë popullore.
 - Cilat janë disa nga monumentet kryesore arkeologjike?
 - Mund të përmendim qytetin e lashtë të Ulpianës, Manastirin e Deçanit dhe Shtëpinë e Lidhjes së Prizrenit. Kosova ka edhe shumë muze.
 Veshjet dhe gatimet tradicionale që përcillen brez pas brezi janë mjaft unike.
 - E mrekullueshme. Mezi po pres që për gjërat që mësova sot, të bisedoj me shokët dhe mësuesen në shkollë.



- Bisedoni për situatën e dhënë.
- Çfarë e përbën trashëgiminë kulturore materiale?



Resurset dhe trashëgimia e vendit tim



Ruajmë trashëgiminë kulturore

- Çka bën pjesë në trashëgiminë kulturore jomateriale?
- A duhet të krenohemi për trashëgiminë kulturore të vendit tonë? Pse?
- Kur përdoren më shumë veshjet dhe gatimet tradicionale?



Kosova ka një trashëgimi kulturore të larmishme, e cila e bën një vend tërheqës për të gjithë vizitorët. Çdo pjesë e Kosovës ka një trashëgimi të pasur materiale me qendra arkeologjike, parqe natyrore, kala, kulla, monumente fetare, galeri të artit, rrugë të ngushta me kalldrëm, shatërvanë, muze, shtëpi të vjetra e objekte të tjera.

Kosova ka 7 muze aktive, në të cilët ruhen shumë monumente kulturore që tregojnë për historinë e popullit tonë. Ndër ta, vlen të theksohet Muzeu Historik Kombëtar, Muzeu Etnologjik "Ermin Gjiku", Muzeu i Prizrenit, i cili fillimisht ka funksionuar si banjë turke. Po ashtu, vlen të përmendet edhe Kompleksi Memorial "Adem Jashari".

Në Kosovë ka edhe shumë monumente të tjera. Shumica e monumenteve janë manastire, kështjella, kisha dhe xhami. Ndër objektet arkeologjike vlen të përmendet ayeti i lashtë i Ulplanës. Gjithashtu, kemi Manastirin e Deçanit dhe Shtëpinë e Lidhjes së Prizrenit që përbëhet nga katër godina.

Të gjitha këto objekte i takojnë trashëgimisë kulturore materiale. Këto objekte mbrohen me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore.

Trashëgimia kulturore jomateriale përfshin gjuhën, krijimtari të popullore, të cilat janë ruajtur dhe përcjellë ndër breza.

Një vend të veçantë në trashëgiminë kulturore të vendit tonë zënë edhe veshjet dhe ushqimet tradicionale.



Fjalët kyçe: trashëgimi kulturore, objekt, muze, monument, veshje, ushqim.

103



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Përvijim i të menduarit

Para se të fillojnë me lexim, nxënësit udhëzohen që gjatë leximit ta përcjellin listën e ideve dhe të shtojnë ide të reja në listë.

Fillohet me leximin e pjesës së parë të mësimt, mbahet lista përpara kur lexohet. Pas leximit rishikohen listat, nëse ka gjëra që janë lexuar dhe nuk i kemi në listë gjërat e reja, radhiten dhe shënohen.

Nëse kemi problem të ri, shkëputje logjike në njësinë mësimore, atëherë rifillohet procesi, duke i angazhuar prapë çiftet, për të formuar një listë të re idesh dhe për të përsëritur procesin.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Përsëritje

Në fund, nga grupet kërkohen vullnetarë për të dhënë disa nga idetë e tyre. Kështu, bëhet prezantimi i asaj që është mësuar e njëkohësisht lexohen pyetjet dhe merren përgjigje nga nxënësit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për dhënien e mendimit për formimin e listës, përcjelljen e mësimt dhe plotësimin e listës me përgjigjet që i dhanë.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Resurset dhe trashëgimia e vendit tim

Rezultatet e të nxënit të temës:

Merr pjesë aktive dhe përcakton veprimet që duhet t'i ndërmarrë në bashkëpunim me të tjerët në organizimin e aktiviteteve të ndryshme që promovojnë ruajtjen e mjedisit, trashëgimisë ekonomike, shëndetësore dhe kujdesit shoqëror ndaj të tjerëve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3,4; II.1,2,7; III.1; V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2,3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kujdesi shëndetësor

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Krahason sjelljet e djaloshit me sjelljet e veta;
- Shpjegon kuptimin e thënies “Sporti zhvillon trupin dhe mendjen”;
- Këshillon Malin për mënyrën e të qenit i shëndetshëm.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografitë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuha dhe komunikimi, Art, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Copëzat e përziara

Në grupe shpërndahen zarfe që brenda tyre përmbajnë fotografi të prera në copëza. Paraqesin etapat e ditës dhe pamjet e fëmijës i cili në një të një foto është i zgjuar e jashtë duket natë, në një të një duke fjetur e jashtë duket ditë, fëmijët duke shkuar në shkollë...

Nxënësit do të formojnë fotografi duke i bashkuar dhe pasi t'i ngjitin në fletën e bardhë i vendosin



Resurset dhe trashëgimia e vendit tim

Kujdesi shëndetësor

Situata 1. Mali, çdo mbrëmje, shkon në shtrat pasmesnate. Të nesërmen duhet të zgjohet në orën 07:00, për t'u përgatitur për shkollë. Ai çdo mbrëmje i lë gatë rrobat e shkollës, kështu që në mëngjes i vesh shpejt e shpejt, e shkon me vrap në shkollë. Mali mëngjesin e ha në shkollë, në orën 9 e 30 minuta. Pas mësimt, kthehet në shtëpi i lodhur, ha drekën, lëshon perdet e dritareve që të bëhet errësirë dhe menjëherë shtrihet për të bërë gjumin e pasdites. Shokët e thërresin për të luajtur futboll ose ndonjë lojë tjetër në ajër të pastër, por ai asnjëherë nuk u bashkohet atyre, sepse i duhet të flejë. Pasi zgjohet, atij i pëlqen të hajë ushqime të shpejta dhe të pijë pije të gazuara. Nuk ha me orar dhe nuk pi mjaftueshëm ujë. Të gjithë janë të brengosur pse Mali është shumë i zbehtë dhe nuk është i shëndetshëm. Prindërit kanë vendosur të ndërrojnë shprehitë e Malit, në mënyrë që ai të bëjë një jetë më të shëndetshme.



Resurset dhe trashëgimia e vendit tim

Kujdesi shëndetësor

- Bisedoni për situatën e dhënë.
- Pse Mali është i zbehtë dhe nuk është i shëndetshëm?
- Çfarë duhet të bëjmë që të jemi të shëndetshëm?
- Cili është ushqimi yt më i pëlqyer? A mendon se është i shëndetshëm? Pse?
- Shpjego thënien: "Sporti zhvillon trupin dhe mendjen".

Shkruaj një këshillë për Malin. Tregoji atij se çfarë duhet të bëjë për të qenë i shëndetshëm.

Ruajtja e shëndetit bëhet vetëm me kujdes të vazhdueshëm. Kujdes shëndetësor do të thotë mirëmbajtja ose përmirësimi i shëndetit tonë. Për të bërë një jetë të shëndetshme, duhet të kujdesemi për higjienën personale, të marrim ushqime të shëndetshme, të merremi me aktivitete fizike, me sporte të ndryshme dhe të bëjmë shëtitje në ajër të pastër, pasi të gjitha këto forcojnë trupin dhe mendjen. Që të jemi të aftë të kryejmë të gjitha aktivitetet ditore, duhet të bëjmë së paku tetë orë gjumë në ditë. Duhet bërë vizita të vazhdueshme te stomatologu dhe te mjeku i familjes. Shprehitë për kujdesin shëndetësor krijohen qysh në fëmijëri të hershme dhe zbatohen gjatë gjithë jetës.

Fjalët kyçe: kujdes shëndetësor, higjienë, sport, ushqim i shëndetshëm, vizitë mjekësore.

105

në tabelë, mundohemi së bashku t'i radhisim dhe bisedojmë për shprehitë e mira dhe jo të mira, si të fëmijëve në foto, po ashtu duke i krahasuar me shprehitë tyre.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive: Përpunimi i përmbajtjes Krahasim

Lexohet mësimi dhe diskutohet me sjelljen e djaloshit dhe shëndetin e tij, duke u munduar t'i krahasojmë fotografitë e vendosura në tabelë dhe leximin e tekstit, shkaktarët negativ të shëndetit dhe suksesit.

Parashtrohen pyetjet dhe e shpjegojnë thënien "Sporti zhvillon trupin dhe mendjen".



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Shkrim i lirë

Shkruajnë një këshillë për Malin duke i treguar atij se çfarë duhet të bëjë për të qenë i shëndetshëm. Lexohen disa nga shkrimet dhe vlerësohen shkrimet me shprehjen e mendimeve.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për bashkëpunimin në grup, shpjegimin e shprehjes dhe këshillën e dhënë.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Shoqëria dhe mjedisi
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV
Tema: Resurset dhe trashëgimia e vendit tim

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Përshkruan me shembull konkret si dëmtohet mjedisi nga hedhja e mbeturinave familjare dhe industriale në vende joadekuate, nga trafiku, keqpërdorimi dhe degradimi i tokës, pyjeve dhe ujërave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3,4; II.1,2,7; III.1; V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2,3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndhimojmë për një mjedis të pastër

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Klasifikon mbeturinat në vendet e duhura;
- Arsyeton kontributin e dhënë në mbajtjen e mjedisit të pastër;
- Përmbledh shprehjet e duhura për mbrojtjen e mjedisit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me figura.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuha dhe komunikimi, Art, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Kush jam unë

Paraprakisht përgatiten etiketa me figura që i paraqesin shportat e mbeturinave ricikluese; fëmijët nuk duhet t'i shohin por vetëm t'ju vendosen në ballë. Nxënësit kanë për detyrë ta ndihmojnë njëri-tjetrin që të bëhen bashkë ata që i kanë etiketat e njëjta dhe në fund do të vendosen në tabelë nga një shembull i mbeturinave, poshtë tyre do të shkruajnë grupi që janë formuar, emrat e gjërave që mund të hidhen në atë lloj të shportës.



Situata 1. Mësuesi: Nxënës, sot do të flasim për ambientin, pandaj ajo çka kërkoj nga ju është që secili nga ju të tregoni se si mund të ndihmoni për një mjedis të pastër. Eri: Mësues, duke qenë se makinat ndotin ajrin, nëpër qytet duhet të ecim, të shfrytëzojmë biçikletën ose transportin publik - autobusin. Ema: Për jetë të shëndetshme në planetin tonë, në të ardhmen, një rol të rëndësishëm do të luajë menaxhimi i mbeturinave. Ato duhet të riciklohen. Riciklimi i tyre është shumë i rëndësishëm. Prodhimi i sendeve nga riciklimi i mbeturinave harxhon më pak energji se prodhimi i tyre nga materiale të reja. Mbeturinat nuk duhet të hidhen në tokë, por në shportat përkatëse. Klea: Uji është i çmueshëm, kështu që duhet ta ruajmë. Të mos derdhim mbeturina në lumenj! Të mos e lëmë çezmën hapur pa nevojë! Të kujdesemi për ruajtjen e energjisë. Mali: Ne mund të mbjellim drurë, shumë drurë së paku një gjatë jetës sonë. Ne së bashku mund ta bëjmë ndryshimin për një ambient sa më të pastër dhe një jetë të shëndetshme. Mësuesi: Ju lumtë, nxënës! Ne duhet të kujdesemi për ambientin që edhe vetë të jemi të shëndetshëm.

Resurset dhe trashëgimia e vendit tim



Ndihmojmë për një mjedis të pastër

- A është e rëndësishme që secili të kontribuojë për ruajtjen e mjedisit? Pse?
- Çfarë bën ti për një mjedis të pastër?
- Çfarë duhet të bëjmë për mbrojtjen e tokës, të ujit dhe të ajrit?
- Krahaso punimin tënd me të shokut të bankës e më pas diskutoni në klasë.



Toka	Uji	Ajri

Mjedisit jetësor është tërë hapësira e natyrës, në të cilën jetojmë, punojmë, lëvizim dhe veprojmë. Njeriu, me sjelljen e tij, ndikon në ndryshimet që ndodhin në natyrë. Ato veprime mund të jenë të dëmshme apo të dobishme për natyrën. Mjedisit i pastër siguron shëndet të mirë për të gjitha qeniet e gjalla që jetojnë në planetin tonë. Është përgjegjësi e çdo qytetari të kontribuojë për ruajtjen e mjedisit nga ndotja.

Për një mjedis të pastër, ne duhet të kursejmë energjinë, të udhëtojmë me biçikletë apo me transport publik, t'i klasifikojmë mbeturinat dhe t'i hedhim ato në vendin e caktuar, ta kursejmë ujin, ta gjelbërojmë sa më shumë mjedisin, që të kemi ajër të pastër.

Njeriu duhet t'i vërë detyrë vetes që, nëse nuk mund të mbrojë natyrën, së paku të mos e shkatërrojë atë!

Fjalët kyçe: mjedis, kujdes, mbrojtje, ujë, ajër, tokë.

107



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Lexim me role

Grupet e formuara do të lexojnë duke i ndarë personazhet, do të vazhdohet me të gjitha grupet me radhë. Përgjigjen në pyetjet e parashtruara në libër dhe shprehin mendimet e tyre se si mund të kontribuojnë në mjedisin e pastër.

Përshkruajnë një shembull konkret si dëmtohet mjedisi nga hedhja e mbeturinave familjare dhe industriale në vende joadekuate, nga trafiku, keqpërdorimi dhe degradimi i tokës, pyjeve dhe ujërave.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve

Zbatim i njohurive

Plotësojnë pjesën e dhënë në libër rëndësinë dhe mënyrat e mbrojtjes së tokës, ujit dhe ajrit. Në fund lexohen disa dhe plotësohen duke e dëgjuar njëri-tjetrin me shprehjet që ata nuk i kanë shkruar.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mënyrën e sjelljes dhe ndihmën e dhënë gjatë zhvillimit të lojës, për përgjigjet e dhëna dhe plotësimin e librit.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mjedisi i vendit tim

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpjegon rëndësinë e zgjerimit të sipërfaqeve të gjelbra, përdorimit të transportit publik dhe atij ekologjik, riciklimit të mbetjeve, krijimit dhe përdorimit të deponive adekuate.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1, 2, 6; III.1, 2; IV.4; VI.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 5.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Njeriu mbron natyrën

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan kujdesin ndaj mjedisit;
- Analizon të mirat e aktiviteteve për mbrojtjen e mjedisit;
- Argumenton organizimin vullnetar për pastrimin e ambientit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Interneti

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuha dhe komunikimi, Art, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Stuhi mendimesh

Nxitet diskutimi me anë të pyetjes:

- Pse duhet të kujdesemi për mjedisin?



Mjedisi i vendit tim

Njeriu mbron natyrën

Era po shiletonte fjalorin e gjuhës shqipe dhe po shikonte se sa fjalë i njihnte. U befasua kur pa një prej përkufizimeve për natyrën: "Natyra është mjedisi në të cilin rron njeriu në Tokë, me të gjitha qeniet e gjalla dhe sendet pa jetë". Ndaloi të reflektonte: si mundet njeriu të dëmtojë jo vetëm mjedisin që e rrethon, por edhe mjedisin ku jetojnë edhe gjallesat e tjera.

- Sa keq bëjmë kur e ndotim rrugën, pyjet e detin, - shtoi Era, me zë të lartë. - Ja, për shembull, kur hedhim mbeturina në det apo breg, ne përveçqë e ndotim një peizazh aq mahnitës, edhe shkatërojmë jetën e shumë gjallesave të detit. Pse i bëjmë këto veprime? Pse duhet të hedhim mbeturina në tokë, në vend që t'i mbajmë ato dhe t'i hedhim në shportën e mbeturinave? Pse mos të mbjellim drurë për gjelbërimin e mjedisit, por i presim ata? Sa kushton të hedhim shisheet e plastikës në shportën për riciklim? Dua të bëj një prezantim për mbrojtjen e natyrës para shoqëve dhe shokëve të klasës, - mendoi Era, e shqetësuar për gjendjen e natyrës në vendin tonë.



Mjedisi i vendit tim

Njeriu mbron natyrën

- Ç'kupton me fjalën *natyrë*?
- Cilat prej veprimeve i sheh si të dëmshme Era?
- Klasifiko mbeturinat sipas ngjyrës së shportave ricikluese.

Ndotja e mjedisit natyror me ndotës të ndryshëm shkakton ndryshime të shumta në tokë, ujë dhe ajër, të cilët drejtpërdrejt ndikojnë edhe në jetën e qenieve të gjalla. Njeriu ka për detyrë të mbrojë mjedisin në të cilin jeton dhe vepron. Ky kujdes ndaj natyrës duhet të jetë i vazhdueshëm dhe i përhershëm, në mënyrë individuale dhe grupore. Njeriu çdo ditë duhet të kryejë veprime për mbrojtjen e natyrës. Ai duhet të ketë vetëiniciativë për mbrojtjen e natyrës, që të mos e ndotë atë. Ndotja e natyrës shkakton edhe jetën e qenieve të gjalla në planetin tonë. Për një jetë të shëndetshme, duhet të kemi një mjedis të pastër.



I bëjnë pyetje njëri-tjetrit.

Hulumtohet më shumë në internet për mbrojtjen e natyrës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e dhëna, mendimet pozitive për ruajtjen e mjedisit dhe për tregimet e shprehura për rastet e tyre.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Puna me tekst

Lexohet situata në heshtje dhe nxiten nxënësit të diskutojnë:

- Ç'kuptoni me fjalën *natyrë*?
- A jeni aktiv për mbrojtjen e mjedisit? Si?
- Çfarë mund të bëni më shumë për natyrën?
- Çfarë mendoni për idenë e prezantimit të Erës?

Nxënësit në grupe bëjnë nga një broshurë për të promovuar mjedisin e pastër. Pas prezantimit të punës, broshurat mund të vendosen në ndonjë kënd të klasës apo shkollës.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Tryezë e rrumbullakët

Nxënësit tregojnë ndonjë shembull të pjesëmarrjes së tyre në një organizim vullnetar për pastrimin e ambientit, sipërfaqeve të gjelbra, përdorimit të transportit publik dhe atij ekologjik, riciklimit të mbetjeve, krijimit dhe përdorimit të deponeve adekuate.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mjedisi i vendit tim

Rezultatet e të nxënësve të temës:

Përshkruan me shembull konkret si dëmtohet mjedisi nga hedhja e mbeturinave familjare dhe industriale në vende joadekuate, nga trafiku, keqpërdorimi dhe degradimi i tokës, pyjeve dhe ujërave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.1,3; II.1,2,6; III.1,2; IV.4; VI.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 5.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndotja e ujërave

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Kujton njohuritë për ujin dhe rëndësinë e ujit;
- Diskuton për mënyrat e pastrimit të ambientit;
- Krahason punën e tij me atë të shokut-shoqes.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletët e bardha.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuha dhe komunikimi, Art, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Pema e mendjes

Bisedohet për ujin dhe rëndësinë e ujit, nxënësit japin mendimet e tyre dhe shkruhen në tabelë.



Mjedisi i vendit tim

Ndotja e ujërave

Mali vizitonte dajat e tij çdo pushim pranveror. Aq shumë e donte natyrën e fshatit, sa që nuk pranonte kurrsesi të kalonte diku tjetër pushimet. Çdo gjë i dukej e mrekullueshme në fshat: relievi, harmonia e njerëzve, lidhja e tyre me natyrën, mënyra se si e punonin tokën, produktet që merrnin nga toka. E vetinja gjë që e shqetësonte ishte lumi i fshatit. *Pse banorët hidhnin mbeturina në lumë? Pse banorët nuk pastronin lumin njëherë e përgjithmonë? Pse fshatarët nuk shpëtonin nga kundërmimi i erës së keqe që shkaktonin mbeturinat?* Mali e kishte plot shokë në fshat me të cilët luante. Mali hodhi idenë i pari që të shkonin së bashku me shokët për t'i larguar të gjitha letrat që ishin afër lumit. Po sikur të kërkojmë ndihmë nga të rriturit për këtë gjë, çfarë do të na thoshin? Fëmijët, që mezi prisnin të kalonin kohën së bashku, thanë të gjithë njëzëri: "Le ta provojmë!". Mali me shqen e tij, Klean, ndërkolhe që po mblidhnin mbeturinat bashkë me fshatarët, po bisedonin se sa keq ishin ndier kur kishin kaluar pushimet në det vitin e kaluar. Ata kishin parë që deti ishte i mbushur me geska najloni e mbetje ushqimesh. Nuk arrinin të gjenin dot një përgjigje për këto veprime. Uji, elementi kyç i jetës së gjallesave, a mos është duke u ndotur shumë nga njeriu? "Njeriu duhet të ndalojë së bëri këto veprime të dëmshme", - ishin fjalët e Yllit, i cili ndërpreu bisedën e Malit dhe të Kleas.

- ? - Çfarë i bënte përshtypje Malit në fshat?
- Pse Mali thotë që uji është element kyç i jetës së gjallesave?
- Pse është e rëndësishme ta kursejmë ujin?

Uji është i domosdoshëm për jetën e qenieve të gjalla. Prandaj njeriu duhet të tregojë kujdes të veçantë për ujërat në mjedisin ku jeton. Njeriu duhet të kujdeset që të mos keqpërdorë apo ndotë ujin e pijshëm dhe ujërat e tjera. Ndotja e ujit është ndotja e të gjitha ujërave në tokë, liqene, lumenj, oqeanë, rrjedhje dhe ujëra nëntokësore. Ndotja e ujit ndodh kur ndotësit hidhen në ujë, pa treguar kujdes për të hequr përbërjet e dëmshme. Ndotja e ujit prek bimët dhe organizmat që jetojnë në këto ujëra dhe shkakton efekte të dëmshme në to. Ndotësit kryesorë dhe shkaktarë të sëmundjeve të shumta infektive janë ujërat e zeza. Secili vend duhet të ketë kujdes për ndërtimin e sistemit të derdhjes së ujërave të zeza.

112 Fjalët kyçe: ujë, lumë, ndotje, kursim, jetesë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
DLTA

Lexohet mësimi me ndalesa, pasi në mësim ka shumë pyetje të arsyeshme të parashtruara nga Mali. Nxënësit përgjigjen dhe i shprehin mendimet e tyre duke i argumentuar ato që ata i kanë thënë me ndonjë shembull nga jeta e tyre.

Bisedohet për veprimet e Malit dhe mënyrën e kursimit të ujit.



Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Rishikim me rigrupim

Secilit grup i jepet nga një fletë, në të cilën shtrohet një detyrë, pyetje apo problem lidhur me ndotësit e ujit. Pastaj, kur grupet ta kryejnë punën në fletën e vet, fletët përcillen nga njëri grup te tjetri derisa të gjitha grupet t'i shkruajnë mendimet e tyre për temën apo t'i plotësojnë mendimet që i kanë dhënë grupet e tjera.

Në fund lexohen fletët ku janë të formuara në bazë të numrit të grupeve.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mendimet e dhëna për ujin, për përgjigjet e dhëna dhe për plotësimin e fletëve.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mjedisi i vendit tim

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan me shembull konkret si dëmtohet mjedisi nga hedhja e mbeturinave familjare dhe industriale në vende joadekuate, nga trafiku, keqpërdorimi dhe degradimi i tokës, pyjeve dhe ujërave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1,2,6; III.1,2; IV.4; VI.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 5.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndotja e tokës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përzgjedh fjali për kujdesin ndaj tokës;
- Dallon njohuritë e mëparshme për tokën dhe ato të mësuara;
- Përzgjedh esenë më të mirë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuha dhe komunikimi, Art, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Brainstorming


Në tabelë do të shkruhet 'TOKA' dhe secili nga nxënësit do të dalë dhe do të shënojë nga një fjali për tokë. Pasi ti përfundojnë shkrimet, krahas tyre, së bashku me nxënësit do të shkruajnë nga një veprim që ne mund ta bëjmë për tokën si p.sh., kujdesem për të, nuk hedh mbeturina, ujë ka më shumë se tokë, nuk e lë çezmen të lëshuar etj.



Mjedisi i vendit tim

Ndotja e tokës

Mësuesja u dha detyrë nxënësve që të përgatitnin një projekt me temë sipas dëshirës. Disa nxënës morën për temë instrumentin më të pëlqyer, disa përgatitën projekt për kafshën e dashur e disa për bimët. Klea po vriste mendjen se cilën temë ta merrte. Dëshironte që të hulumtonte një temë për të cilën nuk kishte shumë informata, por që do të ishte e dobishme për të. Ishte në mes të kafshës më të pëlqyer, bimës më interesante apo trupit të njeriut. Ndërkohë që po mendonte, iu kujtua se këto tri gjallesa kanë diçka të përbashkët. Që të tria jetojnë në Tokë, prandaj ajo mendoi që të hulumtonte për Tokën. Ndërkohë që po mblidhte informacione për formën e Tokës, origjinin e emrit e karakteristika të tjera, asaj i tërhoqi vëmendjen fjalia: "Në Sistemin Diellor ka tërë planetë dhe VETËM në planetin Tokë është e mundshme jeta për gjallesat". Fakte si përcindja e ujit në Tokë, përbërja e ajrit, sateliti natyral i Tokës etj., po i bënin përshypje Kleas. Ajo mendoi që të ndryshonte temën e projektit, do të ndërjegjësohte shokët e shoqet e klasës për rëndësinë e planetit Tokë. - Unë mund të bëj gjëra të vogla me dashuri të madhe për planetin tim, - mendoi ajo. Klea u përqendrua te veprimet e dëmshme që mund të bëjnë fëmijët ndaj tokës. Ne hedhim mbeturina në tokë. Ne shpenzojmë shumë ujë pa nevojë. Ne nuk riciklojmë. Ne dëmtojmë hapësirat e gjelbëruara kur ecim në bar e jo në rrugën e shtuar. Ne dëmtojmë lulet ndërkohë që duhet të kujdesemi për to. Në fund të prezantimit të projektit, ajo kërkoi nga shoqet dhe shokët e klasës që të vizatonin diçka që ata mund të bënin ndryshe për të mirën e planetit. Klea e përmbylli prezantimin duke thënë me zë të lartë: "Është e mira jonë e përbashkët, prandaj duhet ta ruajmë me çdo kusht!".



Mjedisi i vendit tim

Ndotja e tokës

- Çfarë e dallon Tokën nga planetët e tjerë?
- Çfarë mund të mbjellim në tokë?
- Cili mund të jetë kontributi ynë për Tokën?
- Përmend një veprim që shkakton ndotjen e tokës.
- Ndahuni në grupe dhe planifikoni pastrimin e oborrit të shkollës.



Toka është i vetmi planet në Sistemin Diellor, në të cilin zhvillohet jeta. Njeriu duhet të kujdeset në mënyrë të vazhdueshme për tokën duke mbjellë bimë dhe fidanë të ndryshëm, duke ricikluar dhe duke hedhur mbeturinat në vendin e duhur.

Ndotje quhet gjithashtu ndikimi i dëmshëm, shpesh i pakthyeshem në mirëqenien e mjedisit dhe vlerat e tij materiale ose estetike. Ndotja e vazhdueshme e tokës shkakton dëmtime të drejtpërdrejta të mjedisit, pjesëve të natyrës, qenieve të qajlla dhe shëndetit të njeriut. Ndotja kërkohet të parandalohet duke kontrolluar burimet e ndotësve. Veprimet e papërgjegjshme të njeriut rezikojnë dhe ndotin tokën.

Fjalët kyçe: ujë, ndotje, kujdes, tokë, riciklim.

115



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Gushëkuqi rrethor

Mësimi do të ndahet në pjesë, varësisht sa grupe janë të formuara në klasë. Njëri nga nxënësit e lexon pjesën që e kanë të caktuar dhe të tjerët do ta komentojnë ku mund të shtojnë edhe gjëra të tjera, pjesët shtesë grupi duhet t'i mbajnë si shënim. Kështu vazhdohet me të gjitha grupet.

Pjesët shtesë që ata i kanë cekur dhe nuk janë të shkruara në mësim i shënojnë në tabelë, kështu do të shtojmë shumë gjëra të reja.

Përgjigjen në pyetjet që janë në fund të mësimt.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Fjalët kyçe

Do të shkruajnë nga një ese me fjalët kyçe që janë në fund të mësimt.

Në fund do të lexohen disa nga esetë e shkruara dhe do të zgjedhim esenë më të mirë, përmbajtësore dhe domethënëse.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për shprehjen e njohurive për tokën, për përgjigjet e dhëna dhe për tregimin e shkruar me fjalët kyçe.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mjedisi i vendit tim

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përs shkruan me shembull konkret si dëmtohet mjedisi nga hedhja e mbeturinave familjare dhe industriale në vende joadekuate, nga trafiku, keqpërdorimi dhe degradimi i tokës, pyjeve dhe ujërave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1,2,6; III.1,2; IV.4; VI.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 5.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: T'i ruajmë tokën dhe pyjet

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Formulon një tregim të shkurtër me fotografi;
- Bën dallimin në mes të sjelljes së Malit dhe xhaxhait të tij;
- Përmbledh njohuritë e marra për pyjet dhe tokën.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuha dhe komunikimi, Art, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Komentim fotografish


Në tabelë vendosen pesë fotografi dhe nxënësit kanë për detyrë të formojnë nga një tregim me këto fotografi dhe do t'i dëgjojmë tregimet.



Mjedisi i vendit tim

T'i ruajmë tokën dhe pyjet

Mësuesja po sqaronte se sa të dobishëm ishin drurët në jetën e secilit njeri. Ajo kishte përgatitur një prezantim ku tregohej se sa i dobishëm ishte procesi i fotosintezës, ndërkohë që Mali nuk ishte shumë i përqendruar në fjalët e mësueses. Atij po i kujtohej një ngjarje e vitit të kaluar. Ndërkohë që Mali po ecte me familjen e tij në një pyll, ata kishin takuar një të njohur që po priste drurë. Mali e dinte që prerja e drurëve ishte e dëmshme, prandaj e pyeti të njohurin: "O xhaxha, - po ti e di se të presësh drurë nuk është gjë e mirë për ajrin dhe jetën në tokë!" Malit i kujtohej mjaft mirë përgjigja e tij. Ai pati thënë "Po unë me këtë punë jetoj dhe mbaj familjen". Në një mënyrë apo tjetër, Mali e kishte pranuar mendimin e xhaxhait dhe ishte ndier keq pse e kishte pyetur. Tani i dukej momenti i duhur për të ndarë këtë përvojë me mësuesen e tij. Përgjigja e mësueses e habit, edhe pse Mali priste që mësuesja do të kundërshtonte veprimin e xhaxhait. Për çudinë e tij ajo iu drejtua me një pyetje. Çfarë duhet të bëjë i njohuri yt, që të kompensojë dëmin e bërë? Ishte një pyetje që Mali nuk e kishte menduar. Vërtet, nëse xhaxhai do të mbillte nga një dru të ri, për secilin dru të prerë, atëherë ndoshta do të kompensojë dëmin e tij deri diku.



Mjedisi i vendit tim

T'i ruajmë tokën dhe pyjet

- Diskutoni për veprimin e xhaxhait që takoi Mali.
 - Si t'u duk mendimi i Malit për xhaxhanë?
 - Po ty, si t'u duk veprimi i xhaxhait? Po përgjigja e mësueses?
- Mendoje një zgjidhje tjetër të këtij problemi!

Pylli është një bashkësi e gjallë e pemëve dhe shkurreve. Pylli konsiderohet si një fabrikë ekologjike e përsosur, sepse pastron ajrin, por është edhe një vend ideal për jetën e shumë kafshëve të egra dhe njerëzsh njeriu përfiton nga ai.

Duke e ditur dabinë e drurëve për jetën në Tokë, njeriu duhet të ketë kujdes që të mos i presë drurët dhe të mos i shkatërrojë pyjet. Njerëzit me veprimet e tyre të papërgjegjshme presin pyjet për të bërë rrugë, vendbanime, si dhe për shumë nevoja të tjera personale.

Gjatë stinës së verës, ekziston reziku i zjarreve në pyje, për shkak të temperaturave të larta. Pyjet priten ose diçjen, por ne duhet të kujdesemi që ato të ripërtërihen. Ne duhet të jemi të përgjegjshëm që gjithmonë të mbjellim sa më shumë drurë. Për çdo pyll duhet të kujdeset pylltari, gjithashtu për çdo prerje druri duhet të kërkohet leje nga institucionet përkatëse.



Fjalët kyçe: pyll, dru, shkurre, prerje, mbrojtje.

117



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Lexim dhe komentim

Dëgjohet mësimi i lexuar, përgjigjen në pyetje dhe diskutohet veprimi i Malit, xhaxhait të tij dhe të mirat e pyllit.



Përforsimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Pesëvargësh

Pyje

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për formulimin e tregimit me fotot e dhëna, për përgjigjet e dhëna dhe për formimin e pesëvargëshit.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mjedisi i vendit tim

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpjegon rëndësinë e zgjerimit të sipërfaqeve të gjelbra, përdorimit të transportit publik dhe atij ekologjik, riciklimit të mbetjeve, krijimit dhe përdorimit të deponive adekuate.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1, 2,6; III.1,2; IV.4; VI.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 5.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Transporti publik dhe ekologjik

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Kujton njohuritë për transportin publik dhe ekologjik;
- Formulon përgjigjet e pyetjeve në mënyrën më të lehtë;
- Interpretin imagjinatën për transportin.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuha dhe komunikimi, Art, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:


Përgatitja për të nxënë

Kllaster

Bisedohet rreth njohurive të nxënësve për transportin publik dhe ekologjik. Në mes të tabelës do të shënohet transporti publik pastaj do të shikojmë dy video të shkurtra për transportin publik:

<https://www.youtube.com/watch?v=GChHMAkMHUM>

<https://www.youtube.com/watch?v=cGYvjieVkJw>




Mjedisi i vendit tim

Transporti publik dhe ekologjik

Klea po fliste vazhdimisht në familje për rëndësinë e ruajtjes së ambientit, për rëndësinë e hedhjes së mbeturinave në vendin e duhur, për mbjelljen e bimëve, për përdorimin sa më të paktë të makinave.

Nëna dhe babai i Kleas e dëgjonin me vëmendje dhe krenoheshin me vajzën e tyre që donte ta ruante ambientin. Një ditë, teksa po udhëtonin për te gjyshërit në një qytet tjetër, Klea i tërhoqi vëmendjen një autobus i gjatë me ngjyrë të verdhë. Disa njerëz po rrinin në këmbë e të tjerë ishin të ulur në të. Klea pyeti prindërit e saj - Përse njerëzit udhëtonin me autobus kur nuk kishin vend dhe duhej të rrinin në këmbë? Babai buzëqeshi dhe e pyeti Klean: - Këta njerëz po i bënin mirë ambientit apo dëm? Klea u mendua pak dhe u përgjigj: - Natyrisht që po i bënin mirë. Po të përdorte secili nga këta njerëz veturën, atëherë do të digjeshin në shumë lëndë djegëse dhe do të ndotej ambienti. Sa i dobishëm qenka përdorimi i autobusit, - shtoi ajo.

Nëna e lumtur me përgjigjen e Kleas shtoi: - Ky lloj transporti quhet transport publik dhe është i destinuar për të gjithë qytetarët. Ai funksionon sipas një orari, mban një linjë rrugë të caktuar dhe për të shfrytëzuar atë caktohet një çmim standard. - Mendoj që edhe ne, - tha Klea, - duhet të udhëtojmë me transport publik tash e tutje. Prindërve u pëlqeu ideja e saj.



Mjedisi i vendit tim

Transporti publik dhe ekologjik

- Çfarë kupton me fjalën transport publik?
- Si duhet të silllemi në transport publik?
- Pse është e rëndësishme të përdoret transporti ekologjik?
- A ka në qarkullim transport ekologjik në vendin tonë?

Transporti publik përfshin lëvizjen e udhëtarëve nga një vend në një vend tjetër. Transporti publik shërben për transportin e përbashkët të udhëtarëve ose shërbimeve që janë në dispozicion për përdorim nga të gjithë. Llojet e transportit publik janë: transporti urban, ndërurban etj. Për t'i ofruar këto shërbime, përpos ndërmarrjes publike, ekzistojnë edhe ndërmarrjet private, të cilat operojnë në treg në formë të biznesit. Edhe këto përdorin relativisht të njëjtat mjete transporti, si minibusët, autobusët ose taksitë etj. Në të gjithë botën, rëndësi të veçantë i kushtohet transportit ekologjik (metros), i cili redukton ndotjen e ajrit dhe kryen funksion të njëjtë me transportin publik. Ndotësit e mjedisit, midis tyre edhe përdorimi i tepërt i makinave, po shkaktojnë ngrohjen globale, prandaj është i domosdoshëm përdorimi i transportit publik.



Fjalët kyçe: transport publik, ndotje, ajër i pastër, ekologjik.

119



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Përvijim i të menduarit

Pasi të diskutohet për videot, mësimi lexohet dhe parashtrihen pyetjet që janë në mësim dhe pyetje të tjera shtesë. Gjërat e reja do t'i diskutojmë në klasë dhe do t'i shënojmë në tabelë, duke u munduar që t'i sqarojmë dhe komentojmë sa më mirë dhe më lehtë.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Shkrim i lirë

Lëshohet një muzikë e qetë e cila ka të bëjë me transportin dhe nxënësit në mënyrë të pavarur do të shkruajnë nga një tregim imagjinar lidhur me transportin dhe udhëtimin e tyre të gjatë.

Në fund lexohen disa nga shkrimet e bëra dhe vlerësohet imagjinata më e zhvilluar.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mendimet e dhëna për transportin publik, përgjigjet e dhëna dhe për tregimet imagjinare.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mjedisi i vendit tim

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpjegon rëndësinë e zgjerimit të sipërfaqeve të gjelbra, përdorimit të transportit publik dhe atij ekologjik, riciklimit të mbetjeve, krijimit dhe përdorimit të deponive adekuate.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1,2,6; III.1,2; IV.4; VI.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 5.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Si riciklohen mbetjet?

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Bën dallimin mes fjalëve ripërdor, riciklo dhe redukto;
- Shpreh njohuritë paraprake duke u përgjigjur në pyetje;
- Arrin në përfundim që e ka kuptuar ndarjen e mbeturinave.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Shportat e mbeturinave.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuha dhe komunikimi, Art, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Aktivitet në ambient të hapur

Së bashku me nxënësit zhvillohet një aktivitet për mbledhjen e mbeturinave në oborrin e shkollës. Mërrin shportat me ngjyra dhe së bashku me nxënësit duke i mbledhur mbeturinat i ndajmë nëpër vendet e caktuara dhe në fund sqarohet qëllimi i aktivitetit dhe fjalët ripërdor, riciklo dhe redukto.



Mjedisi i vendit tim

Si riciklohen mbetjet?

Mali i kishin rënë në sy vazhdimisht disa shenja në shportën e plehrave në oborrin e shkollës. Madje kishte dëgjuar dhe për rregullën "3R - ripërdor, riciklo dhe redukto". Ndoshta se nuk ishte shumë i interesuar në atë kohë, prandaj nuk e kishte kuptuar dhe aq mirë këtë rregull. Kur mësuesja filloi të fliste se si mbeturinat nuk duhej të hidheshin të gjitha në të njëjtën shportë, por ato duhej të klasifikoheshin, atij iu kujtua pse ekzistonte rregulla "3R".

Qëllimi i kësaj rregulle ishte që të shfrytëzoheshin sa më shumë produktet. - Mësuese, a po flisni për riciklimin? - pyeti Mali. - Pikërisht, Mali, të lumtë! Mirëpo, po flas dhe për ripërdorimin dhe reduktimin. P.sh., ti mund të përdorësh çantën e njëjtë për shumë vjet në shkollë. Mund të punosh ndonjë dekor dhe ta zbkurosh çdo vit çantën, në vend që të kërkosh të blesh një të re. Apo, t'i falësh lodrat e tua. Kështu, ne kemi ripërdorur materiale të ndryshme.

Ju lutem, kudo që e shihni shenjën e riciklimit, të hidhni vetëm materialet që mund të riciklohen, si: shisheet e plastikës, letrën e pastër, shisheet e xhamit apo kanaçet e pijeve të ndryshme.

Ju duhet të ndani mbeturinat edhe në shtëpitë tuaja. Rrobat apo gjërat që mund të riciklohen, t'i përdorni sa më gjatë që të mundeni. Kur të mos ju bëjnë më, mund t'ua dhuroni njerëzve në nevojë.

Mali dhe shokët e shoqërisë së tij u gëzuan shumë, sepse menduan që kishin shumë gjëra në dorë për të ruajtur ambientin. Mezi po prisnin që të sistemonin lodrat e vegjël dhe rrobat e tyre, me qëllim që t'ua dhuronin fëmijëve të tjerë.

Mali propozoi që të gjithë fëmijët të vizitonin simbolin e riciklimit dhe ta vendosnin atë në një prej shportave të mbeturinave në shtëpi.



- C'është riciklimi?
- Cilat gjëra/sende riciklohen?
- Çfarë përfitojmë nga riciklimi i mbetjeve?
- Trego një rast kur ke ricikluar.



Riciklimi është ndarja e materialeve nga mbeturinat dhe ripërdorimi i tyre. Ai përfshin mbledhjen, ndarjen, përpunimin dhe prodhimin e produkteve të reja nga sendet ose materialet e përdorura. Shumë mbeturina mund të ripërdoren nëse grumbullohen veçmas.

Është shumë e rëndësishme që së pari të ndahen mbetjet sipas llojeve të mbeturinave. Duhet të kemi kujdes kur i klasifikojmë mbeturinat, sepse mbeturinat e riciklueshme duhet t'i hedhim në koshin e caktuar.

Materialet që mund të riciklohen janë: letra, metalet, si: alumini, çeliku, produktet e qelqit etj. Krijimi i plehrave nga mbetjet organike është një tjetër shembull i mirë i riciklimit. Pa futjen e riciklimit në jetën e përditshme, do të jetë e pamundshme të imagjinohet një sistem i rregullt i mbeturinave.

120 **Fjalët kyçe:** kujdes, mbeturinë, riciklim, përfitim.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Mësim në natyrë

Pasi të përfundojë aktiviteti, të gjithë nxënësit ulen në rreth dhe vazhdohet me leximin e mësim-it dhe komentimin duke u bazuar në aktivitetin që e zhvilluan më herët.

Parashtrohen pyetje dhe merren përgjigje, po ashtu shprehen edhe shumë ide të ndryshme nga përvojat e nxënësve nga jeta e përditshme dhe diskutohen edhe hedhjet e mbeturinave në shtëpi dhe rrugë.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Tabela e ndarjeve

Pas përfundimit të mësimin në natyrë të gjithë nxënësit kthehen në klasë, tabela ndahet në katër pjesë, shënohen dhe vizatohen figurat me ngjyra të llojeve të shportave.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në aktivitet, për përgjigjet e dhëna dhe paraqitjen e ndarjeve të mbeturinave.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mjedisi i vendit tim

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpjegon rëndësinë e zgjerimit të sipërfaqeve të gjelbra, përdorimit të transportit publik dhe atij ekologjik, riciklimit të mbetjeve, krijimit dhe përdorimit të deponive adekuate.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1, 2,6; III.1,2; IV.4; VI.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 5.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kujdesi për higjienën në komunitet

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon atë që e di për higjienën në komunitet;
- Lidh njohuritë paraprake për higjienën në komunitet;
- Krahason njohuritë paraprake dhe ato që ka arritur t'i marrë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Interneti, fletët.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuha dhe komunikimi, Art, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Di

Shpërndahet nga një fletë në të cilën shkruan titulli i mësimi dhe rubrika *Di*. Nxënësit kanë për detyrë që të shkruajnë atë që ata e dinë për temën.

Pasi të kenë përfunduar detyrën, mësuesi/ja në tabelë shënon ato që ata i dinë por të ndryshmet nga njëri tjetri.



Mjedisi i vendit tim

Kujdesi për higjienën në komunitet

Shoqja e Lumit dhe e Norës, Mira, shkon në shkollën e muzikës, ku mëson pianon. Në një koncert që shkolla e muzikës organizoi, u ftuan të gjithë shokët e shoqet e Mirës. Fëmijët s'kishin marrë pjesë asnjëherë në një ngjarje të tillë më parë.

Mësuesja u kujtoi fëmijëve se duhej të shkonin në koncert në kohën e duhur, të zinin vendet pa bërë zhurmë, të mos flisnin ndërkohë që interpretohej pjesa muzikore, të shikonin dhe të dëgjonin performancën e nxënësve.

Ndërkohë që fëmijët po prisnin në korridorin e shkollës për të filluar koncertin, Ylli, i ulur në një karrige, pasi mbaroi ushqimin, hodhi letrën në dysheme. Edhe Diella veprroi në të njëjtën mënyrë me letrën e saj të kekut.

Ky veprim nuk kaloi pa u vënë re nga mësuesja dhe shumë shokë e shoqe që ishin aty. Ata kujtuan që, ashtu siç mbajnë pastër higjienën personale, duhet të ruajnë dhe ambientet publike. Nëse të gjithë do të hidhnin mbeturinat vend e pa vend, nuk do të mund të shijonin bukuritë në mjedise të ndryshme. Lumi iu drejtua shokëve duke u thënë: "Le të kujdesemi për higjienën gjithandej. Kjo higjienë do të na mbajë të shëndetshëm fizikisht dhe mendërisht".



- Çfarë kupton me fjalën *komunitet*?
- Si duhet të sillemi në ambiente publike?
- Çfarë masash duhet të ndërmerim për pastrimin e lagjes?
- Përmend tri veprime jo të mira që ndikojnë në higjienën në komunitet.



Njeriu ka përgjegjësi që, përveç higjienës personale, të promovojë vlera aytetarie edhe në komunitet. Këtë përgjegjësi e demonstroi me veprime të ndryshme, si: duke mbjellë bimë të ndryshme, duke u kujdesur për ambientin, duke u kujdesur që të mos dëmtojë objektet që i shfrytëzojmë në mënyrë të përbashkët etj.

Të gjitha shprehjet e jetës krijohen në fëmijëri. Për çdo gjë që na rrethon duhet të kujdesemi sikur të ishte prona jonë. Nëse sillemi me përgjegjësi dhe tregojmë kujdes të plotë për higjienën e gjërave që na rrethojnë, do të kemi një jetë të mirë dhe të shëndetshme në komunitetin tonë.

122 Fjalët kyçe: komunitet, higjienë, kujdes, ambient publik.



123



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Dua të di

Në vazhdim do të shkruajnë se çfarë duan të dinë, në mënyrë pak më të specifikuar. Po ashtu, do ta paraqesin nga një ilustrim se me çfarë u asocion ky titull.

Pasi të përfundojnë, do të lexohet mësimi dhe do të shohin se a kanë mundur t'i gjejnë ato që kanë dashur t'i dinë në mësim dhe për ato që nuk i kanë gjetur do ta përdorin internetin me ndihmën e mësuesit/es.

Po ashtu, do të bëjnë edhe krahasimin e ilustrimit të tyre me atë që e kanë në libër.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Mësova

Pasi ta kenë lexuar mësimin, me ndihmën e mësuesit/es do të plotësojnë edhe atë që nuk e kanë ditur.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për shprehjen e mendimeve të tyre, për leximin dhe kuptueshmërinë.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Mjedisi i vendit tim

Rezultatet e të nxënës të temës:

Merr pjesë aktive dhe përcakton veprimet që duhet t'i ndërmarrë në bashkëpunim me të tjerët në organizimin e aktiviteteve të ndryshme që promovojnë ruajtjen e mjedisit, trashëgimisë ekonomike, shëndetësore dhe kujdesit shoqëror ndaj të tjerëve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1,2,6; III.1,2; IV.4; VI.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 5.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Unë dhe ti

Rezultatet e të nxënës të orës mësimore:

- Zgjedh pyetjet e duhura për etiketa;
- Nxjerr përfundime të pyetjeve me kujdes të shtuar;
- Konfirmon fitoren e lojës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuha dhe komunikimi, Art, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Temat e njohurive

Nxënësit në grupe kanë për detyrë të formojnë nga 20 etiketa secili grup dhe në etiketa do të shkruajnë pyetje të ndryshme të marra nga mësimet e mësuara.

Jepen sqarime për mënyrën e zhvillimit të lojës. Në lojë marrin pjesë të gjithë nxënësit, etiketat e formuara i kthejnë në anën e kundërt dhe nxënësit do t'i hapin etiketat me radhë. Nxënësi që nuk e di



Mjedisi i vendit tim

Lojë: Unë dhe ti

Përshkrimi i lojës:

Në këtë lojë marrin pjesë dy nxënës.

Nevojiten etiketa me numrat 1 deri në 20, të cilat i përgatit mësuesi/ja. Secili nxënës tërheq nga një etiketë dhe i përgjigjet pyetjes me numrin që ka etiketa.

Pasi përgjigjet nxënësi i parë, tërheq etiketën nxënësi i dytë dhe përgjigjet në pyetjen përkatëse.

Secila përgjigje e saktë vlen dy pikë. Mbahet shënim për secilin nxënës dhe në fund do të fitojë ai që ka marrë më së shumti pikë.

1. Çfarë kupton me fjalën *bullizëm*?

20. Përmend disa materiale të cilat mund të riciklohen.


19. Çfarë bën për një mjedis të pastër?

18. Çfarë do të thotë pasuri humane?

17. Cilat janë pasuritë nëntokësore të Kosovës?

16. Trego cilat janë institucionet kulturore të vendit tënd.

Unë					
Ti					

2. Cili është grupi më i vogël shoqëror?	3. Cilat janë arsyet që njerëzit bëjnë punë vullnetare?	4. Përmend dy të drejta dhe dy përgjegjësi të fëmijëve.	5. Cilët janë hapat për zgjidhjen e mosmarrëveshjes?	6. Çfarë do të thotë diversitet kulturor?
				7. Si e shpjegon kuptimin e fjalës mikpritje?
				8. Cilat veti e tregojnë një njeri solidar?
				9. Sa është e rëndësishme barazia gjinore në jetën e përditshme?
				10. Unë jam tolerant, sepse...
15. Përmend disa sportistë kosovarë që sollën medalje të arta në vendin tonë.	14. Cilat janë dallimet mes familjes tradicionale dhe familjes bashkëkohore?	13. Cilat komunitete i përfaqësojnë yjet në flamurin e Kosovës?	12. Kur u shpall Pavarësia e Kosovës?	11. Numëro regionet e Kosovës?

127

përgjigjen e pyetjes që i bie e kthen etiketën në vendin e duhur dhe ai që e di përgjigjen e mban letrën në dorë. Në fund fitues është ai që ka më së shumti letra në dorë.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes**
Zhvillim i lojës argëtuese

Zhvillohet loja në grupe, pyetjet do të jenë nga 20 për një grup dhe pasi i kanë marrë sqarimet për lojë, fillon loja dhe mësuesi/ja e përcjellë zhvillimin e lojës.

Cili nga nxënësit fiton më së shumti etiketa do të jetë fitues i grupit. Kështu do të nxirren 6 fitues dhe etiketat me të gjitha grupeve do të bashkohen dhe loja do të vazhdojë.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit**
Përzgjedhje e fituesit

Pasi janë zgjedhur 6 fitues dhe etiketat janë bashkuar të gjitha; gara do të vazhdojë dhe në fund të 6 fituesit garojnë në mes vete dhe nxënësi që fiton do të jetë fitues i gjithë lojës.

Gjashtë fituesit e lojës komentojnë ndjenjat e tyre gjatë zhvillimit të lojës dhe krejt në fund fituesi i gjithë lojës, do të tregojë për ndjenjat dhe mendimet e tij gjatë zhvillimit të lojës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për kuptimin e lojës, për përgjigjet e dhëna dhe fitoren.

Detyrë:

Të plotësojë në fletore të punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:





